



EKONOMIA QARKORE DHE TRANZICIONI I GJELBËR NË INDUSTRIËN E TEKSTILIT

MAJ 2026



Ky publikim është zbatuar nga Rilindja Gjelbër, menaxhuar nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF) dhe prodhurar me mbështetjen financiare të Ambasadës Suedeze në Prishtinë. Përmbajtja e tij rrjedh nga përgjigjet e anketave të marra deri në datën e specifikuar në këtë raport dhe është përgjegjësi e vetme e Rilindja Gjelbër, zbatues i projektit "Kthimi i Vlerave në Ekonominë Qarkore" nën kuadrin e programit "Fuqizimi i OSHC-ve Mjedisore në Kosovë".

Ky raport konsiderohet version draft/final paraparak dhe do të finalizohet pas prezantimit të gjetjeve dhe marrjes së komenteve përfundimtare nga palët relevante. Çdo koment apo sqarim i dalë gjatë dhe pas prezantimit do të reflektohet në versionin final të raportit

PËRMBAJTJA

Lista e shkurtesave	5
Lista e figurave	6
Lista e tabelave	11
Përmbledhje ekzekutive	12
1. Hyrje	13
2. Metodologjia	14
2.1 Limitimet e raportit	15
3. Analiza e politikave	16
3.1 Strategjitë dhe nxitjet e qeverisë	20
3.2. Marrëveshjet dhe standardet ndërkombëtare	21
4. Profili ekonomik i industrisë së tekstilit	24
4.1 Kategorizimi i bizneseve	25
4.2 Punësimi	26
4.3 Importi dhe eksporti	28
4.4 Konsiderata mjedisore	36
5. Ekonomia qarkore	36
6. Sfidat në sektorin e tekstilit	37
7. Rezultatet nga anketat me qytetarë	39
7.1 Demografia	40
7.2 Furnizimi me produktet e tekstilit	40
7.3 Veshmbathjet dhe aksesoret	62
7.4 Tekstili shtëpiak	70
7.5 Praktikat e ripërdorimit dhe riciklimit	75
7.6 Ekonomia qarkore	84
7.7 Burimet e informacionit	88
8. Rezultatet nga intervistat me biznese	89
8.1 Informacioni i përgjithshëm për kompaninë	89
8.2 Përdorimi i lëndëve të para për prodhim	95
8.3 Menaxhimi i mbeturinave	99
8.4 Ekonomia qarkore	106

8.5 Ndryshimet klimatike dhe gjurmët e karbonit	108
8.6 Regullat mjedisore për eksport.....	110
8.7 Interesimi dhe sfidat për riciklim.....	111
9. Rezultatet nga intervistat me politikbërës	125
9.1 Ministria e Mjedisit – Departamenti për Menaxhim të Mbeturinave	125
9.2 Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK).....	126
9.3 Kompania për Menaxhimin e Deponive në Kosovë (KMDK)	127
9.4 Komuna e Gjakovës – Sektori për Menaxhimin e Mbeturinave	128
9.4 Përmbledhje e intervistave	131
10. Konkluzion	134
11. Rekomandime	135
Referencat	138
Aneks	143
Pyetësi për anketat me qytetarë	143
Pyetësi për intervistat me biznese	154

LISTA E SHKURTESAVE

CDF – Community Development Fund

AMMK – Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës

KMDK – Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës

GIZ – Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit

ARBK – Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës

USAID – United States Agency for International Development

BE – Bashkimi Evropian

SAA – Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit

CEFTA – Marrëveshja për Tregti të Lirë në Evropën Qendrore

PZP – Përgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuesit

SKZH-2030 – Strategjia Kombëtare për Zhvillim 2030

ILO – Organizata Ndërkombëtare e Punës

EU4Green – Program i financuar nga BE për zhvillim të qëndrueshëm

MMPHI – Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës

LISTA E FIGURAVE

Figura 1. Bizneset në industrinë e tekstilit sipas kategorisë.....	25
Figura 2. Bizneset në industrinë e tekstilit sipas llojit të aktivitetit	26
Figura 3. Vlera e mallrave sipas kategorive për vitin 2025	28
Figura 4. Vlera e mallrave të veshjeve të përdorura për vitin 2025	29
Figura 5. Sasia e mallrave sipas kategorive për vitin 2025.....	30
Figura 6. Sasia e mallrave të veshjeve të përdorura për vitin 2025.....	31
Figura 7. Vlera e mallrave sipas muajve për vitin 2025	32
Figura 8. Sasia e mallrave sipas muajve për vitin 2025	33
Figura 9. Vlera e mallrave të importit sipas shteteve për vitin 2025	34
Figura 10. Sasia e mallrave të importeve sipas shteteve për vitin 2025.....	34
Figura 11. Si furnizoheni me produktet e mëposhtme të tekstilit – veshmbathje? (Pyetje e shumëfishtë)	41
Figura 12. Si furnizoheni me produktet e mëposhtme të tekstilit – aksesore? (Pyetje e shumëfishtë)	42
Figura 13. Si furnizoheni me produktet e mëposhtme të tekstilit – shtëpiake? (Pyetje e shumëfishtë)	43
Figura 14. Sa shpesh i blini produktet e mëposhtme – veshmbathje?	44
Figura 15. Sa shpesh i blini produktet e mëposhtme – aksesore?	45
Figura 16. Sa shpesh i blini produktet e mëposhtme – shtëpiake?	45
Figura 17. Ku i blen zakonisht produktet e mëposhtme të tekstilit – veshmbathje? (Pyetje e shumëfishtë)	46
Figura 18. Ku i blen zakonisht produktet e mëposhtme të tekstilit – aksesore? (Pyetje e shumëfishtë)	47
Figura 19. Ku i blen zakonisht produktet e mëposhtme të tekstilit – shtëpiake? (Pyetje e shumëfishtë)	48
Figura 20. Në cilat vende jashtë Kosovës i bën këto blerje?	49
Figura 21. Pse këto produkte vendosni ti blini jashtë Kosovës? (Pyetje e shumëfishtë)	50
Figura 22. Si i blen zakonisht produktet e mëposhtme të tekstilit – veshmbathjet? (Pyetje e shumëfishtë)	51
Figura 23. Si i blen zakonisht produktet e mëposhtme të tekstil – aksesore? (Pyetje e shumëfishtë)	51
Figura 24. Si i blen zakonisht produktet e mëposhtme të tekstil – shtëpiake? (Pyetje e shumëfishtë)	52
Figura 25. Në çfarë lloj dyqanesh zakonisht i bëni këto blerje? (Pyetje e shumëfishtë)	53

Figura 26. Në cilat platforma i bëni zakonisht blerjet online?	54
Figura 27. Çfarë lloji te produkteve te mëposhtme te tekstilit blini – veshmbathje? (Pyetje e shumëfishtë)	55
Figura 28. Çfarë lloji te produkteve te mëposhtme te tekstilit blini – aksesorë? (Pyetje e shumëfishtë)	56
Figura 29. Çfarë lloji te produkteve te mëposhtme te tekstilit blini – shtëpiake? (Pyetje e shumëfishtë)	57
Figura 30. Si i blini zakonisht produktet e ripërdorura (second-hand) të tekstilit?	57
Figura 31. Cilat janë arsyet që nuk blini produkte të ripërdorura? (Pyetje e shumëfishtë)	58
Figura 32. Cilat janë arsyet që nuk blini produkte të ripërdorura? Krahاسimi 2024–2025 (Pyetje e shumëfishtë)	59
Figura 33. Në një shkallë nga 1 deri në 7, ku 1-aspak i gatshëm dhe 7-shumë i gatshëm, sa jeni të gatshëm të bleni produkte të ripërdorura në të ardhmen?	59
Figura 34. Cilat janë arsyet që do ta konsideroni blerjen e produkteve të ripërdorura (second-hand) në të ardhmen? (Pyetje e shumëfishtë)	60
Figura 35. Cilat janë arsyet e ripërdorimit te produkteve të tekstilit nga anëtarët e familjes tuaj? (Pyetje e shumëfishtë)	61
Figura 36. Çfarë lloji të veshmbathjeve dhe aksesorëve preferoni ta blini më shumë? (Pyetje e shumëfishtë)	62
Figura 37. Cilët janë tre faktorët që ndikojnë më shumë në vendimin tuaj për të zgjedhur veshmbathje apo aksesorë që blini? (Pyetje e shumëfishtë)	63
Figura 38. Sa jeni të informuar për konceptin fast fashion (modë e shpejt)?	63
Figura 39. Sa jeni të informuar për konceptin fast fashion (modë e shpejtë)? Krahاسimi 2024–2025	64
Figura 40. Sa ka ndikuar Fast Fashion (moda e shpejtë) në atë se sa shpesh bleni veshmbathje apo aksesorë?.....	65
Figura 41. Si i menaxhoni veshmbathjet dhe aksesorët që nuk i përdorni më? (Pyetje e shumëfishtë)	65
Figura 42. Si i menaxhoni veshmbathjet dhe aksesorët që nuk i përdorni më? Krahاسimi 2024–2025 (Pyetje e shumëfishtë)	66
Figura 43. Specifikoni vendin ku? (I dhuroj për familje në nevojë)	67
Figura 44. Specifikoni vendin ku? (I hedhi si mbeturinë)	68
Figura 45. Përafërsisht sa kilogram veshmbathje i hudhni gjatë një viti?	69
Figura 46. Në cilat raste zakonisht blini produkte të reja të tekstilit shtëpiak? (Pyetje e shumëfishtë)	70
Figura 47. Cilat janë arsyet kryesore për blerjen e tekstilit shtëpiak? Krahاسimi 2024–2025	70

Figura 48. Cilët janë tre faktorët që ndikojnë më shumë në vendimin tuaj për të zgjedhur produktet e tekstilit shtëpiak që blini? (Pyetje e shumëfishtë)	71
Figura 49. A keni ndryshuar zakonet tuaja të blerjes së produkteve të tekstilit shtëpiak gjatë viteve të fundit?.....	72
Figura 50. Si i menaxhoni produktet e tekstilit shtëpiak që nuk i përdorni më? (Pyetje e shumëfishtë)	72
Figura 51. Specifikoni vendin ku? (I dhuroj për familje në nevojë)	73
Figura 52. Specifikoni vendin ku? (I hedhi si mbeturinë)	74
Figura 53. A keni njohuri se si ndikon prodhimi dhe asgjësimi i produkteve të tekstilit në mjedis	75
Figura 54. Sa mendoni se është i rëndësishëm ky problem?	76
Figura 55. Cili mendoni se është shkaku kryesor i mos informimit tuaj mbi këtë çështje? (Pyetje e shumëfishtë)	77
Figura 56. Sa shpesh i ripërdorni dhe ricikloni produktet tuaja të tekstilit?	77
Figura 57. Sa shpesh i ripërdorni dhe ricikloni produktet tuaja të tekstilit? Krahasimi 2024-2025	78
Figura 58. A përballeni me vështirësi gjatë procesit të ripërdorimit dhe riciklimit të produkteve të tekstilit?	79
Figura 59. Çfarë ndryshimesh do t'ju inkurajonin të ripërdornit dhe riciklonit produktet e tekstilit më shpesh? (Pyetje e shumëfishtë).....	80
Figura 60. Çfarë do t'ju nxiste të ripërdorni ose ricikloni më shumë roba? Krahasimi 2024–2025 ..	81
Figura 61. Në cilat aspekte lidhur me ripërdorimin dhe riciklimin e produkteve të tekstilit dëshironi të merrni më shumë informacion? (Pyetje e shumëfishtë)	82
Figura 62. A keni informacion për ndonjë iniciativë të riciklimit të produkteve të tekstilit?	83
Figura 63. Në një shkallë nga 1 deri në 7, ku 1-aspek i gatshëm dhe 7-shumë i gatshëm, sa do të ishit të gatshëm të përfshihenit në procese të riciklimit të produkteve të tekstilit	83
Figura 64. Sa keni njohuri për konceptin e ekonomisë qarkore?	84
Figura 65. Sa keni njohuri për konceptin e ekonomisë qarkore? Krahasimi 2024—2025	85
Figura 66. A do të ishit të gatshëm të ndryshoni zakonet tuaja të furnizimit me produkte të tekstilit për të kontribuar në ekonominë qarkore?	85
Figura 67. Sa jeni të gatshëm të merrni pjesë në evente të shkëmbimit të robave (swapping clothes event)?	86
Figura 68. Çfarë ju motivon më shumë për t'u bërë pjesë e nismave të tilla? Pyetje e shumëfishtë	86
Figura 69. Cilat burime të informacionit i përdorni për të marrë informatat në lidhje me tekstilin dhe blerjen e produkteve të tekstilit? Pyetje e shumëfishtë	87
Figura 70. Cilat nga rrjetet sociale i përdorni më së shpeshti për informim dhe blerje të produkteve të tekstilit? Pyetje e shumëfishtë	88

Figura 71. Veprimtaria e kompanisë	89
Figura 72. Gjinia e pronarëve të kompanisë	89
Figura 73. Numri i punëtorëve në kompani sipas gjinisë	90
Figura 74. Vlerat e deklaruara të eksportit dhe importit të kompanive	90
Figura 75. Në cilat shtete keni eksportuar në vitin 2025?	91
Figura 76. Në cilat shtete keni importuar në vitin 2025?	91
Figura 77. Ku furnizohet kompania juaj me lëndën e parë?	92
Figura 78. Specifikoni vendin ku jashtë Kosovës?	93
Figura 79. Cila ka qenë forma kryesore e shitjes në kompaninë tuaj në vitin 2025?	93
Figura 80. Cili është aktiviteti kryesor i kompanisë tuaj?	94
Figura 81. Nëse kompania juaj është prodhuese, cilat produkte i prodhoni? (Pyetje e shumëfishtë)	95
Figura 82. Nëse kompania juaj ofron shërbime, cilat janë shërbimet kryesore që ofroni? (Pyetje e shumëfishtë)	96
Figura 83. Nëse kompania juaj është shitës me pakicë/shumicë, cilat produkte kryesore shisni? (Pyetje e shumëfishtë)	97
Figura 84. Cila është lënda e parë që përdorni për produktet e prodhuara?	97
Figura 85. Cilat janë materialet që kërkohen më shumë nga klientët tuaj dhe që kanë më shumë shitje? (Pyetje e shumëfishtë)	98
Figura 86. Si i menaxhon kompania juaj mbeturinat e materialeve në procesin e prodhimit? (Pyetje e shumëfishtë)	99
Figura 87. Si i menaxhon kompania juaj mbeturinat e materialeve në procesin e prodhimit? Krahësimi 2024—2025 (Pyetje e shumëfishtë)	100
Figura 88. Nëse po, sa herë i grumbullojnë mbeturinat e materialit?	100
Figura 89. Cilat janë llojet kryesore të mbeturinave që gjeneroni gjatë procesit të punës?	101
Figura 90. Cilat janë llojet kryesore të mbeturinave që gjeneroni gjatë procesit të punës? Krahësimi 2024-2025	102
Figura 91. Sa ton mbeturina tekstili gjeneron kompania juaj në vit?	103
Figura 92. A ka kompania juaj një sistem për ripërdorimin e materialeve të mbetura brenda procesit të prodhimit?	104
Figura 93. Ju lutem përshkruani shkurtimisht sistemin për ripërdorimin e materialeve të mbetura brenda procesit të prodhimit?	105
Figura 94. A keni dëgjuar për konceptin e ekonomisë qarkore?	106
Figura 95. Sa jeni të shqetësuar për ndotjen që veprimtaria e kompanisë suaj shkakton në mjedis?	107

Figura 96. A jeni të gatshëm të investoni në përmirësimin e praktikave për të reduktuar ndikimin mjedisor dhe gjurmët e karbonit?	108
Figura 97. A jeni të gatshëm të investoni në përmirësimin e praktikave për të reduktuar ndikimin mjedisor dhe gjurmët e karbonit? Krahasimi 2024-2025	109
Figura 98. Për kompanitë eksportuese në BE: A jeni të gatshëm të investoni për të përmbushur kriteret mjedisore që kërkohen për eksport?	110
Figura 99. A është kompania juaj aktualisht e përfshirë në ndonjë iniciativë ripërdorimi dhe riciklimi për mbeturinat pas prodhimit?	110
Figura 100. A është kompania juaj aktualisht e përfshirë në ndonjë iniciativë ripërdorimi dhe riciklimi për mbeturinat pas prodhimit? Krahasimi 2024-2025	111
Figura 101. Nëse jo, pse nuk jeni të përfshirë?	112
Figura 102. A bashkëpunon kompania juaj me ndonjë kompani riciklimi për menaxhimin e mbeturinave të tekstilit?.....	113
Figura 103. A do të ishte e interesuar kompania juaj për të bashkëpunuar me një kompani riciklimi që specializohet në menaxhimin e mbeturinave të veshjeve?	113
Figura 104. Ju lutem specifikoni pengesat kryesore që ka kompania juaj në lidhje me bashkëpunimin me një kompani të riciklimit.	115
Figura 105. A do të ishte e interesuar kompania juaj për të bashkëpunuar me një kompani riciklimi që specializohet në menaxhimin e mbeturinave të veshjeve? Krahasimi 2024—2025	115
Figura 106. Cilat zgjidhje për menaxhimin e mbeturinave do të preferonte kompania juaj? (Pyetje e shumëfishtë)	116
Figura 107. Cilat zgjidhje për menaxhimin e mbeturinave do të preferonte kompania juaj? Krahasimi 2024-2025 (Pyetje e shumëfishtë)	117
Figura 108. A ka kompania juaj në plan për të zbatuar ndonjë iniciativë të re për të përmirësuar menaxhimin e mbeturinave dhe mirëmbajtjen e ambientit?	117
Figura 109. A do të ishit të hapur për të siguruar informacion shtesë ose për të marrë pjesë në diskutimet e mëtejshme lidhur me menaxhimin e mbeturinave dhe iniciativat e riciklimit në kompaninë tuaj?	118
Figura 110. A do të ishit të hapur për të siguruar informacion shtesë ose për të marrë pjesë në diskutimet e mëtejshme lidhur me menaxhimin e mbeturinave dhe iniciativat e riciklimit në kompaninë tuaj? Krahasimi 2024—2025	119
Figura 111. A merr pjesë kompania juaj në panaire të tekstilit dhe teknologjisë për tekstil?	119
Figura 112. A merr pjesë kompania juaj në panaire të tekstilit dhe teknologjisë për tekstil?	120
Figura 113. A do të ishit të interesuar të merrnit informacione për panaire dhe konferenca që lidhen me veprimtarinë tuaj?	121
Figura 114. A do të ishit të interesuar të merrnit informacione për panaire dhe konferenca që lidhen me veprimtarinë tuaj? Krahasimi 2024—2025	121

Figura 115. A do të ishit të interesuar që të angazhoni stafin tuaj në trajnime për riciklim të tekstilit?	122
Figura 116. A do të ishit të interesuar që të angazhoni stafin tuaj në trajnime për riciklim të tekstilit? Krahasimi 2024—2025	123

LISTA E TABELAVE

Tabela 1. Numri i punëtorëve në sektorin e tekstilit sipas komunave	26
Tabela 2. Specifikoni vendin ku? (I dhuroj për riciklim)	66
Tabela 3. Specifikoni vendin ku dhe nese keni dyqan? (I shes në tregje të dorës së dytë)	68
Tabela 4. Specifikoni vendin ku? (I dhuroj për riciklim)	73
Tabela 5. Specifikoni vendin ku dhe nëse keni dyqan? (I shes në tregje të dorës së dytë)	74
Tabela 6. A është kompania juaj e gatshme të fillojë me riciklim dhe të zbatojë praktikrat e ekonomisë qarkore?	106
Tabela 7. A do të ishit të interesuar për pjesëmarrje në trajnime për ekonominë qarkore për biznesin dhe punëtorët tuaj?	106

PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

Ky hulumtim është zhvilluar si pjesë e projektit **“Kthimi i Vlerave në Ekonominë Qarkore”**, i zbatuar nga **Rilindja e Gjellbër** përmes programit **“Fuqizimi i OSHC-ve Mjedisore në Kosovë”** menaxhuar nga **Community Development Fund (CDF)** dhe i mbështetur financiarisht nga **Ambasada Suedeze në Prishtinë**. Për këtë qëllim Rilindja e Gjellbër ka kontraktuar UBO Consulting për të realizuar vlerësimin vjetor në industrinë e tekstitit dhe menaxhimin e mbeturinave të tekstitit në Kosovë.

Raporti aktual është realizuar në vitin 2025 dhe përfaqëson vazhdimësi të vlerësimit të realizuar në vitin 2024. Përveç analizimit të të dhënave të mbledhura gjatë vitit 2025, raporti përfshin edhe krahasime dhe analiza ndërmjet viteve 2024 dhe 2025, me qëllim të identifikimit të ndryshimeve, trendeve dhe zhvillimeve kryesore në sektorin e tekstitit dhe në praktikën e menaxhimit të mbeturinave të tekstitit. Po ashtu, aty ku është e përshtatshme, raporti trajton edhe ndërlidhjet dhe korrelacionet ndërmjet indikatorëve të ndryshëm, duke ofruar një pasqyrë më të thelluar mbi faktorët që ndikojnë në sjelljet, praktikën dhe qëndrimet e qytetarëve dhe bizneseve ndaj ekonomisë qarkore.

Qëllimi kryesor i këtij projekti është të promovojë dhe lehtësojë kalimin nga modeli linear ekonomik “merre-prodho-hidhe” në një ekonomi qarkore që rigjeneron burimet, me fokus në sektorin e tekstitit. Projekti gjithashtu synon të forcojë kulturën e konsumimit të përgjegjshëm dhe të rrisë ndërgjegjësimin për ripërdorim, riciklim dhe reduktim të mbeturinave.

Për të mbështetur këtë qëllim është përdorur një metodologji e kombinuar që përfshin: rishikim të dokumenteve strategjike, legjislative dhe literaturë shtesë, anketa me 400 qytetarë, intervista me 100 biznese nga sektori i tekstitit nga vende të ndryshme të Kosovës dhe intervista me katër (4) politikbërës kyç. Të dhënat e mbledhura ndihmojnë në kuptimin e sasisë së tekstitit të importuar, prodhuar dhe trajtuar në Kosovë, duke identifikuar gjithashtu praktikën aktuale të menaxhimit të mbeturinave të tekstitit.

Rezultatet e këtij studimi paraqesin bazë të fortë për ndërmarrjen e politikave dhe praktikave të reja që synojnë zhvillimin e qëndrueshëm të sektorit të tekstitit dhe përfshirjen aktive të parimeve të ekonomisë qarkore në Kosovë.

1. HYRJE

Industria e tekstilit dhe veshjeve në Kosovë vazhdon të përfaqësojë një sektor me rëndësi për zhvillimin ekonomik, punësimin dhe potencialin për transformim të qëndrueshëm. Në një kontekst ku ekonomia qarkore po merr gjithnjë e më shumë vëmendje në politikat publike, në tregjet evropiane dhe në praktikatat e biznesit, sektori i tekstilit paraqet një fushë të rëndësishme për ndërhyrje, duke qenë se lidhet drejtpërdrejt me prodhimin, konsumin, ripërdorimin, riciklimin dhe menaxhimin e mbeturinave.

Ky raport është realizuar si pjesë e vlerësimit vjetor për vitin 2025 në kuadër të projektit “Kthimi i Vlerave në Ekonominë Qarkore”, i zbatuar nga Rilindja e Gjelbër përmes programit “Fuqizimi i OSHC-ve Mjedisore në Kosovë”, menaxhuar nga Community Development Fund (CDF) dhe i mbështetur financiarisht nga Ambasada Suedeze në Prishtinë. Për këtë qëllim, Rilindja e Gjelbër ka kontraktuar UBO Consulting për të realizuar hulumtimin mbi industrinë e tekstilit dhe menaxhimin e mbeturinave të tekstilit në Kosovë.

Raporti i këtij viti ndërtohet mbi bazën e raportit të realizuar në vitin 2024, por nuk kufizohet vetëm në përditësimin e të dhënave ekzistuese. Ai është përshtatur për të pasqyruar zhvillimet, të dhënat dhe gjetjet e vitit 2025, duke përfshirë gjithashtu analiza krahasuese ndërmjet viteve 2024 dhe 2025. Përmes këtyre krahasimeve, raporti synon të identifikojë ndryshimet në sjelljet e qytetarëve, praktikatat e bizneseve, nivelin e informimit, gatishmërinë për riciklim dhe ripërdorim, si dhe zhvillimet institucionale dhe ekonomike që lidhen me sektorin e tekstilit. Në rastet ku të dhënat e lejojnë, raporti përfshin edhe analiza të marrëdhënieve ndërmjet indikatorëve kryesorë, për të kuptuar më mirë faktorët që ndikojnë në tranzicionin drejt ekonomisë qarkore.

Qëllimi kryesor i projektit është të promovojë dhe lehtësojë kalimin nga modeli linear “merre-prodho-hidhe” drejt një modeli më të qëndrueshëm dhe qarkor, ku produktet dhe materialet mbahen në përdorim për një kohë më të gjatë përmes ripërdorimit, riparimit, riciklimit dhe reduktimit të mbeturinave. Në këtë drejtim, raporti trajton jo vetëm gjendjen aktuale të sektorit, por edhe mundësitë për përmirësimin e praktikave ekzistuese dhe për forcimin e rolit të institucioneve, bizneseve dhe qytetarëve në menaxhimin më të qëndrueshëm të tekstilit.

Mbeturinat e tekstilit, të cilat shpesh përfundojnë në deponi ose trajtohen brenda sistemit të përgjithshëm të mbeturinave, vazhdojnë të paraqesin sfidë për mjedisin dhe për zhvillimin e një ekonomie më të qëndrueshme. Mungesa e infrastrukturës së specializuar për riciklimin e tekstilit, niveli ende i kufizuar i vetëdijes për konsum të qëndrueshëm, mungesa e skemave të qarta për ndarje dhe grumbullim të tekstilit, si dhe boshllëqet në politikat specifike për këtë nënsektor e bëjnë të nevojshme analizën e vazhdueshme të gjendjes dhe identifikimin e masave konkrete për përmirësim.

Në këtë kontekst, raporti shqyrton ciklin e produkteve të tekstilit në Kosovë, duke filluar nga importi, prodhimi dhe furnizimi, deri te përdorimi, ripërdorimi, riciklimi dhe menaxhimi pas përdorimit. Përveç analizës së sektorit nga perspektiva ekonomike dhe institucionale, raporti përfshin edhe të dhëna nga qytetarët, bizneset dhe politikbërësit, duke ofruar një pasqyrë më të plotë mbi sjelljet, kapacitetet, sfidat dhe mundësitë për zhvillimin e ekonomisë qarkore në industrinë e tekstilit.

Rezultatet dhe rekomandimet e këtij raporti synojnë të shërbejnë si bazë për ndërhyrje të mëtejshme nga institucionet publike, sektori privat, shoqëria civile, donatorët dhe aktorët e tjerë relevantë. Përmes analizës së gjetjeve të vitit 2025 dhe krahasimit me vitin 2024, raporti ofron një mundësi për të kuptuar progresin e arritur, sfidat që mbeten dhe hapat e nevojshëm për të ndërtuar një sektor të tekstilit më konkurrues, më të qëndrueshëm dhe më të përgjegjshëm ndaj mjedisit.

2. METODOLOGJIA

Për realizimin e vlerësimit vjetor të industrisë së tekstilit dhe praktikave të menaxhimit të mbeturinave të tekstilit në Kosovë për vitin 2025 është përdorur një qasje metodologjike e kombinuar, e cila ka përfshirë analizë të burimeve sekondare, mbledhje të të dhënave primare me qytetarë dhe biznese, si dhe intervista me përfaqësues institucionalë. Kjo qasje është përshtatur për raportin e këtij viti me qëllim që të pasqyrojë jo vetëm gjendjen aktuale të sektorit në vitin 2025, por edhe ndryshimet dhe zhvillimet krahasuar me vitin 2024. Në këtë mënyrë, raporti mundëson analizimin e trendeve ndërmjet dy viteve, identifikimin e ndryshimeve në sjelljet dhe qëndrimet e qytetarëve, vlerësimin e praktikave të bizneseve, si dhe shqyrtimin e zhvillimeve institucionale dhe ekonomike që ndikojnë në tranzicionin drejt ekonomisë qarkore në sektorin e tekstilit.

Në fazën e parë është realizuar rishikimi i dokumenteve strategjike, legjislative dhe literaturës relevante për industrinë e tekstilit, menaxhimin e mbeturinave dhe ekonominë qarkore. Kjo fazë ka shërbyer për të përditësuar kuadrin analitik të raportit dhe për të identifikuar zhvillimet më të fundit në politikat publike, rregulloret, strategjitë dhe nismat që lidhen me sektorin. Në kuadër të kësaj analize janë shqyrtuar:

- politikat dhe korniza ligjore dhe rregullative që rregullojnë prodhimin, menaxhimin e mbeturinave dhe qëndrueshmërinë në sektorin e tekstilit;
- strategjitë, masat dhe nxitjet qeveritare që lidhen me zhvillimin e industrisë së tekstilit dhe ekonominë qarkore;
- marrëveshjet, standardet dhe orientimet ndërkombëtare që ndikojnë në këtë industri, përfshirë ato të Bashkimit Evropian;
- dokumentet dhe të dhënat relevante të publikuara gjatë periudhës së fundit, me qëllim përditësimin e analizës për vitin 2025.

Për të ndërtuar profilin ekonomik të sektorit janë analizuar të dhënat nga **Dogana e Kosovës** dhe **Agjencia e Regjistrimit të Bizneseve të Kosovës**. Këto të dhëna janë përdorur për të vlerësuar strukturën e bizneseve në industrinë e tekstilit, punësimin, importin, eksportin dhe qarkullimin tregtar. Për raportin e këtij viti, këto të dhëna janë trajtuar edhe në funksion të krahasimit me vitin paraprak, aty ku informacioni ka qenë i disponueshëm dhe metodologjikisht i krahasueshëm.

Për të kuptuar qëndrimet, sjelljet dhe praktikat e qytetarëve ndaj konsumit të tekstilit, ripërdorimit, riciklimit dhe menaxhimit të mbeturinave, është realizuar një anketë kuantitative me 400 qytetarë të moshës mbi 18 vjeç në Kosovë, përmes panelit të hulumtimeve. Mostra është përzgjedhur në mënyrë të rastësishme, duke respektuar përfaqësimin gjinor, moshën dhe shpërndarjen gjeografike. Marzha e gabimit statistik është $\pm 4.9\%$ në një interval besimi prej 95%. Pyetësori ka përfshirë rreth 40 pyetje, kryesisht të mbyllura për analizë statistikore, si dhe disa pyetje të hapura për të kuptuar më mirë perceptimet dhe praktikat individuale. Mbledhja e të dhënave është realizuar në muajin shkurt 2026.

Për të mbledhur të dhëna të drejtpërdrejta nga sektori privat, janë realizuar 100 intervista me biznese që operojnë në industrinë e tekstilit në Kosovë. Bizneset janë përzgjedhur nga Regjistri i Bizneseve i ARBK-së dhe përfshijnë prodhues, shitës me shumicë dhe pakicë, importues, eksportues dhe kompani që ofrojnë shërbime të lidhura me sektorin e tekstilit. Intervistat kanë synuar të ofrojnë një pasqyrë më të qartë mbi aktivitetin e bizneseve, përdorimin e lëndëve të para, prodhimin, importin, eksportin, gjenerimin dhe trajtimin e mbeturinave, si dhe nivelin e përfshirjes në praktika të ripërdorimit, riciklimit dhe ekonomisë qarkore.

Vëmendje e veçantë i është kushtuar ndjekjes së ciklit të materialeve të tekstilit, nga furnizimi dhe prodhimi deri te menaxhimi i mbeturinave pas procesit të prodhimit. Të dhënat nga bizneset janë përdorur jo vetëm për të pasqyruar gjendjen aktuale të sektorit në vitin 2025, por edhe për të identifikuar sfidat, kapacitetet dhe gatishmërinë e bizneseve për të zbatuar praktika më të qëndrueshme. Aty ku ka qenë e mundur, këto të dhëna janë krahasuar me gjetjet e vitit 2024 për të evidentuar ndryshime në praktikën e sektorit.

Për të përfshirë perspektivën institucionale, janë realizuar katër intervista me përfaqësues të institucioneve kyçe që lidhen me menaxhimin e mbeturinave dhe politikën mjedisore në Kosovë. Intervistat janë zhvilluar me përfaqësues nga:

- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Departamenti për Menaxhim të Mbeturinave;
- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës;
- Kompania për Menaxhimin e Deponive të Kosovës;
- Departamenti i mbeturinave në Komunën e Gjakovës.

Këto intervista kanë ndihmuar në identifikimin e sfidave institucionale, boshllëqeve në politika, kufizimeve në zbatim dhe mundësive për mbështetje të mëtejshme të sektorit. Për raportin e këtij viti, perspektiva institucionale është përdorur edhe për të kuptuar nëse ka pasur zhvillime të reja krahasuar me vitin paraprak, veçanërisht në raport me politikën për ekonominë qarkore, ndarjen e mbeturinave, riciklimin dhe trajtimin e tekstilit si rrjedhë specifike e mbeturinave.

Analiza e të dhënave është realizuar duke kombinuar përshkrimin statistikor të rezultateve të vitit 2025 me krahasime ndërmjet viteve 2024 dhe 2025, aty ku pyetjet, indikatorët dhe burimet e të dhënave kanë qenë të krahasueshme. Për disa indikatorë janë shqyrtuar edhe marrëdhëniet ndërmjet variablave, me qëllim identifikimin e lidhjeve të mundshme ndërmjet njohurive, qëndrimeve dhe praktikave të qytetarëve dhe bizneseve në raport me ekonominë qarkore. Në këtë mënyrë, metodologjia e përdorur synon të ofrojë një bazë të qëndrueshme analitike për vlerësimin e progresit, sfidave dhe mundësive të sektorit të tekstilit në Kosovë gjatë vitit 2025.

2.1 LIMITIMET E RAPORTIT

Pavarësisht përpjekjeve për të siguruar një analizë gjithëpërfshirëse dhe të besueshme, ky raport përmban disa kufizime që duhet të merren parasysh gjatë interpretimit të rezultateve. Një nga sfidat kryesore ka qenë mungesa e të dhënave të plota, të përditësuara dhe të standardizuara për industrinë e tekstilit dhe menaxhimin e mbeturinave në Kosovë. Në disa raste, informacioni ishte i fragmentuar ose nuk ekzistonte fare, gjë që ka ndikuar në thellësinë dhe saktësinë e disa analizave.

Një tjetër kufizim ka të bëjë me përfaqësueshmërinë e mostrës. Edhe pse janë respektuar kriteret statistikore në përzgjedhjen e qytetarëve dhe bizneseve të anketuara, ekziston rreziku që disa aktorë të rëndësishëm, sidomos ata që operojnë në mënyrë informale ose jashtë sistemit të regjistrimit zyrtar, të mos jenë përfshirë në mënyrë adekuate. Kjo mund të ketë ndikuar në pasqyrimin e plotë të realitetit në terren.

Gjithashtu, intervistat me politikbërës dhe përfaqësues të institucioneve përmbajnë elemente subjektiviteti, pasi bazohen në përvoja dhe perceptime individuale. Edhe pse këto kontribuojnë në ndërtimin e një panorame të përgjithshme, ato nuk mund të konsiderohen përfaqësuese për të gjitha nivelet institucionale apo për politikat zyrtare.

Së fundmi, mungesa e një politike të veçantë për menaxhimin e mbeturinave të tekstilit ka përbërë një pengesë në ndërtimin e një kornize të qartë analitike. Në mungesë të rregulloreve të dedikuara, analiza institucionale është mbështetur kryesisht në legjislacionin e përgjithshëm për menaxhimin e mbeturinave, gjë që ka kufizuar saktësinë e interpretimit të sfidave dhe nevojave specifike të këtij nënsektori.

3. ANALIZA E POLITIKAVE

Industria e tekstilit në Kosovë vazhdon të operojë në një mjedis të ndikuar nga globalizimi, integrimi gradual me tregjet evropiane, kërkesat për rritje të konkurrueshmërisë dhe presioni gjithnjë e më i madh për tranzicion të gjelbër. Edhe pse Kosova ende nuk ka një legjislacion të posaçëm për sektorin e tekstilit apo për mbeturinat tekstile si rrjedhë e veçantë e mbeturinave, sektori ndikohet drejtpërdrejt nga një kornizë më e gjerë industriale, tregtare, mjedisore dhe klimatike.

Në këtë kuadër, politikat dhe kornizat më të rëndësishme që ndikojnë në sektorin e tekstilit përfshijnë Politikën Industriale të Kosovës 2030, Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2030, kornizën ligjore për menaxhimin e mbeturinave, Udhërrëfyesin e Kosovës për Ekonominë Qarkore, Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2024–2035 dhe Planin e Veprimit 2024–2026, Ligjin për Ndryshimet Klimatike, skemat mbështetëse për bizneset prodhuese dhe përpunuese, si dhe kornizën rregullatore të Bashkimit Evropian për tekstilet e qëndrueshme, mbeturinat tekstile dhe përgjegjësinë e prodhuesit. Gjatë periudhës njëvjeçare 2024–2025, zhvillimet më të rëndësishme lidhen me avancimin e kornizës strategjike për menaxhimin e mbeturinave, miratimin e ligjit të parë për ndryshimet klimatike, përfshirjen më të qartë të ekonomisë qarkore në politikat publike, diskutimet më të avancuara për Përgjegjësinë e Zgjeruar të Prodhuesit, nënshkrimin e marrëveshjes tregtare me EFTA-n, si dhe përfshirjen e kriterëve të gjelbra në disa skema mbështetëse për bizneset prodhuese. Megjithatë, këto zhvillime ende nuk janë përkthyer në një politikë të posaçme për mbeturinat tekstile, gjë që mbetet boshllëku kryesor për sektorin.

Politika Industriale e Kosovës 2030 mbetet dokumenti kryesor orientues për zhvillimin industrial, duke e lidhur rritjen e prodhimit me transformimin strukturor, inovacionin, integrimin në tregje ndërkombëtare dhe rritjen e produktivitetit (Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë [MINT], 2023). Kjo politikë është në përputhje me Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2030, e cila e vendos zhvillimin ekonomik të qëndrueshëm, rritjen e mirëqenies dhe forcimin e kapaciteteve institucionale në qendër të vizionit afatgjatë të vendit (Zyra e Kryeministrit, 2023). Për industrinë e

tekstilit, këto dokumente janë të rëndësishme sepse krijojnë bazën për modernizim industrial dhe rritje të konkurrueshmërisë. Megjithatë, ato mbeten kryesisht korniza të përgjithshme dhe nuk përmbajnë ende masa të posaçme për menaxhimin e mbeturinave tekstile, ripërdorimin e materialeve, dizajnin qarkor apo përgjegjësinë e prodhuesit në sektorin e tekstilit.

Një nga zhvillimet më të rëndësishme gjatë periudhës 2024–2025 është avancimi i kornizës strategjike për menaxhimin e mbeturinave. Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave në Kosovë 2024–2035 dhe Plani i Veprimit 2024–2026 përmenden si dokumente kyçe të planifikimit në raportimin institucional për menaxhimin e mbeturinave, duke e orientuar Kosovën drejt përmirësimit të shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, forcimit të riciklimit, ndarjes në burim dhe përafrimit me standardet e Bashkimit Evropian (Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës [AMMK], 2025). Ky zhvillim është i rëndësishëm për industrinë e tekstilit sepse krijon bazën për një qasje më të integruar ndaj mbeturinave, por deri më tani nuk parasheh ende një regjim të veçantë për mbeturinat tekstile. Prandaj, edhe pse korniza e përgjithshme ka avancuar, tekstili vazhdon të trajtohet kryesisht brenda sistemit të përgjithshëm të mbeturinave, pa instrumente të dedikuara për grumbullim, ndarje, ripërdorim apo riciklim të specializuar.

Në planin ligjor, korniza bazë mbetet Ligji Nr. 04/L-060 për Mbeturina, i cili përcakton parimet e përgjithshme për parandalimin, reduktimin, ripërdorimin dhe trajtimin e mbeturinave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2012). Ky ligj është ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 08/L-071 në vitin 2022, ndërsa gjatë vitit 2024 është prekur edhe nga harmonizime procedurale me legjislacionin për procedurën e përgjithshme administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2024). Këto ndryshime tregojnë përditësim të kornizës ligjore, por nuk krijojnë ende një kategori të veçantë rregullimi për mbeturinat tekstile. Si rezultat, sektori i tekstilit vazhdon të përballet me mungesë të mekanizmave të qartë për ndarje në burim, mbledhje të veçantë dhe riciklim të specializuar të produkteve tekstile pas përdorimit.

Një zhvillim tjetër i rëndësishëm është miratimi i Ligjit Nr. 08/L-250 për Ndryshimet Klimatike në vitin 2024. Ky ligj përcakton detyrat dhe përgjegjësitë e institucioneve shtetërore për masat e zbutjes dhe përshtatjes ndaj ndryshimeve klimatike, koordinimin dhe monitorimin e rezultateve, si dhe përmbushjen e obligimeve që lidhen me marrëveshjet ndërkombëtare të aplikueshme për Kosovën (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, 2024). Ligji është relevant për sektorin e tekstilit sepse e vendos aktivitetin industrial dhe prodhues në një kontekst më të gjerë të reduktimit të ndikimit mjedisor, monitorimit të emetimeve dhe tranzicionit drejt një ekonomie më të qëndrueshme. Në këtë aspekt, periudha 2024–2025 shënon një avancim të rëndësishëm në kornizën klimatike të vendit, edhe pse ndikimi praktik i këtij ligji në sektorin e tekstilit varet nga aktet nënligjore, kapacitetet institucionale dhe zbatimi në praktikë.

Në fushën e ekonomisë qarkore, Udhërrëfyesi i Kosovës për Ekonominë Qarkore mbetet dokument kyç orientues. Ky dokument identifikon sektorë prioritarë për tranzicionin qarkor, duke përfshirë edhe prodhimin, shitjen me pakicë dhe sektorët kreativë, të cilët lidhen drejtpërdrejt me industrinë e tekstilit përmes prodhimit, dizajnit, konsumit, ripërdorimit dhe menaxhimit pas përdorimit (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës [MMPHI], 2023). Profili i ekonomisë qarkore për Kosovën, i publikuar në vitin 2024, gjithashtu konfirmon se Kosova ka filluar të ndërtojë një kornizë më të qartë për ekonominë qarkore, por se zbatimi praktik, monitorimi i progresit dhe përfshirja e sektorëve specifikë mbeten ende në zhvillim (European Topic Centre on Circular Economy and

Resource Use [ETC/CE], 2024). Për sektorin e tekstilit, kjo do të thotë se ekziston një bazë strategjike për ta trajtuar industrinë si pjesë të tranzicionit qarkor, por ende mungojnë instrumente konkrete sektoriale për ta bërë këtë tranzicion funksional.

Nga aspekti tregtar, Kosova vazhdon të ketë një regjim relativisht të hapur, të mbështetur nga Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit me Bashkimin Evropian, CEFTA, marrëveshja me Turqinë dhe marrëveshja e partneritetit tregtar me Mbretërinë e Bashkuar (MINT, 2023). Një zhvillim i ri gjatë periudhës së raportimit është nënshkrimi i Marrëveshjes së Tregtisë së Lirë ndërmjet Kosovës dhe EFTA-s më 22 janar 2025. Sipas EFTA-s, marrëveshja u nënshkrua në Davos dhe synon të forcojë marrëdhëniet ekonomike dhe tregtare ndërmjet Kosovës dhe shteteve të EFTA-s, ndërsa hyrja e saj në fuqi mbetet e lidhur me procedurat përkatëse të ratifikimit (European Free Trade Association [EFTA], 2025). Për sektorin e tekstilit, ky zhvillim mund të jetë i rëndësishëm për zgjerimin e mundësive të eksportit dhe integrimin në tregje të reja, megjithëse marrëveshjet tregtare nuk krijojnë në vetvete detyrime të drejtpërdrejta për praktika qarkore apo menaxhim të mbeturinave tekstile.

Në të njëjtën periudhë, janë vërejtur edhe sinjale më të qarta të lidhjes ndërmjet mbështetjes industriale dhe tranzicionit të gjelbër. Në vitin 2025, skemat e KIESA-s për ndërmarrjet prodhuese dhe përpunuese kanë synuar rritjen e kapaciteteve prodhuese, zgjerimin e pranisë së produkteve kosovare në tregjet vendore dhe ndërkombëtare, përmirësimin e bilancit tregtar, krijimin e vendeve të reja të punës dhe inkurajimin e pjesëmarrjes së bizneseve në ekonominë qarkore (Kosovo Investment and Enterprise Support Agency [KIESA], 2025). Kjo është relevante për industrinë e tekstilit sepse dokumentet e skemës për makineri prodhuese dhe përpunuese përfshijnë edhe sektorët e tekstilit, veshmbathjes dhe lëkurës, ndërsa elementet që lidhen me qëndrueshmërinë dhe ekonominë qarkore paraqiten si pjesë e orientimit të skemës (KIESA, 2025). Kjo tregon një avancim krahasuar me qasjen më tradicionale të mbështetjes industriale, sepse zhvillimi i prodhimit po fillon të lidhet më qartë me objektivat e gjelbra.

Një tjetër zhvillim që duhet theksuar për periudhën 2024–2025 lidhet me diskutimet për reformimin e ligjit për mbeturinat dhe përfshirjen e mekanizmave të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit. GIZ ka raportuar se diskutimet mbi Ligjin për Mbeturina dhe PZP kanë përfshirë institucione, biznese dhe akterë të tjerë, me qëllim forcimin e bazës ligjore dhe praktike për tranzicionin drejt një ekonomie më qarkore. Në këtë diskutim, zgjidhjet PZP janë trajtuar me fokus në tekstil dhe paketim, duke e bërë këtë zhvillim veçanërisht të rëndësishëm për sektorin e tekstilit (GIZ, 2025). Për industrinë e tekstilit, PZP mund të krijojë në të ardhmen mekanizma për ta zhvendosur një pjesë të përgjegjësisë për produktet pas përdorimit të prodhuesit, importuesit dhe shitësit. Megjithatë, deri në periudhën e raportimit, nuk ka ende një skemë funksionale të dedikuar për tekstin në Kosovë. Prandaj, PZP duhet të paraqitet si zhvillim potencial dhe si drejtim politik në avancim, jo si mekanizëm tashmë i zbatuar për sektorin e tekstilit.

Një dimension tjetër i rëndësishëm lidhet me përafrimin e Kosovës me zhvillimet rregullatore evropiane. Strategjia e BE-së për Tekstile të Qëndrueshme dhe Qarkore sinjalizon drejtimin në të cilin po lëvizin tregjet evropiane: produkte më të qëndrueshme, më të riparueshme, më të riciklueshme, më shumë transparencë për konsumatorin dhe përgjegjësi më e madhe për ndikimin mjedisor përgjatë ciklit jetësor të produktit (European Commission, 2022). Për prodhuesit kosovarë që synojnë integrim më të thellë në zinxhirët evropianë të vlerës, kjo nënkupton se standardet e cilësisë dhe çmimit nuk do të jenë më të mjaftueshme. Në të ardhmen, përputhshmëria me

kërkesat e gjelbra, gjurmën mjedisore, transparencën dhe qarkullimin e materialeve do të bëhet gjithnjë e më e rëndësishme.

Në këtë drejtim, Direktiva Kornizë për Mbeturinat e Bashkimit Evropian, e ndryshuar përmes Direktivës (EU) 2018/851, ka rëndësi të veçantë. Kjo direktivë vendos detyrimin që shtetet anëtare të BE-së të krijojnë sisteme të ndara për grumbullimin e tekstileve nga 1 janari 2025, duke e trajtuar tekstilin si fraksion që kërkon ndarje, grumbullim dhe menaxhim të veçantë (European Commission, 2025). Përveç grumbullimit të ndarë, kjo kornizë lidhet edhe me objektivat për përgatitjen për ripërdorim dhe riciklim, duke ndikuar kështu në të gjithë zinxhirin e vlerës së industrisë së tekstit. Në praktikë, kjo nënkupton se kompanitë do të duhet të orientohen gradualisht drejt dizajnit më të qëndrueshëm të produkteve, përdorimit më të madh të materialeve të ricikluara, prodhimit të artikujve më të riparueshëm dhe më të riciklueshëm, si dhe krijimit të kushteve që produktet të mund të rikthehen në përdorim ose të riciklohen pas përfundimit të ciklit të tyre të përdorimit.

Zhvillimi më i ri në nivel evropian është rishikimi i Direktivës Kornizë për Mbeturinat, i cili ka hyrë në fuqi në tetor 2025 dhe ka fokus të veçantë te mbeturinat ushqimore dhe tekstile. Sipas Komisionit Evropian, ky rishikim synon harmonizimin e rregullave për tekstilet e përdorura dhe mbeturinat tekstile në tregun e BE-së dhe forcimin e qasjes qarkore në këtë sektor (European Commission, 2025). Ky zhvillim tregon se politika evropiane për tekstilin po zhvendoset nga rekomandimet e përgjithshme drejt detyrimeve më konkrete për prodhuesit, importuesit dhe vendosësit e produkteve në treg.

Për Kosovën, këto zhvillime nuk përbëjnë ende detyrim të drejtpërdrejtë ligjor të brendshëm, por paraqesin standarde të rëndësishme për përafrim, sidomos duke pasur parasysh orientimin e vendit drejt harmonizimit me standardet evropiane dhe integritetin në tregjet e BE-së. Nëse Kosova përafrohet me këtë kornizë, aplikimet praktike për vendin do të ishin të rëndësishme. Së pari, tekstili do të duhej të njihet ligjërisht si fraksion specifik i mbeturinave dhe të integrohet në planet kombëtare dhe komunale të menaxhimit të mbeturinave. Së dyti, komunat dhe operatorët e mbeturinave do të duhej të zhvillonin sisteme për grumbullim të ndarë, pika dorëzimi dhe mekanizma për klasifikim të tekstileve të përdorura. Së treti, bizneset do të duhej të raportonin më saktë sasinë e produkteve të vendosura në treg dhe mbeturinat e gjeneruara, ndërsa prodhuesit, importuesit dhe shitësit do të mund të përfshiheshin në skema PZP për financimin e grumbullimit, klasifikimit dhe riciklimit të tekstit. Kjo do të krijonte një zhvendosje të rëndësishme nga modeli aktual, ku barra kryesore bie mbi komunat dhe sistemin publik të mbeturinave, drejt një modeli ku përgjegjësia ndahet edhe me aktorët ekonomikë.

Në këtë kuptim, politikat kryesore të rëndësishme për sektorin mund të grupohen në tri nivele. Së pari, korniza vendore industriale dhe zhvillimore, përfshirë Politikën Industriale 2030 dhe Strategjinë Kombëtare për Zhvillim 2030, krijon orientimin e përgjithshëm për modernizim, produktivitet dhe konkurrueshmëri. Së dyti, korniza mjedisore dhe e ekonomisë qarkore, përfshirë Ligjin për Mbeturina, Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2024–2035, Planin e Veprimit 2024–2026, Udhërrëfyesin për Ekonominë Qarkore dhe Ligjin për Ndryshimet Klimatike, krijon bazën për trajtimin e ndikimeve mjedisore të sektorit. Së treti, korniza evropiane, përfshirë Strategjinë e BE-së për Tekstile të Qëndrueshme dhe Qarkore, Direktivën Kornizë për Mbeturinat dhe zhvillimet e reja për PZP në tekstil, tregon drejtimin me të cilin Kosova pritet të përafrohet gradualisht.

Zhvillimet e periudhës 2024–2025 tregojnë se Kosova ka avancuar në nivel të dokumenteve strategjike, diskutimeve për reforma ligjore dhe përafrimit konceptual me ekonominë qarkore. Megjithatë, për sektorin e tekstilit, boshllëku kryesor mbetet zbatimi praktik. Ende nuk ka sistem të ndarë për grumbullimin e tekstileve, nuk ka skemë funksionale PZP për tekstilin, nuk ka statistika të dedikuara për këtë fraksion dhe nuk ka mekanizma të qëndrueshëm për financimin e riciklimit. Prandaj, obligimet e ardhshme për Kosovën, nëse vendi ndjek drejtimin e BE-së, do të kërkojnë jo vetëm ndryshim ligjor, por edhe investime në infrastrukturë, kapacitete komunale, raportim nga bizneset, skema financimi dhe partneritete funksionale me operatorët e ripërdorimit dhe riciklimit.

3.1 STRATEGJITË DHE NXITJET E QEVERISË

Industria e tekstilit në Kosovë vazhdon të përballet me mungesë të mbështetjes institucionale. Gjetjet e studimit të USAID-it mbeten një pikë e rëndësishme reference, pasi rreth 80% e bizneseve të anketuara raportuan se nuk kanë mbështetje institucionale, ndërsa 13% deklaruan se kanë përfituar vetëm mbështetje sporadike. Sipas të njëjtit studim, nëse do të ofroheshin burime institucionale, bizneset do t'i orientonin ato kryesisht drejt punësimit të punëtorëve të kualifikuar nga jashtë, përditësimit të teknologjisë dhe, në masë më të vogël, sigurimit të lëndëve të para (USAID, 2020). Përveç kësaj, bizneset vazhdojnë të mbështeten kryesisht në kreditë bankare për rritje, ndërsa qasja e kufizuar në kapital investues dhe kostoja e financimit mbeten barriera të rëndësishme për zgjerim dhe modernizim (USAID, 2020).

Gjatë viteve të fundit janë ndërmarrë hapa konkretë drejt zhvillimit të një ekonomie më të qëndrueshme dhe qarkore në Kosovë, përmes kombinimit të reformave ligjore, dokumenteve strategjike dhe projekteve zbatuese. Projekti "Shërbime të Qëndrueshme Komunale" (2017–2023), i zbatuar nga GIZ, kontribuoi në përmirësimin e shërbimeve komunale të menaxhimit të mbeturinave, përfshirë zgjerimin e mbulimit me shërbime dhe reduktimin e deponive ilegale. Këto përpjekje u pasuan nga miratimi i Strategjisë së Integruar për Menaxhimin e Mbeturinave 2021–2030, e cila për herë të parë vendosi objektiva të qarta kombëtare për zhvillimin e ekonomisë qarkore, në përputhje me politikat dhe prioritetet e Bashkimit Evropian.

Në vitet e fundit është forcuar edhe korniza institucionale dhe ligjore për veprim klimatik dhe ekonomi qarkore. Me miratimin e Ligjit për Ndryshimet Klimatike (Ligji Nr. 08/L-250) në janar 2024, janë vendosur struktura gjithëpërfshirëse të qeverisjes klimatike, përfshirë krijimin e Këshillit Kombëtar për Ndryshimet Klimatike, si mekanizëm koordinues ndërinstitutional, si dhe fillimin e procesit të hartimit të Strategjisë afatgjatë për Dekarbonizim. Paralelisht, është miratuar Strategjia e re për Menaxhimin e Mbeturinave 2024–2035, e cila zgjeron ndjeshëm ambicien e dokumenteve paraprake dhe parashikon investime të konsiderueshme në infrastrukturën për riciklim, reduktimin e mbeturinave

Vetëm dy nga bizneset e anketuara kanë raportuar plane për investime në aplikimin e teknologjisë për trajtim të mbeturinave.

që përfundojnë në deponi dhe përmirësimin e sistemeve të monitorimit dhe raportimit të të dhënave.

Në aspektin e zbatimit praktik, projekti “SEREC – Promovimi i ekonomisë qarkore si model i qëndrueshëm për zhvillimin e ndërmarrjeve sociale” ka kontribuar në promovimin e ekonomisë qarkore përmes mbledhjes, ripërpunimit dhe ripërdorimit të materialeve, përfshirë tekstilin, si dhe në nxitjen e sipërmarrjes sociale dhe rritjen e punësimit për grupe të marginalizuara (Rilindja Gjelbër, 2024). Në këtë kuadër, nisma 3R Thrift Store paraqet një shembull konkret të aplikimit të ekonomisë qarkore në sektorin e tekstilit, duke promovuar përdorimin e veshjeve të dorës së dytë, zgjatjen e jetës së produkteve tekstile dhe reduktimin e mbeturinave përmes ripërdorimit (Rilindja Gjelbër, 2025). Po ashtu,

Zhvillimi dhe zbatimi i politikave kombëtare që përafrohen me legjislacionin e BE-së është i domosdoshëm për të mundur tranzicionin e Kosovës drejt një ekonomie qarkore, ku produktet dizajnohen për jetëgjatësi, riciklimi promovohet, dhe mbeturinat trajtohen si burim i ri.

Rilindja Gjelbër është vlerësuar në kuadër të Circular Economy Awards 2025 për zhvillimin e qendrës së parë për riciklimin e tekstilit në Kosovë, duke treguar se modelet praktike të ripërdorimit, riciklimit dhe ndërmarrjes sociale tashmë kanë filluar të zhvillohen në nivel lokal (Western Balkans Circular Economy Hub, 2025). Krahas kësaj, projekti “Circular Economy for Green Transition in Kosovo”, i financuar nga Bashkimi Evropian dhe i zbatuar nga People in Need në bashkëpunim me Rilindja Gjelbër, ka synuar avancimin e tranzicionit drejt ekonomisë qarkore në Kosovë, me fokus në fuqizimin e organizatave të shoqërisë civile dhe ndërmarrjeve të vogla dhe të mesme gjatë periudhës 2023–2025 (European Union Office in Kosovo, 2025). Po ashtu, projekti “Circular Urban Development – Kosovo4Green”, i zbatuar nga GIZ në partneritet me Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, ka filluar në vitin 2024 dhe synon përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave dhe zhvillimit urban të qëndrueshëm përmes qasjeve të ekonomisë qarkore deri në vitin 2028 (GIZ, 2024). Këto iniciativa tregojnë se, megjithëse Kosova ende nuk ka një sistem të konsoliduar kombëtar për mbeturinat e tekstilit, ekzistojnë shembuj praktikë dhe institucional që mund të shërbejnë si bazë për modele pilot, partneritete lokale dhe zgjerim të ndërhyrjeve në nivel më të gjerë.

Megjithatë, pavarësisht këtyre zhvillimeve pozitive, mbeten sfida të rëndësishme strukturore dhe institucionale. Zbatimi i Udhërrëfyesit për Ekonominë Qarkore mbetet i kufizuar, ndërsa miratimi i Planit Kombëtar për Energji dhe Klimë (NECP) ka pësuar vonesa. Nivelet e riciklimit mbeten të ulëta, ndarja në burim nuk zbatohet në mënyrë sistematike, dhe mekanizmat si Sistemi për Rimbursimin e Depozitave, i cili është pritur të pilotohet në vitin 2025, ende nuk janë operacional. Në këtë kontekst, hartimi i Ligjit të Ri për Mbeturina (2024–2025) përfaqëson një hap të rëndësishëm drejt krijimit të një baze më të fortë ligjore për zbatimin e mekanizmave si Përgjegjësia e Zgjeruar e Prodhuesit, por kërkon kapacitete të shtuara institucionale, financiare dhe teknike për të siguruar zbatim efektiv.

3.2. MARRËVESHJET DHE STANDARDET NËRKOMBËTARE

Marrëveshjet dhe standardet ndërkombëtare përbëjnë një pjesë të rëndësishme të kornizës brenda së cilës zhvillohet industria e tekstilit në Kosovë. Për një sektor që lidhet me importin e lëndëve të para, prodhimin, eksportin, shitjen me pakicë dhe menaxhimin e produkteve pas përdorimit, integrimi në tregje rajonale dhe evropiane nuk nënkupton vetëm qasje më të lehtë tregtare, por edhe nevojë për përafrim gradual me standardet e qëndrueshmërisë, riciklimit, gjurmës mjedisore dhe ekonomisë qarkore.

Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit ndërmjet Kosovës dhe Bashkimit Evropian mbetet një nga instrumentet më të rëndësishme për zhvillimin ekonomik dhe tregtar të vendit. Ajo krijon bazën për një zonë të lirë tregtare ndërmjet Kosovës dhe BE-së dhe njëkohësisht e lidh zhvillimin e politikave të Kosovës me procesin e përafrimit me standardet dhe kërkesat e BE-së (European Union, 2016). Për industrinë e tekstilit, rëndësia e kësaj marrëveshjeje qëndron jo vetëm te lehtësimi i qasjes në tregun evropian, por edhe te presioni afatgjatë për përmirësimin e standardeve të prodhimit, cilësisë, sigurisë së produkteve dhe performancës mjedisore. Kjo bëhet edhe më e rëndësishme në kushtet kur politikat e BE-së po zhvendosen drejt produkteve më të qëndrueshme, zinxhirëve më transparentë të vlerës dhe menaxhimit më të përgjegjshëm të mbeturinave.

Në të njëjtën linjë, CEFTA dhe marrëveshjet e tjera rajonale vazhdojnë të jenë të rëndësishme për uljen e barrierave tregtare, forcimin e bashkëpunimit rajonal dhe lehtësimin e qarkullimit të mallrave. Në kuadër të Marrëveshjes së Stabilizim-Asocimit theksohen edhe zotimet e Kosovës në kontekstin e CEFTA-s, si instrument për të rritur integrimin ekonomik rajonal dhe aftësinë e rajonit për të tërhequr investime (European Union, 2016). Për sektorin e tekstilit, këto marrëveshje krijojnë mundësi për qarkullim më të lehtë të mallrave, bashkëpunim me furnitorë rajonalë dhe qasje në tregje të afërta. Megjithatë, CEFTA dhe marrëveshjet tregtare rajonale janë kryesisht instrumente tregtare dhe nuk krijojnë në vetvete standarde të detyrueshme për menaxhimin e mbeturinave tekstile, dizajnin qarkor apo përgjegjësinë e prodhuesit.

Deklarata e Sofjes për Agjendën e Gjelbër për Ballkanin Perëndimor e vendos ekonominë qarkore në qendër të tranzicionit të gjelbër të rajonit. Përmes kësaj deklarate, vendet e Ballkanit Perëndimor, përfshirë Kosovën, janë zotuar të ndjekin parimet e Marrëveshjes së Gjelbër Evropiane dhe të ndërmarrin hapa drejt zhvillimit të qëndrueshëm. Deklarata përfshin pesë fusha kryesore, ndër të cilat edhe ekonominë qarkore, dhe kërkon zhvillimin e strategjive të ekonomisë qarkore që marrin parasysh ciklin e plotë jetësor të produkteve, parandalimin e mbeturinave, menaxhimin modern të mbeturinave dhe riciklimin (Regional Cooperation Council [RCC], 2020). Për industrinë e tekstilit, kjo është veçanërisht relevante, pasi sektori lidhet drejtpërdrejt me konsumin intensiv të burimeve, gjenerimin e mbeturinave, ripërdorimin dhe nevojën për riciklim më të strukturuar.

Gjatë periudhës 2024–2025, rëndësia e Agjendës së Gjelbër për Ballkanin Perëndimor është reflektuar edhe në përpjekjet e Kosovës për të avancuar kornizën strategjike për menaxhimin e mbeturinave dhe ekonominë qarkore. Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2024–2035 dhe Plani i Veprimit 2024–2026 paraqesin një zhvillim të rëndësishëm në këtë drejtim, duke synuar përmirësimin e shërbimeve të menaxhimit të mbeturinave, forcimin e riciklimit, reduktimin e mbeturinave që përfundojnë në deponi dhe rritjen e rikuperimit të materialeve (Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës [MMPHI], 2025). Megjithatë, kjo kornizë mbetet ende e përgjithshme dhe nuk ofron instrumente të dedikuara për tekstin si rrjedhë e veçantë e mbeturinave.

Në nivel të Bashkimit Evropian, Plani i Veprimit për Ekonominë Qarkore mbetet një nga kornizat kryesore që udhëheq kalimin nga modeli linear i prodhimit dhe konsumit drejt një modeli ku produktet dhe materialet mbahen në përdorim sa më gjatë. Ky plan identifikon tekstilin si një nga zinxhirët kryesorë të produkteve me ndikim të lartë mjedisor dhe ekonomik, duke e lidhur sektorin me nevojën për dizajn më të qëndrueshëm, ritje të ripërdorimit, riciklimit dhe reduktimit të mbeturinave (European Commission, 2020). Për Kosovën, edhe pse ky plan nuk është drejtpërdrejt i detyrueshëm, ai shërben si pikë reference për përafrimin e politikave, veçanërisht për sektorët që synojnë qasje në tregun e BE-së.

Strategjia e BE-së për Tekstil të Qëndrueshëm dhe Qarkor është veçanërisht e rëndësishme për këtë sektor, sepse përcakton drejtimin e politikave evropiane për tekstilin në vitet në vijim. Strategjia parasheh që produktet tekstile të vendosura në tregun e BE-së të jenë më të qëndrueshme, më të riparueshme, më të ripërdorshme dhe më të riciklueshme, duke reduktuar varësinë nga prodhimi i shpejtë dhe jetëshkurtër i tekstileve (European Commission, 2022). Për prodhuesit, importuesit dhe shitësit kosovarë të tekstit, kjo do të thotë se konkurrueshmëria në tregjet evropiane do të varet gjithnjë e më shumë nga aftësia për t'u përshtatur me kërkesat e qëndrueshmërisë, transparencës dhe menaxhimit të ciklit jetësor të produkteve.

Një zhvillim veçanërisht i rëndësishëm gjatë periudhës 2024–2025 lidhet me forcimin e rregullave të BE-së për tekstilet e përdorura dhe mbeturinat tekstile. Shtetet Anëtare të BE-së kanë detyrim që nga viti 2025 të krijojnë sisteme të ndara të grumbullimit për tekstilet e përdorura, ndërsa rishikimi i Direktivës Kornizë për Mbeturinat synon harmonizimin e rregullave për tekstilet e përdorura dhe mbeturinat tekstile, si dhe forcimin e skemave të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit për tekstilet (European Commission, 2023, 2025). Ky zhvillim është shumë i rëndësishëm për Kosovën, sepse tregon drejtimin në të cilin po lëviz rregullimi evropian: nga menaxhimi i përgjithshëm i mbeturinave drejt sistemeve të veçanta për tekstilin, me më shumë përgjegjësi për prodhuesit dhe me kërkesa më të forta për grumbullim, klasifikim, ripërdorim dhe riciklim.

Po ashtu, Rregullorja e BE-së për Dërgesat e Mbeturinave synon të rregullojë më mirë lëvizjen ndërkufitare të mbeturinave dhe të kufizojë praktikën që zhvendosin barrën mjedisore jashtë BE-së (European Commission, 2021). Për sektorin e tekstit, kjo është e rëndësishme sepse tregjet evropiane po bëhen më të kujdesshme ndaj eksportit të tekstileve të përdorura dhe mbeturinave të tekstit drejt vendeve të treta. Për vende si Kosova, kjo nënkupton se në të ardhmen nuk do të mjaftojë vetëm importi, eksporti apo tregtimi i produkteve të tekstit do të bëhet gjithnjë e më e rëndësishme edhe aftësia për të dokumentuar trajtimin e qëndrueshëm të produkteve dhe mbeturinave përgjatë ciklit jetësor. Prandaj, është shumë me rëndësi që Kosova të rishikoj programet nacionale për parandalim të mbeturinave dhe të ndaloj importin e mbeturinave të tekstit dhe të veshmbathjeve të përdorura.

Pavarësisht rëndësisë së këtyre marrëveshjeve dhe standardeve ndërkombëtare, Kosova ende nuk ka zhvilluar një kornizë të plotë kombëtare të harmonizuar me dokumentet kryesore të BE-së për ekonominë qarkore në sektorin e tekstit. Mungesa e sistemeve të ndara për grumbullimin e tekstileve të përdorura, mungesa e një skeme funksionale PZP për tekstilin, kapacitetet e kufizuara për riciklim dhe mungesa e standardeve të qarta për dizajn qarkor e vendosin sektorin në një fazë të hershme të përafrimit. Kjo nuk përbën vetëm sfidë mjedisore, por edhe sfidë ekonomike, sepse prodhuesit dhe eksportuesit kosovarë që synojnë tregjet evropiane do të përballen gradualisht

me kërkesa më të larta për qëndrueshmëri, gjurmë mjedisore, transparencë dhe menaxhim të mbeturinave.

Në këtë kuptim, marrëveshjet si Marrëveshja e Stabilizim-Asocimit, CEFTA dhe Deklarata e Sofjes mbeten të rëndësishme për orientimin ekonomik, tregtar dhe mjedisor të Kosovës, ndërsa dokumentet e BE-së për ekonominë qarkore dhe tekstilet e qëndrueshme e përcaktojnë gjithnjë e më qartë standardin drejt të cilit duhet të lëvizë sektori. Krahasuar me vitin paraprak, periodha 2024–2025 tregon një avancim më të qartë të kornizës evropiane për tekstin, sidomos përmes detyrimit për grumbullim të ndarë të tekstileve, forcimit të qasjes ndaj PZP dhe presionit për menaxhim më të përgjegjshëm të mbeturinave të tekstilit. Për Kosovën, sfida kryesore mbetet përkthimi i këtyre orientimeve ndërkombëtare në politika, standarde dhe instrumente konkrete kombëtare për sektorin e tekstilit.

4. PROFILI EKONOMIK I INDUSTRIË SË TEKSTILIT

Industria e tekstilit në Kosovë paraqet një sektor me rëndësi në zhvillimin ekonomik dhe punësimin në vend. Ky seksion ofron një analizë të strukturës së sektorit përmes kategorizimit të bizneseve dhe ndikimit të tyre në tregun e punës. Të dhënat e përdorura për këtë pjesë janë siguruar nga ARBK. Në analizë janë përfshirë të gjitha bizneset që kanë të regjistruar së paku njërën nga aktivitetet e mëposhtme, të cilat përfaqësojnë hallkat kryesore të zinxhirit të vlerës në industrinë e tekstilit.

- Tregtia me pakicë e veshjeve në dyqane të specializuara
- Prodhimi i veshjeve të tjera të jashtme
- Tregtia me shumicë e tekstilit
- Prodhimi i veshjeve të tjera p.k.t
- Larja (pastrimi kimik) dhe tharja e tekstilit dhe produkteve të gëzofit
- Tregtia me shumicë e veshjeve dhe këpucëve
- Prodhimi i veshjeve të tjera dhe atyre plotësuese (dorëza, kapela, shalle etj.)
- Proceset përfundimtare të përpunimit të tekstilit
- Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e tekstilit, veshjeve, gëzofit, këpucëve dhe artikujve prej lëkure
- Aktivitetet e ndërmjetësimit për shitjen e lëndëve të para bujqësore, kafshëve të gjalla, lëndëve të para të tekstilit dhe mallrave gjysmë të gatshme
- Tregtia me pakicë në tezgja dhe tregje të tekstilit, veshjeve dhe këpucëve
- Prodhimi i artikujve të tekstilit të konfeksionuar përveç veshjeve
- Endja e tekstilit
- Prodhimi i veshjeve të tjera teknike dhe industriale
- Tregtia me shumicë e makinerive të industrisë dhe të makinave të qepjes dhe thurjes
- Prodhimi i artikujve nga gëzofi
- Prodhimi i makinerive për prodhimin e veshjeve dhe lëkurave

Për vlerësimin e aktivitetit tregtar ndërkombëtar të sektorit, janë analizuar të dhënat e siguruar nga Dogana e Kosovës për vitin 2025 (Dogana e Kosovës, 2025). Për vlerësimin e aktivitetit tregtar ndërkombëtar të sektorit, janë analizuar të dhënat e siguruar nga Dogana e Kosovës për vitin

2025 (Dogana e Kosovës, 2025). Analiza përfshin importin dhe eksportin e 346 kodeve tarifore, të cilat përmbledhin produkte të ndryshme të industrisë së tekstilit dhe që, për qëllim të analizës, janë klasifikuar si veshmbathje, aksesore dhe tekstil shtëpiak. Krahasuar me raportin paraprak, ku analiza përfshinte 330 kode tarifore, numri i kodeve është rritur për shkak të harmonizimit të analizës me versionin më të fundit të Tarifës së Integruar të Kosovës, përkatësisht TARIK 01.01.2025, si dhe përditësimit të listës së kodeve relevante për sektorin. Ky ndryshim nuk duhet interpretuar domosdoshmërisht si zgjerim real i menjëhershëm i sektorit, por si përditësim metodologjik dhe tarifor që synon përfshirje më të plotë të produkteve tekstile sipas nomenklaturës më të re. TARIK bazohet në Sistemin e Harmonizuar të Organizatës Botërore të Doganave dhe në Nomenklaturën e Kombinuar të Bashkimit Evropian, ndërsa përditësohet rregullisht për të reflektuar ndryshimet në legjislacion dhe në nomenklaturën tarifore. Këto të dhëna ndihmojnë në kuptimin e shkallës së qarkullimit tregtar dhe ndikimit të sektorit në ekonominë kombëtare.

4.1 KATEGORIZIMI I BIZNESEVE

Sektori ka shënuar një zgjerim të lehtë në përbërjen e aktiviteteve, por jo një transformim të thellë në strukturën e madhësisë së bizneseve. Dominimi i mikro-ndërmarrjeve mbetet pothuajse i pandryshuar, gjë që tregon se sektori vazhdon të jetë i fragmentuar dhe i përbërë kryesisht nga biznese me kapacitete të kufizuara për investime, zgjerim dhe modernizim. Megjithatë, rritja e peshës së prodhimit dhe ulja relative e tregtisë sugjerojnë një zhvendosje të lehtë drejt aktiviteteve me potencial më të madh për krijim të vlerës së shtuar. Ky zhvillim është i rëndësishëm për ekonominë qarkore, pasi përfshirja më e madhe e prodhimit mund të krijojë hapësirë për praktika më të strukturuar të menaxhimit të materialeve, reduktimit të mbetjeve dhe ripërdorimit brenda sektorit.

Sektori i tekstilit në Kosovë vazhdon të dominohet nga mikro-ndërmarrjet. Nga gjithsej 7,210 kompani të identifikuar, 98.6% janë mikro-ndërmarrje, 1.1% janë ndërmarrje të vogla, 0.2% janë ndërmarrje të mesme, ndërsa vetëm 0.1% janë ndërmarrje të mëdha. Krahasuar me vitin e kaluar, struktura mbetet pothuajse e njëjtë në thelb, pasi edhe atëherë sektori dominohej nga mikro-ndërmarrjet me 99.2%, çka tregon se zgjerimi i numrit të kompanive nuk është shoqëruar me një transformim të dukshëm në madhësinë e bizneseve.




Figura 1. Bizneset në industrinë e tekstit sipas kategorisë

Sektori vazhdon të dominohet nga tregtia, por me një peshë disi më të ulët se vitin e kaluar. Tregtia përfaqëson 71.0% të kompanive, prodhimi 25.3%, ndërsa shërbimet e pastrimit 3.7%. Krahësuar me vitin paraprak, kur tregtia zinte 77.3% dhe prodhimi vetëm 19.5%, vërehet një rritje e peshës së prodhimit dhe një ulje relative e dominimit të tregtisë. Kjo mund të nënkuptojë një pasqyrë më të plotë të sektorit në këtë version, por gjithashtu sugjeron se aktivitetet prodhuese kanë një rol më të madh sesa është reflektuar më herët.




Figura 2. Bizneset në industrinë e tekstit sipas llojit të aktivitetit

4.2 PUNËSIMI

Sipas analizës së përditësuar, sektori i tekstit ka gjithsej 13,897 punëtorë të regjistruar. Pjesa më e madhe e tyre është e përqendruar në komunën e Prishtinës me 27.6%, e ndjekur nga Prizreni me

11.6% dhe Ferizaj me 9.2%. Krahasuar me vitin e kaluar, numri total i punëtorëve është rritur ndjeshëm nga 7,181 në 13,897. Prishtina mban barrën kryesore me 27.6% të të gjithë punëtorëve, ndërsa pas saj renditen Prizreni me 11.6%, Ferizaj me 9.2%, Gjakova me 6.3% dhe Gjilani me 5.9%.

Tabela 1. Numri i punëtorëve në sektorin e tekstilit sipas komunave

Komuna	Përqindja e punëtorëve
Prishtinë	27.6%
Prizren	11.6%
Ferizaj	9.2%
Gjakovë	6.3%
Gjilan	5.9%
Viti	5.5%
Pejë	5.1%
Fushë Kosovë	3.7%
Podujevë	3.2%
Malishevë	2.6%
Obiliq	2.3%
Graçanicë	2.2%
Mitrovicë	2.2%
Glllogoc	1.7%
Vushtrri	1.6%
Lipjan	1.2%
Suharekë	1.0%
Rahovec	0.9%
Skenderaj	0.8%
Klinë	0.8%
Istog	0.6%
Kaçanik	0.6%
Mitrovicë Veriore	0.6%
Deçan	0.5%
Kamenicë	0.5%
Shtime	0.5%
Zubin Potok	0.3%
Dragash	0.2%
Leposaviq	0.2%
Mamushë	0.2%
Shtërpçë	0.1%
Hani i Elezit	0.1%
Klllokot	0.0%
Junik	0.0%
Novobërdë	0.0%
Zveçan	0.0%

Partesh	0.0%
Ranillug	0.0%

Punësimi vazhdon të përqendrohet kryesisht në disa nënsegmente të caktuara. Pjesa më e madhe e punëtorëve, 25.2%, punon në tregtinë me pakicë të tekstileve, ndërsa 22.4% janë të përqendruar në prodhimin e veshjeve dhe 18.9% në tregtinë me pakicë të veshjeve. Kjo do të thotë se mbi dy të tretat e punësimit në sektor lidhen me shitjen dhe prodhimin e drejtpërdrejtë të tekstileve dhe veshjeve. Për këtë tregues nuk është bërë krahasim i drejtpërdrejtë me vitin paraprak në nivel nënsegmentesh, pasi struktura e raportimit dhe kategorizimit të aktiviteteve nuk është plotësisht e njëjtë ndërmjet dy periudhave. Prandaj, të dhënat interpretohen vetëm si pasqyrë e shpërndarjes aktuale të punësimit brenda sektorit për vitin 2025, duke treguar se tregtia dhe prodhimi mbeten fushat kryesore ku përqendrohet punësimi.

4.3 IMPORTI DHE EKSPORTI

Të dhënat e paraqitura më poshtë janë marrë nga Dogana e Kosovës dhe i referohen vitit 2025. Analiza fokusohet në qarkullimin e mallrave në sektorin e tekstilit, duke përfshirë veshmbathjet, aksesoret dhe tekstin për përdorim shtëpiak. Qasja analitike mbështetet si në vlerën monetare të tregtisë, ashtu edhe në sasinë fizike të mallrave në kilogram, si dhe në shpërndarjen sipas shteteve partnere. Në këtë mënyrë, të dhënat nuk tregojnë vetëm strukturën e importeve dhe eksporteve, por edhe ndihmojnë në vlerësimin e potencialit për krijimin e mbeturinave të tekstilit në Kosovë.

Analiza e vlerës së mallrave sipas kategorive tregon se edhe gjatë vitit 2025 importi ka mbetur dukshëm më i lartë se eksporti në të gjitha grupet kryesore të produkteve. Peshën më të madhe e mbajnë veshmbathjet, me rreth 237.03 milionë euro import dhe 35.69 milionë euro eksport. Edhe te aksesoret diferenca mbetet shumë e thellë, me 17.08 milionë euro import kundrejt vetëm 0.47 milionë euro eksport. Te tekstili shtëpiak tabloja është e njëjtë, pasi importi arrin në 24.01 milionë euro, ndërsa eksporti mbetet në 5.37 milionë euro. Krahasuar me vitin 2024, ndryshimi më i

dukshëm është rritja e fortë e vlerës së importeve, veçanërisht te veshmbathjet, që sugjeron zgjerim të mëtejshëm të varësisë nga tregjet e jashtme.




Figura 3. Vlera e mallrave sipas kategorive për vitin 2025

Në analizë është veçuar edhe kategoria e veshjeve të përdorura, ku pabarazia mes importit dhe eksportit mbetet shumë e theksuar. Gjatë vitit 2025, importi i kësaj kategorie arrin në 1.80 milionë euro, ndërsa eksporti vetëm në 0.08 milionë euro. Gjatë vitit 2025, importi i kësaj kategorie arrin në 1.80 milionë euro, ndërsa eksporti vetëm në 0.08 milionë euro. Krahësuar me vitin paraprak, importi ka shënuar një rënie të lehtë nga rreth 1.9 milionë euro në 1.80 milionë euro, ndërsa eksporti është rritur nga rreth 44 mijë euro në rreth 80 mijë euro. Megjithatë, kjo nuk ndryshon strukturën bazë të tregtisë, pasi hyrja e veshjeve të përdorura në vend vazhdon të jetë shumëfish më e lartë sesa dalja e tyre.




Figura 4. Vlera e mallrave të veshjeve të përdorura për vitin 2025

Edhe kur tregtia lexohet në sasi fizike, pamja mbetet e njëjtë. Importet tejkalojnë ndjeshëm eksportet në çdo kategori, gjë që tregon se tregu vendor mbështetet kryesisht në mallra të ardhura nga jashtë. Te veshmbathjet, importi arrin në 14.71 milionë kg, ndërsa eksporti mbetet në 0.52 milionë kg. Te aksesorët, importi është 2.16 milionë kg dhe eksporti vetëm 0.03 milionë kg. Te tekstili shtëpiak, importi arrin në 4.69 milionë kg, ndërsa eksporti në 1.04 milionë kg. Fakti që disbalanca shfaqet njësoj si në vlerë ashtu edhe në sasi tregon se bilanci negativ tregtar në këtë sektor është i thellë dhe i qëndrueshëm. Kjo ka rëndësi të veçantë në aspektin mjedisor, pasi nënkupton hyrje të vazhdueshme të sasive të mëdha të tekstilit që në fund të ciklit të përdorimit mund të përfundojnë si mbeturina.

Krahasimi me vitin paraprak tregon se ndryshimet në tregtinë e tekstilit nuk kanë ndodhur në mënyrë të njëjtë në vlerë dhe në sasi. Në disa kategori, sidomos te veshmbathjet, vërehet rritje e vlerës së importit dhe eksportit, ndërkohë që sasia fizike e raportuar është më e ulët se në vitin 2024. Ky disproporcion tregon se vlera totale e tregtisë nuk është ndikuar vetëm nga volumi i mallrave në kilogram, por edhe nga çmimi mesatar për njësi, struktura e produkteve të tregtuara dhe lloji i mallrave që kanë hyrë apo dalë nga vendi. Rritja e vlerës krahas rënies së sasisë mund të sugjerojë një orientim më të madh drejt produkteve me vlerë më të lartë për kilogram, produkteve më të përpunuara, artikujve me çmim më të lartë apo ndryshimeve në çmimet e furnizimit në tregjet ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, rritja e kostove të përgjithshme dhe presionet çmimore mund të kenë ndikuar që qarkullimi monetar të rritet edhe pa rritje

proporcionale të sasisë fizike. Për këtë arsye, zhvillimet e vitit 2025 tregojnë më shumë rritje të vlerës financiare të tregtisë sesa zgjerim të njëjtë të volumit fizik të tekstileve.




Figura 5. Sasia e mallrave sipas kategorive për vitin 2025

Pjesa kryesore e sasisë së importuar vazhdon të përqendrohet te veshmbathjet, të cilat përbëjnë rreth 63.9% të totalit të importuar në këto kategori. Pas tyre renditet tekstili shtëpiak me 20.4%, aksesoret me 9.4% dhe veshjet e përdorura me 6.3%. Edhe pse pesha relative e veshmbathjeve është më e ulët se në vitin 2024, ato mbeten segmenti dominues dhe burimi kryesor i fluksit tekstil që hyn në Kosovë. Kjo është e rëndësishme, sepse një vëllim kaq i madh i produkteve të importuara krijon edhe potencial më të lartë për mbeturina tekstile, sidomos në mungesë të sistemeve të zhvilluara të riciklimit dhe ripërdorimit. Ndryshimi më domethënës këtu është se struktura e importit po bëhet disi më e shpërndarë edhe drejt kategorive të tjera, pa e lëkundur dominimin e veshmbathjeve.

Nëse shihet veçmas kategoria e veshjeve të përdorura, disproporcioni mbetet shumë i fortë edhe në aspektin sasior. Gjatë vitit 2025 janë eksportuar vetëm 0.05 milionë kg, ndërsa janë importuar 1.45 milionë kg. Krahësuar me vitin 2024, importi i kësaj kategorie është rritur, ndërsa eksporti mbetet shumë i ulët. Kjo sugjeron se veshjet e përdorura vazhdojnë të hyjnë në tregun vendor në sasi të mëdha, pa u riintegruar në mënyrë të plotë në një cikël qarkor, çka rrit rrezikun që një pjesë e konsiderueshme e tyre të përfundojë si mbeturina.




Figura 6. Sasia e mallrave të veshjeve të përdorura për vitin 2025

Shpërndarja tremujore e vlerës së tregtisë tregon se importet kanë qenë sistematikisht më të larta se eksportet gjatë gjithë vitit 2025. Kulmi i importeve është arritur në tremujorin e tretë me 77.40 milionë euro, ndërsa eksportet lëvizin nga 10.47 milionë euro në tremujori i parë deri në 14.09 milionë euro në tremujorin e katërt. Në krahasim me vitin e kaluar, ajo që bie më shumë në sy është rritja e importeve në të katër tremujorët, veçanërisht në gjysmën e dytë të vitit. Eksportet gjithashtu janë rritur, por jo në një masë që do të mund të ngushtonte ndjeshëm hendekun tregtar. Pra, ndryshimi më i fortë nuk është përmirësimi i bilancit, por zgjerimi i vetë volumit të tregtisë.




Figura 7. Vlera e mallrave sipas muajve për vitin 2025

E njëjta prije shfaqet edhe në sasinë e mallrave sipas tremujorëve. Importet arrijnë në 5.07 milionë kg në tremujorin e parë, 5.32 milionë kg në tremujorin e dytë, 7.10 milionë kg në tremujorin e tretë dhe 6.89 milionë kg në tremujorin e katërt. Eksportet mbeten shumë më të ulëta, me 0.69 milionë kg në tremujorin e parë, 0.70 milionë kg në tremujorin e dytë, 0.70 milionë kg në tremujorin e tretë dhe 0.91 milionë kg në tremujorin e katërt. Krahësuar me vitin 2024, rritja më e dukshme është te importet në tremujorin e tretë dhe të katërt, ndërsa te eksportet vërehet një përmirësim në fund

të vitit. Megjithatë, edhe ky përmirësim nuk ndryshon faktin që sasia e mallrave që hyn në vend mbetet shumë herë më e lartë se ajo që del.




Figura 8. Sasia e mallrave sipas muajve për vitin 2025

Sa i përket shteteve partnere, importet në vitin 2025 janë përqendruar kryesisht në disa tregje kyçe. Turqia kryeson me 114.61 milionë euro, e ndjekur nga Kina me 63.49 milionë euro dhe Bangladeshi me 37.49 milionë euro. Pas tyre renditen Maroku, Kamboxha, Mianmari, Pakistani, India, Vietnami dhe Spanja. Në raport me vitin 2024, ndryshimi më i madh është rritja shumë e fortë e peshës së Turqisë dhe Bangladeshit, ndërsa Bangladeshi shfaqet më dukshëm si një nga partnerët kryesorë. Kjo e përqendron edhe më shumë furnizimin e tregut vendor në disa shtete specifike, sidomos në tregje që furnizojnë mallra me volum të lartë.




Figura 9. Vlera e mallrave të importit sipas shteteve për vitin 2025

Kur analizohen importet sipas sasisë, shihet se renditja nuk përputhet plotësisht me atë të vlerës. Në vitin 2025, Kina del e para me 8.86 milionë kg, ndërsa Turqia renditet e dyta me 8.59 milionë kg. Pas tyre vjen Bangladeshi me 2.07 milionë kg. Kjo tregon se Turqia kryeson në vlerë, por Kina furnizon sasi më të madhe fizike. Në të njëjtën kohë, vende si Zvicra dhe Gjermania paraqiten me sasi relativisht të larta, pa qenë ndër partnerët kryesorë sipas vlerës, çka sugjeron se mallrat e importuara nga këto vende kanë çmim më të ulët për njësi ose një strukturë tjetër produktesh. Ky dallim mes vlerës dhe sasisë është i rëndësishëm, sepse tregon se jo të gjitha importet kanë të njëjtin profil ekonomik apo të njëjtin ndikim potencial në krijimin e mbeturinave.

2

Figura 10. Sasia e mallrave të importeve sipas shteteve për vitin 2025

Në krahasim me vitin 2024, të dhënat për vitin 2025 tregojnë vazhdimësi të të njëjtit model tregtar, ku importet dominojnë dukshëm ndaj eksporteve si në vlerë ashtu edhe në sasi. Disbalanca e identifikuar në vitin paraprak mbetet e pranishme edhe këtë vit, ndërsa dallimet ndërmjet vlerës dhe sasisë vazhdojnë të tregojnë se struktura, natyra e produkteve dhe çmimi për njësi ndikojnë në interpretimin e tregtisë së sektorit. Ndryshimi kryesor në vitin 2025 është se qarkullimi tregtar ka marrë peshë më të madhe financiare, pa sjellë një ndryshim të dukshëm në bilancin ndërmjet importeve dhe eksporteve. Në kuadër të ekonomisë qarkore, kjo e bën edhe më të nevojshme

ndërtimin e kapaciteteve për grumbullim, përpunim, riciklim dhe ripërdorim të tekstilit, në mënyrë që rritja e qarkullimit të mos përkthehet drejtpërdrejt në rritje të presionit mjedisor.

4.4 KONSIDERATA MJEDISORE

Sektori i prodhimit, përfshirë industrinë e tekstilit, përbën një ndër sektorët me ndikimin më të lartë mjedisor si në nivel global ashtu edhe në kontekstin e ekonomive të vogla dhe të hapura si Kosova. Industria e tekstilit karakterizohet nga përdorim intensiv i energjisë, konsum i lartë i ujit, përdorim i substancave kimike dhe emetime të konsiderueshme të CO₂ përgjatë ciklit jetësor të produkteve (Niinimäki et al., 2020). Modelet e prodhimit masiv dhe konsumi i përshpejtuar, të nxitura nga konkurrenca me çmime të ulëta, përforcojnë presionin mbi burimet natyrore dhe rrisin gjenerimin e mbeturinave tekstile.

Në nivel kombëtar, raportet mbi gjendjen e mjedisit tregojnë se menaxhimi i mbeturinave mbetet ndër sfidat kryesore mjedisore në Kosovë, me norma të kufizuara riciklimi dhe varësi të lartë nga deponimi (AMMK, 2023). Strategjia për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2024–2035 thekson nevojën për përmirësim të sistemeve të grumbullimit të ndarë dhe për zhvillimin e infrastrukturës për trajtimin e fraksioneve të veçanta të mbeturinave (Ministria e Mjedisit, 2025). Megjithatë, tekstili nuk trajtohet ende si një fraksion i veçantë me sistem të konsoliduar kombëtar të menaxhimit.

Të dhënat e Doganës së Kosovës për vitin 2025 tregojnë se mbi 24 milionë kilogram tekstile janë importuar, ndërsa eksportet kanë mbetur rreth 3 milionë kilogram (Dogana e Kosovës, 2025). Ky disproporcion strukturor nënkupton se një pjesë e madhe e tekstileve që hyjnë në vend përfundimisht do të menaxhohen brenda territorit të Kosovës, si në fazën post-konsum, pas përdorimit nga konsumatorët, ashtu edhe në fazën post-industriale, përmes mbeturinave që krijohen gjatë përpunimit, prerjes, qepjes apo proceseve të tjera të prodhimit. Në mungesë të sistemeve funksionale të riciklimit dhe ripërdorimit, kjo strukturë tregtare rrit presionin mbi sistemin e mbeturinave dhe potencialin për ndotje.

Studimet mbi ekonominë qarkore në Kosovë tregojnë se riciklimi kontribuon pozitivisht në rritjen ekonomike, por performanca aktuale e sektorit të riciklimit mbetet nën potencial për shkak të kufizimeve institucionale dhe infrastrukturore (Haliti Rudhani et al., 2025). Kjo sugjeron se zgjerimi i kapaciteteve të riciklimit të tekstilit mund të prodhojë përfitime të dyfishta: reduktim të presionit mjedisor dhe stimulim të aktivitetit ekonomik.

Një dimension tjetër mjedisor lidhet me cilësinë dhe jetëgjatësinë e produkteve. Studimet mbi modelet e konsumit të shpejtë tregojnë se produktet me jetëgjatësi të shkurtër përshpejtojnë ciklin e hedhjes dhe rrisin sasinë e mbeturinave (European Environment Agency, 2024). Nëse sektori vazhdon të konkurrojë kryesisht në bazë të çmimit, pa investime në cilësi dhe dizajn të qëndrueshëm, presioni mjedisor do të mbetet i lartë.

5. EKONOMIA QARKORE

Ekonomia qarkore përfaqëson një model ekonomik që synon të transformojë mënyrën se si prodhohen, konsumohen dhe menaxhohen produktet, duke minimizuar mbeturinat dhe duke

mbajtur materialet në përdorim për sa më gjatë (Ellen MacArthur Foundation, 2013). Ky model është konsoliduar në nivel evropian përmes Planit të Veprimit për Ekonominë Qarkore (European Commission, 2020) dhe Strategjisë për Tekstile të Qëndrueshme dhe Qarkore (European Commission, 2022).

Rishikimi i Direktivës Kornizë për Mbeturinat dhe hyrja në fuqi e detyrimeve për mbledhje të ndarë të tekstileve në vitin 2025 përforcojnë përgjegjësinë e shteteve për të krijuar sisteme funksionale për tekstilin si fraksion specifik (European Commission, 2023). Skemat e detyrueshme të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (PZP) për tekstilet synojnë të zhvendosin barrën financiare dhe organizative drejt prodhuesve, duke stimuluar dizajnin e produkteve më të qëndrueshme dhe më të riciklueshme. Nëse Kosova përafrohet gradualisht me këto parime, kjo mund të ndihmojë në ndërtimin e një sistemi më të strukturuar për ndarjen, grumbullimin, klasifikimin, ripërdorimin dhe riciklimin e tekstileve. Në këtë drejtim, aplikimi i skemave të Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (PZP) për tekstilin do të mund të krijonte një burim të qëndrueshëm financimi për proceset e grumbullimit, klasifikimit dhe riciklimit të mbeturinave tekstile, pasi në modelin PZP prodhuesit mbajnë përgjegjësi financiare dhe/ose organizative për menaxhimin e produkteve pas përdorimit. Në Kosovë, diskutimet e vitit 2025 mbi Ligjin për Mbeturina dhe PZP kanë përfshirë edhe zgjidhje për tekstilin dhe paketimin, por një skemë funksionale e PZP për tekstilin ende nuk është zbatuar (GIZ, 2025).

Në literaturën akademike, ekonomia qarkore konsiderohet një paradigmë që ndërthur dimensionin ekonomik, mjedisor dhe social të qëndrueshmërisë (Geissdoerfer et al., 2017). Megjithatë, hulumtime më të fundit theksojnë se vendet në zhvillim përballen me sfida specifike në implementim, përfshirë dobësitë institucionale dhe mungesën e tregjeve për materiale të ricikluara (Alite et al., 2023).

Në Kosovë, Udhërrëfyeni për Ekonominë Qarkore (Zyra e Kryeministrit, 2023) përfaqëson një hap strategjik, por zbatimi mbetet në fazë të hershme. Studimet mbi sjelljen konsumatore tregojnë se ndërgjegjësimi për ekonominë qarkore është në rritje, por ndryshimi i sjelljes kërkon mbështetje infrastrukturore dhe politika nxitëse (Bislimi & Dalloshi, 2025). Kjo tregon se tranzicioni drejt një sistemi qarkor kërkon një qasje të integruar që përfshin politikë industriale, legjislacion mjedisor dhe instrumente financiarë.

6. SFIDAT NË SEKTORIN E TEKSTILIT

Sektori i tekstit në Kosovë vazhdon të përballët me një sërë sfidash strukturore që kufizojnë rritjen, modernizimin dhe konkurrueshmërinë e tij. Një pjesë e këtyre sfidave janë të hershme dhe mbeten ende relevante, ndërsa një pjesë tjetër lidhen me kërkesat më të reja të tregut, tranzicionin e gjelbër dhe nevojën për integrim në zinxhirë më të avancuar të vlerës. Studimi i USAID-it mbi industrinë e veshjeve theksonte se mungesa e mbështetjes institucionale ishte një nga pengesat kryesore për zhvillimin e sektorit: rreth 80% e bizneseve të anketuara raportuan se nuk kishin mbështetje institucionale, ndërsa 13% deklaruan se kishin marrë vetëm mbështetje sporadike. I njëjti studim tregonte se, në rast të rritjes së mbështetjes, bizneset do ta orientonin atë kryesisht drejt punësimit të punëtorëve të kualifikuar, përditësimit të teknologjisë dhe sigurimit të lëndëve të para (USAID, 2020).

Një nga kufizimet kryesore të sektorit mbetet përqendrimi në prodhim me vlerë relativisht të ulët dhe integrimi ende i kufizuar në zinxhirë më të sofistikuar ndërkombëtarë të vlerës. Diagnostikimi i sektorit privat nga BERZH vëren se baza prodhuese e Kosovës mbetet e ngushtë dhe se eksportet e mallrave përbëhen kryesisht nga produkte me vlerë të ulët të shtuar dhe nivel të kufizuar sofistikimi. Për sektorin e tekstilit, kjo nënkupton se konkurrueshmëria shpesh mbështetet më shumë në koston dhe fleksibilitetin sesa në inovacion, brendim, dizajn apo specializim të avancuar të produktit, gjë që e bën sektorin më të ndjeshëm ndaj presionit të konkurrencës së jashtme dhe luhatjeve të tregut (European Bank for Reconstruction and Development [EBRD], 2022).

Qasja në financim mbetet një tjetër sfidë e rëndësishme, sidomos për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme. Edhe pse OECD vlerëson se Kosova ka bërë disa përmirësime në qasjen në financim përmes skemave të garancisë kreditore dhe linjave publike të kreditimit, ajo thekson se burimet alternative të financimit mbeten shumë të kufizuara dhe se ekonomia vazhdon të varet kryesisht nga financimi bankar tradicional. Kjo është veçanërisht problematike për sektorin e tekstilit, ku investimet në modernizim, certifikim, teknologji dhe procese të reja prodhuese kërkojnë kapital që shumë biznese të vogla nuk e sigurojnë lehtë. Për më tepër, mungesa e tregjeve më të zhvilluara të kapitalit dhe e instrumenteve më fleksibile të financimit e kufizon aftësinë e firmave për të kaluar nga prodhimi bazik në modele më inovative dhe me vlerë më të lartë të shtuar (Organisation for Economic Co-operation and Development [OECD], 2024).

Një sfidë po aq serioze lidhet me mungesën e fuqisë punëtore të kualifikuar dhe me mospërputhjen ndërmjet nevojave të industrisë dhe aftësive që ofron tregu i punës. Studimi më i ri për boshllëqet e aftësive në sektorin industrial në Kosovë thekson se sektori përballlet me mungesë të profileve teknike dhe menaxheriale, ndërsa në nënsektorin e tekstilit, veshmbathjes dhe lëkurës evidentohen kërkesa të dukshme për menaxherë të prodhimit, mbikëqyrës të prodhimit, operatorë makinerish tekstile dhe profile që lidhen me kontrollin e cilësisë, menaxhimin e linjës, efikasitetin dhe logjistikën. I njëjti burim tregon se nevojat e ardhshme të sektorit do të orientohen gjithnjë e më shumë drejt përdorimit të mjeteve digjitale, dizajnit me softuer, teknologjive të reja prodhuese dhe aftësive që lidhen me qëndrueshmërinë dhe inovacionin. Kjo do të thotë se problemi i fuqisë punëtore nuk është më vetëm mungesë numerike, por edhe mungesë e kompetencave të reja që kërkon transformimi i sektorit (RIINVEST Institute, 2024).

Sektori përballlet gjithashtu me konkurrencë të padrejtë nga ekonomia joformale. Ky problem nuk është specifik vetëm për tekstin, por e prek drejtpërdrejt edhe këtë industri, sidomos në tregun vendas. BERZH thekson se informaliteti i përhapur në shumë sektorë të ekonomisë në Kosovë pengon investimin dhe zhvillimin e biznesit, ndërsa firmat informale krijojnë konkurrencë të padrejtë për bizneset formale. Edhe Komisioni Evropian vëren se autoritetet kanë intensifikuar përpjekjet për të reduktuar sektorin informal, gjë që tregon se problemi mbetet aktual dhe i rëndësishëm edhe në periudhën më të fundit. Për sektorin e tekstilit, kjo konkurrencë e padrejtë ul hapësirën për investime afatgjata, dobëson formalizimin e punës dhe shton presionin mbi firmat që veprojnë sipas rregullave fiskale dhe ligjore (EBRD, 2022; European Commission, 2024).

Një tjetër sfidë në rritje është përshtatja me kërkesat mjedisore dhe me tranzicionin drejt ekonomisë qarkore. Kjo sfidë nuk lidhet vetëm me pajtueshmërinë ligjore, por edhe me konkurrueshmërinë e ardhshme të sektorit, sidomos për firmat që synojnë tregjet evropiane. Udhëzuesi i EU4Green për modelet qarkore të biznesit në Kosovë thekson se zhvillimi i modeleve qarkore pengohet nga

mungesa e vetëdijes, infrastruktura e kufizuar për menaxhimin e mbeturinave dhe riciklimin, kapacitetet e dobëta teknologjike, kostoja e lartë e teknologjisë dhe mungesa e qasjes në financim. Raporti i vitit 2025 mbi progresin e Agjendës së Gjelbër në Kosovë shton se riciklimi i mbeturinave komunale mbetet shumë i ulët, rreth 2.5%, ndarja në burim nuk zbatohet në mënyrë sistematike, ndërsa financimi për investime qarkore dhe infrastruktura e ripërdorimit janë ende të pamjaftueshme. Për sektorin e tekstilit, kjo nënkupton se kalimi drejt proceseve të ripërdorimit, ndarjes, grumbullimit dhe përpunimit të mbeturinave tekstile mbetet i vështirë pa investime shtesë dhe pa një kornizë më të fortë mbështetëse (EU4Green, 2024).

Këto kufizime ndikojnë edhe në gatishmërinë eksportuese të sektorit. Bizneset tekstile dhe të veshjeve në Kosovë nuk përballen vetëm me sfidën e prodhimit, por edhe me nevojën për të përmbushur standarde më të larta të cilësisë, certifikimit, afateve të furnizimit dhe fleksibilitetit të kërkuar nga tregjet ndërkombëtare. Në të njëjtën kohë, sektori operon në një mjedis ku zhvillimi i aftësive, digjitalizimi dhe kalimi drejt produkteve me vlerë më të lartë janë ende në proces. Kjo e bën të vështirë që shumë firma të kalojnë nga modele të thjeshta prodhimi në modele më të avancuara, të orientuara kah dizajni, specializimi ose prodhimi i qëndrueshëm (OECD, 2024; RIINVEST Institute, 2024).

Megjithatë, përkundër këtyre sfidave, sektori ka edhe mundësi reale zhvillimi. Avantazhet gjeografike të Kosovës, qasja preferenciale në tregje të rëndësishme dhe afërsia me tregun evropian mbeten faktorë me rëndësi për firmat që synojnë zgjerim në eksport. U.S. International Trade Administration vëren se pozita e Kosovës në zemër të Ballkanit ofron qasje të lehtë në tregjet fqinje dhe te CEFTA, ndërsa regjimi liberal tregtar dhe lidhjet me tregun e BE-së vazhdojnë të përbëjnë një avantazh strukturor. Në të njëjtën kohë, skema e granteve e KIESA-s e publikuar në vitin 2025 për blerjen e makinerive të avancuara prodhuese dhe përpunuese synon pikërisht transformimin strukturor drejt industrive më të integruara globalisht dhe prodhimit të produkteve me vlerë më të lartë të shtuar; sektorët e tekstilit, veshmbathjes dhe lëkurës përfshihen shprehimisht në këtë mbështetje. Kjo tregon se, ndonëse sfidat mbeten të mëdha, ekziston edhe një bazë më e qartë se më parë për modernizim teknologjik dhe rritje të konkurrueshmërisë së sektorit (International Trade Administration, 2026; Kosovo Investment and Enterprise Support Agency [KIESA], 2025).

Në këtë kuptim, sfidat strukturore të sektorit të tekstilit në Kosovë kanë ndikim të drejtpërdrejtë edhe në aftësinë e bizneseve për të zbatuar praktika të ripërdorimit dhe riciklimit të tekstilit. Mungesa e mbështetjes institucionale, varësia nga financimi bankar, boshllëqet në aftësi, konkurrenca joformale dhe infrastruktura e dobët për qarkullimin e materialeve e bëjnë më të vështirë investimin në modele më të qëndrueshme të prodhimit. Megjithatë, nëse adresohen në mënyrë të synuar, praktikat qarkore mund të shërbejnë jo vetëm si përgjigje mjedisore, por edhe si strategji zhvillimi për sektorin: ato mund të ndihmojnë në uljen e kostove të materialeve, krijimin e produkteve me vlerë më të lartë, hapjen e vendeve të reja të punës dhe rritjen e përputhshmërisë me kërkesat e tregjeve evropiane. Për këtë arsye, ekonomia qarkore nuk duhet parë vetëm si një obligim mjedisor, por si një mundësi konkrete për rritjen afatgjatë të konkurrueshmërisë së industrisë së tekstilit në Kosovë (EU4Green, 2024; KIESA, 2025).

7. REZULTATET NGA ANKETAT ME QYTETARË

Në vazhdim paraqiten rezultatet e anketës së realizuar me qytetarët, me qëllim të kuptimit të mendimeve dhe qëndrimeve të tyre në fusha të ndryshme. Përmes analizës së të dhënave të mbledhura, synohet të identifikohen tendencat kryesore dhe preferencat e pjesëmarrësve, duke mundësuar një pasqyrë më të qartë mbi çështjet e trajtuara.

7.1 DEMOGRAFIA

Mostra përbëhet nga 400 të anketuar, me një ndarje pothuajse të barabartë gjinore. Femrat përbëjnë 50.5% të të anketuarve, ndërsa meshkujt 49.5%, duke siguruar përfaqësim të balancuar gjinor në analizë.

Sa i përket statusit martesor, shumica e të anketuarve janë të martuar (67.6%), ndërsa 27.1% janë beqarë/beqare. Një pjesë shumë e vogël raportojnë se janë të divorcuar (0.4%), të ve (3.4%) ose jetojnë në bashkëjetesë (1.5%). Në aspektin e numri të anëtarëve në familje, të anketuarit jetojnë kryesisht në familje mesatare dhe të mëdha. Madhësitë më të shpeshta të familjes janë ato me katër anëtarë (25.9%) dhe pesë anëtarë (25.0%), të ndjekura nga familjet me gjashtë anëtarë (14.1%) dhe shtatë anëtarë (12.9%). Sa i përket të ardhurave mujore familjare, shpërndarja tregon se familjet më së shumti raportojnë të ardhura në intervalin 601–900 euro (21.0%), ndjekur nga 901–1,200 euro (13.4%) dhe 1,201–1,500 euro (12.9%).

59.2% e të anketuarve jetojnë në zona rurale, ndërsa 40.8% në zona urbane, duke reflektuar një përfaqësim më të lartë të popullsisë rurale në mostër. Në aspektin e arsimimit, niveli dominues është universitar (Bachelor) me 36.7%, i ndjekur nga Master (23.0%) dhe arsim i mesëm (24.4%).

Në lidhje me statusin e punësimit, shumica e të anketuarve janë të punësuar, kryesisht në sektorin privat (28.8%) dhe me kohë të plotë (21.6%), ndërsa 6.3% janë të vetëpunësuar. 14.6% raportojnë se janë të papunësuar dhe në kërkim të punës, 6.1% të papunësuar që nuk kërkojnë punë, ndërsa 6.9% janë studentë dhe 5.7% pensionistë.

Në aspektin e moshës, të anketuarit mbulojnë një gamë të gjerë moshe nga 18 deri në 66 vjeç, me përqendrim më të madh në grupmoshat aktive të punës, veçanërisht nga fundi i të 20-ave deri në mesin e të 50-ave, çka e bën mostrën të përshtatshme për analizimin e sjelljes së konsumatorëve në tregun e tekstit.

7.2 FURNIZIMI ME PRODUKTET E TEKSTILIT

Një element qendror i analizës është mënyra se si qytetarët blejnë dhe sigurojnë produkte tekstili. Ky seksion fokusohet në mënyrat e furnizimit me produkte tekstili, duke analizuar burimet kryesore të blerjeve dhe faktorët që ndikojnë në vendimet e konsumatorëve.

Krahasuar me vitin paraprak, rezultatet tregojnë se mënyra e furnizimit me veshmbathje ka mbetur kryesisht e qëndrueshme, me blerjen personale si formën dominuese në pothuajse të gjitha kategoritë. Në vitin 2025, kjo formë furnizimi është forcuar lehtë te disa kategori, si këpucët, ku është rritur nga 87.6% në 90.5%, bluzat/këmishat nga 86.0% në 88.6%, xhaketat/palltot nga 80.8% në 84.0% dhe produktet sportive nga 71.5% në 74.0%. Megjithatë, kjo rritje nuk është e njëjtë në të

gjitha kategoritë, pasi blerja personale ka rënë te çorapet nga 81.5% në 74.3%, si dhe pak te pantallonat/xhinset/fundet nga 87.0% në 85.2% dhe të brendshmet nga 90.6% në 88.8%.

Në të njëjtën kohë, blerjet nga familjarët janë bërë më pak të shpeshta në disa kategori bazë, si bluzat/këmishat, ku kanë rënë nga 21.4% në 15.1%, pantallonat/xhinset/fundet nga 16.7% në 13.9% dhe të brendshmet nga 14.1% në 12.1%. Megjithatë, kjo formë furnizimi është rritur te disa kategori me karakter më praktik ose me blerje më të përbashkët familjare, si këpucët nga 16.9% në 21.6% dhe çorapet nga 26.2% në 27.8%. Kjo sugjeron se, ndërsa konsumatorët vazhdojnë t'i blejnë vetë shumicën e veshmbathjeve, për disa produkte të përditshme ose funksionale roli i familjarëve mbetet ende i pranishëm.

Sa i përket ripërdorimit nga anëtarët e familjes, të dhënat tregojnë një rënie në shumicën e kategorive krahasuar me vitin 2024, përfshirë xhaketat/palltot nga 18.5% në 16.1%, bluzat/këmishat nga 10.7% në 8.4%, këpucët nga 11.2% në 9.1% dhe pantallonat/xhinset/fundet nga 9.7% në 7.9%. Kjo mund të tregojë një orientim pak më të madh drejt blerjes së produkteve të reja, ose një rol më të kufizuar të ripërdorimit familjar në furnizimin me veshmbathje. Në anën tjetër, opsioni "nuk i blej/përdori" mbetet i ulët në shumicën e kategorive, me ndryshimin më të dukshëm te produktet sportive, ku ka rënë nga 13.6% në 9.6%, duke sugjeruar një përdorim më të gjerë të kësaj kategorie në vitin 2025.

Në përgjithësi, ndryshimet ndërmjet dy viteve nuk tregojnë një zhvendosje të madhe në sjelljen e konsumatorit, por më shumë një vazhdimësi të modelit ekzistues të furnizimit. Blerja personale mbetet mënyra kryesore e sigurimit të veshmbathjeve, ndërsa ndryshimet më të dukshme lidhen

me rënien e blerjes personale te çorapet, rritjen e blerjes nga familjarët te këpucët dhe uljen e ripërdorimit familjar në shumicën e kategorive.




Figura 11. Si furnizoheni me produktet e mëposhtme të tekstilit – veshmbathje? (Pyetje e shumëfishtë)

Për aksesoret, modeli dominues mbetet blerja personale, ndërsa krahasuar me valën e kaluar vërehen disa ndryshime të lehta në burimet alternative të furnizimit. Te çantat, blerja personale mbetet pothuajse e pandryshuar (71.5% në valën aktuale kundrejt 71.2% më parë), ndërsa blerja nga familja është gjithashtu stabile. Megjithatë, ripërdorimi nga anëtarët e familjes është rritur (13.9% kundrejt 9.5%), duke treguar një përdorim më të shpeshtë të burimeve brenda familjes, ndërsa përqindja e atyre që nuk i blejnë ose nuk i përdorin ka rënë lehtë. Te kapelet, blerja personale ka shënuar një rënie të vogël krahasuar me valën e kaluar, por në të njëjtën kohë është rritur roli i familjarëve që i blejnë këto produkte për respondentët, si dhe është ulur përqindja e atyre që deklarojnë se nuk i blejnë apo nuk i përdorin. Te shallat dhe/ose dorezat, blerja personale është rritur lehtë nga 62.5% në 65.1%, ndërsa blerja nga familjarët është rritur nga 22.1% në 24.1%. Ripërdorimi nga anëtarët e familjes gjithashtu është rritur nga 6.2% në 10.0%. Ndërkohë, përqindja

e atyre që nuk i blejnë/përdorin ka rënë nga 17.0% në 10.8%, duke sugjeruar përdorim më të gjerë të kësaj kategorie në vitin 2025.




Figura 12. Si furnizoheni me produktet e mëposhtme të tekstitit – aksesorë? (Pyetje e shumëfishtë)

Për tekstin shtëpiak, modeli i furnizimit mbetet i qëndrueshëm edhe në këtë valë, me blerjen personale si mënyra dominuese për të gjitha kategoritë, por me disa zhvendosje të lehta krahasuar me valën e kaluar. Blerja personale është rritur për mbulesat e shtratit (nga 54.4% në 57.1%), qilimat (nga 44.7% në 50.2%) dhe perdet (nga 48.0% në 50.7%), ndërsa mbetet pothuajse e pandryshuar për mbulesat e tavolinave (rreth 50%). Te tekstili shtëpiak vërehen disa ndryshime të lehta në mënyrën e furnizimit. Blerja nga dikush nga familja ka rënë te mbulesat e shtratit nga 43.5% në 39.7%, por është rritur te mbulesat e tavolinave nga 43.2% në 45.4%, te qilimat nga 40.1% në 43.5% dhe te perdet nga 42.6% në 46.6%. Kjo sugjeron se, për shumicën e produkteve shtëpiake, vendimmarrja ose blerja nga familjarët mbetet e rëndësishme dhe në disa raste është bërë më e theksuar. Ripërdorimi nga anëtarët e familjes ka shënuar rritje të lehtë te mbulesat e shtratit nga 6.5% në 7.3%, te mbulesat e tavolinave nga 5.5% në 7.5% dhe te perdet nga 4.7% në 5.9%, ndërsa ka rënë te qilimat nga 5.3% në 4.2%. Ndërkohë, përqindja e atyre që nuk i blejnë/përdorin këto produkte ka mbetur e njëjtë te mbulesat e shtratit (3.5%), por ka rënë te mbulesat e tavolinave nga 6.7% në 5.7%, te qilimat nga 14.6% në 11.0% dhe te perdet nga 7.7% në 5.5%, duke sugjeruar përdorim më të gjerë të këtyre produkteve në vitin 2025.




Figura 13. Si furnizoheni me produktet e mëposhtme të tekstilit – shtëpiake? (Pyetje e shumëfishtë)

Rezultatet lidhur me shpeshtësinë e blerjes së produkteve të tekstilit tregojnë se ritmi i furnizimit ndryshon sipas llojit të produktit. Modelet e blerjes së produkteve të tekstilit mbeten përgjithësisht të ngjashme, por me disa zhvendosje të lehta në ritmin e blerjes sipas kategorive. Për veshjet bazë (maica, këmisha, bluza), blerja çdo 2–3 muaj vazhdon të dominojë (33.8% kundrejt 35.4%), ndërsa është vërejtur një rritje e blerjeve më të shpeshta gjatë muajit (22.5% nga 15.9%). Për veshjet e sipërme (xhaketa, pallto), blerja e rrallë mbetet karakteristike kryesore, me mbi katër në dhjetë raste që raportojnë blerje më rrallë se çdo 6 muaj (45.3% dhe 46.4%), duke reflektuar natyrën sezonale të këtyre produkteve. Një prirje e ngjashme shihet edhe te veshjet sportive dhe këpucët, ku blerjet e rralla vazhdojnë të zënë një peshë të konsiderueshme. Ndërkohë, për artikujt me përdorim të përditshëm si të brendshmet dhe çorapet, frekuenca mujore dhe ajo disa herë në muaj mbetet më e lartë krahasuar me kategoritë e tjera. Frekuenca e blerjes së veshmbathjeve në vitin 2025 mbetet përgjithësisht e ngjashme, me disa ndryshime të lehta sipas kategorive. Te çorapet, blerjet më të shpeshta, disa herë ose një herë në muaj, mbeten pothuajse në të njëjtin nivel, 53.1% në 2025 krahasuar me 54.7% në 2024. Te të brendshmet, kjo frekuencë është ritur nga 42.5% në 2024 në 50.4% në 2025, duke treguar blerje më të rregullta. Ndërkohë, te xhaketat/palltot dhe këpucët vazhdojnë të dominojnë blerjet më të rralla se çdo 6 muaj, përkatësisht 45.3% dhe 39.4% në vitin 2025, shumë afër niveleve të vitit paraprak. Ndryshimi më i dukshëm shihet te bluzat/këmishat, ku blerjet disa herë në muaj janë ritur nga 15.9% në 22.5%.




Figura 14. Sa shpesh i blini produktet e mëposhtme – veshmbathje?

Aksesorët, përfshirë çantat, kapelet dhe shallët/dorezat, vazhdojnë të blihen relativisht rrallë edhe në valën aktuale, në një linjë të ngjashme me valën e kaluar. Në matjen aktuale, blerjet më të rralla se çdo 6 muaj dominojnë për të gjitha kategoritë, me 46.6% për çantat, 50.2% për kapelet dhe 58.8% për shallët/dorezat, ndërsa në valën e kaluar këto përqindje ishin edhe më të larta (55.8%, 59.2% dhe 66.5%, përkatësisht). Krahësuar me valën e mëparshme, vërehet një rritje e lehtë e blerjeve më të shpeshta, veçanërisht në intervalin çdo 2–3 muaj për çantat (20.1% kundrejt 15.8%) dhe kapelet (15.8% kundrejt 10.6%), si dhe një prani pak më e lartë e blerjeve mujore. Megjithatë, këto ndryshime mbeten modeste dhe nuk ndryshojnë prirjen kryesore, sipas së cilës aksesorët trajtohen kryesisht si blerje sporadike dhe jo si produkte të konsumit të rregullt, me diferenca vetëm marginale mes dy valëve të matjes.




Figura 15. Sa shpesh i blini produktet e mëposhtme – aksesorë?

Për tekstilet shtëpiake vërehen lëvizje të moderuara në shpërndarjen e shpeshtësisë së blerjes. Për mbulesat e shtratit, blerjet shumë të shpeshta mbeten të kufizuara, ndërsa pjesa që i blen më rrallë (çdo 6 muaj ose më rrallë) rritet nga rreth 47% në mbi 51%. Një prirje e ngjashme shihet edhe te mbulesat e tavolinave, ku blerjet më të rralla kalojnë nga rreth 50% në mbi 57%. Te qilimat dhe perdet, blerjet rrallë dominuese mbeten të larta dhe shënojnë rritje të lehtë, duke arritur rreth dy të tretat e të anketuarve për qilimat dhe mbi 70% për perdet. Kjo tregon se tekstilet shtëpiake vazhdojnë të blihen kryesisht në intervale më të gjata kohore, me ndryshime të vogla në intensitetin e blerjes.




Figura 16. Sa shpesh i blini produktet e mëposhtme – shtëpiake?

Blerja e produkteve tekstile vazhdon të dominohet nga tregu vendor, me ndryshime kryesisht të lehta dhe selektive sipas kategorive. Për maica, këmisha dhe bluza, blerjet brenda Kosovës janë rritur nga 93.5% në 94.5%, ndërsa blerjet jashtë Kosovës janë rritur më ndjeshëm nga 12.9% në 16.7%, duke treguar një hapje të moderuar drejt burimeve alternative. Në kategorinë e xhaketa, palltove dhe jakneve, blerjet brenda Kosovës kanë rënë nga 90.8% në 87.0%, ndërsa ato jashtë Kosovës janë rritur nga 13.2% në 16.7%, duke sugjeruar një orientim më të madh drejt tregjeve të jashtme për këtë lloj produktesh. Për pantallona, xhinse dhe funde/fustane, modeli mbetet i qëndrueshëm, me një rënie minimale të blerjeve brenda Kosovës nga 91.2% në 90.8% dhe një ulje të lehtë të blerjeve jashtë Kosovës nga 12.3% në 11.5%. Të brendshmet vazhdojnë të blihen pothuajse ekskluzivisht brenda Kosovës, me përqindje pothuajse të pandryshuara (96.2% kundrejt 96.1%) dhe një rënie të blerjeve jashtë Kosovës nga 7.2% në 5.9%. Ndryshimi më i theksuar vërehet te produktet sportive, ku blerjet brenda Kosovës kanë rënë ndjeshëm nga 92.0% në 79.9%, ndërsa blerjet jashtë Kosovës kanë mbetur relativisht të qëndrueshme (11.2% kundrejt 10.6%). Për këpucë, çizme dhe patike, blerjet brenda Kosovës kanë rënë lehtë nga 92.6% në 91.0%, ndërsa ato jashtë Kosovës janë rritur nga 13.2% në 15.4%, ndërsa çorapet mbeten kategoria më e orientuar drejt tregut vendor, megjithëse me një rënie të lehtë të blerjeve brenda Kosovës nga 97.6% në 94.7% dhe një rritje minimale të blerjeve jashtë Kosovës nga 3.8% në 4.8%.




Figura 17. Ku i blen zakonisht produktet e mëposhtme të tekstilit – veshmbathje? (Pyetje e shumëfishtë)

Modelet e blerjes për aksesorët tregojnë ndryshime të dukshme krahasuar me valën e kaluar. ërehet një rënie e theksuar e blerjeve brenda Kosovës për të gjitha aksesorët, e shoqëruar me ulje paralele të blerjeve jashtë Kosovës, çka sugjeron një ngushtim të përgjithshëm të blerjes së këtyre produkteve. Për çanta, blerjet brenda Kosovës kanë rënë ndjeshëm nga 93.2% në 84.2%, ndërsa blerjet jashtë Kosovës janë ulur nga 11.6% në 8.9%. Një rënie edhe më e fortë vërehet te kapelet, ku blerjet brenda Kosovës kanë zbritur nga 92.9% në 73.4% dhe blerjet jashtë Kosovës nga 11.1% në 3.7%. Po ashtu, për shall dhe/ose dorëza, blerjet brenda Kosovës kanë rënë nga 94.2% në 81.1%, ndërsa blerjet jashtë Kosovës nga 9.8% në 4.8%. Në tërësi, ndryshe nga kategoritë bazike të tekstilit,

aksesorët shfaqin një tkurrje të dukshme të blerjes në të dy drejtimet, duke sugjeruar se këto produkte mund të jenë më pak prioritet për konsumatorët në valën aktuale.




Figura 18. Ku i blen zakonisht produktet e mëposhtme të tekstilit – aksesorë? (Pyetje e shumëfishtë)

Edhe në këtë valë, blerja brenda Kosovës mbetet qartësisht dominuese për tekstilet shtëpiake, megjithëse vërehet një rënie e lehtë krahasuar me valën e kaluar. Furnizimi brenda vendit për mbulesat e shtratit zbret nga 97.5% në 91.2%, për mbulesat e tavolinave nga 96.0% në 89.2%, për qilimat nga 99.4% në 87.2%, ndërsa për perdet nga 99.0% në 91.8%. Paralelisht, blerjet jashtë Kosovës shënojnë një rritje të vogël, por mbeten marginale në të gjitha kategoritë.




Figura 19. Ku i blen zakonisht produktet e mëposhtme të tekstilit – shtëpiake? (Pyetje e shumëfishtë)

Blerjet jashtë Kosovës vazhdojnë të përqendrohen kryesisht në Gjermani (37.3%), e cila mbetet destinacioni kryesor edhe në valën aktuale, me një peshë shumë të ngjashme me atë të valës së kaluar. Zvicra (16.4%) ruan pozicionin e dytë, megjithëse me një prani më të kufizuar krahasuar me Gjermaninë. Vende të tjera si Anglia (10.0%), Shqipëria (7.8%) dhe Turqia (7.6%) përmenden më rrallë dhe mbeten zgjedhje dytësore në të dyja valët. Në përgjithësi, struktura e vendeve ku realizohen këto blerje mbetet stabile ndërmjet valëve, pa zhvendosje të dukshme drejt destinacioneve të reja.




Figura 20. Në cilat vende jashtë Kosovës i bën këto blerje?

Krahasimi me valën e kaluar tregon disa ndryshime në arsyt pse të anketuarit vendosin t'i blejnë produktet e tekstilit jashtë Kosovës. Perceptimi se cilësia e produkteve jashtë Kosovës është më e mirë mbetet arsyeja kryesore, megjithëse ka shënuar rënie nga 57.9% në valën e kaluar në 53.4% në valën aktuale. Edhe vlerësimi se çmimet janë të arsyeshme në raport me cilësinë është ulur lehtë, nga 45.2% në 41.9%. Arsyeja që në Kosovë nuk gjenden produktet e kërkuara ka shënuar rritje, nga 32.6% në 36.6%. Ndërkohë, rëndësia e modeleve më të reja jashtë vendit ka pësuar rënie, nga 22.0% në 13.9%. Ndërsa preferenca për marka ndërkombëtare dhe reputacioni i dyqaneve ndërkombëtare kanë pësuar rritje krahasuar me valën e kaluar. Kategoria “tjetër” gjithashtu shënon rritje, nga 13.1% në 22.4%, duke sugjeruar diversifikim të arsyeve të deklaruara nga të anketuarit.



Figura 21. Pse këto produkte vendosni ti blini jashtë Kosovë? (Pyetje e shumëfishtë)

Të dhënat krahasuese ndërmjet valës aktuale dhe asaj të mëparshme tregojnë se blerjet e produkteve të tekstilit realizohen kryesisht në dyqane fizike për të gjitha kategoritë, me përqindje që në valën aktuale variojnë nga 85.8% për veshjet sportive deri në 95.9% për çorapet. Krahasuar me valën e kaluar, blerjet online shënojnë rritje në disa kategori, si xhaketat dhe palltot (nga 16.7% në 20.8%) dhe këpucët, çizmet dhe patiket (nga 20.7% në 20.9%), ndërsa për veshjet sportive blerjet online mbeten relativisht të larta, megjithëse me një rënie të lehtë (nga 25.1% në 22.4%). Për të brendshmet dhe çorapet, blerjet online mbeten në nivele të ulëta në të dyja valët, duke kaluar nga 5.4% në 10.4% për të brendshmet dhe nga 5.9% në 9.8% për çorapet.




Figura 22. Si i blen zakonisht produktet e mëposhtme të tekstit – veshmbathjet? (Pyetje e shumëfishtë)

Krahasimi i dy valëve tregon se dyqanet fizike mbeten kanali kryesor i blerjes së aksesorëve, por blerjet online janë në rritje në të gjitha kategoritë. Për shall/doreza, blerjet online janë rritur nga 11.8% në valën e kaluar në 17.7% në valën aktuale, ndërsa blerjet në dyqane fizike kanë rënë lehtë nga 92.8% në 90.8%. Një prirje e ngjashme vërehet për kapelet, ku blerjet online janë rritur nga 9.4% në 14.0%, ndërsa blerjet fizike kanë rënë nga 93.1% në 90.2%. Ndryshimi më i theksuar vërehet te çantat, ku blerjet online janë rritur ndjeshëm nga 22.1% në 32.7%, ndërsa blerjet në dyqane fizike kanë rënë nga 87.5% në 81.5%.




Figura 23. Si i blen zakonisht produktet e mëposhtme të tekstit – aksesorë? (Pyetje e shumëfishtë)

Analiza krahasuese mes valës aktuale dhe asaj të kaluar tregon se blerja në dyqane fizike vazhdon të jetë forma mbizotëruese për tekstin e shtëpisë, por njëkohësisht po vërehet një rritje graduale e orientimit drejt blerjeve online. Te qilimat, pjesa e blerjeve online është rritur nga 9.1% në 12.8%, ndërsa blerjet në dyqane fizike kanë zbritur nga 93.6% në 90.4%, duke sinjalizuar një hapje të lehtë ndaj kanalit digjital. Një zhvillim i ngjashëm shfaqet edhe te perdet, ku blerjet online janë rritur nga 9.1% në 13.8%, paralelisht me rënien e blerjeve fizike nga 95.5% në 89.7%. Kalimi drejt online bëhet më i dukshëm te produktet më të standardizuara. Për mbulesat e tavolinave, blerjet online janë rritur ndjeshëm nga 13.7% në 21.5%, ndërsa blerjet në dyqane fizike kanë rënë nga 93.7% në 87.4%. Tendenca është edhe më e fortë te mbulesat e shtratit (çarçafët, mbulesa jastëkësh, jorgan), ku blerjet online kanë kaluar nga 19.5% në 25.1%, duke u shoqëruar me një rënie të blerjeve fizike nga 90.6% në 85.4%.




Figura 24. Si i blen zakonisht produktet e mëposhtme të tekstil – shtëpiake? (Pyetje e shumëfishtë)

Rezultatet nga krahasimi i dy valëve sugjerojnë se qendrat tregtare vazhdojnë të përbëjnë pikën kryesore të realizimit të blerjeve, me një rritje nga 88.0% në 91.5%, duke reflektuar një përqendrim edhe më të madh të konsumatorëve në këto hapësira. Preferenca për dyqanet ndërkombëtare të njohura (p.sh. Zara, H&M, Mango) mbetet kryesisht e qëndrueshme, me një rënie të lehtë nga 39.7% në 38.8%. Në të njëjtën kohë, blerjet përmes dyqaneve online kanë shënuar rritje nga 32.3% në 36.6%, duke treguar një përdorim gjithnjë e më të zakonshëm të këtij kanali. Ndryshime më të moderuara vërehen te format e tjera të blerjes. Dyqanet e lagjes kanë pësuar një rënie të lehtë (nga 17.8% në 16.8%), ndërsa dyqanet e dorës së dytë (second hand) kanë shënuar rritje nga 11.1% në 14.0%, duke reflektuar interes në rritje për këtë lloj blerjeje. Tregjet e hapura (pazar) mbeten relativisht të qëndrueshme, me një ulje të vogël nga 13.7% në 12.4%, ndërsa kategoria “tjetër” vazhdon të ketë peshë minimale (nga 0.5% në 0.6%).




Figura 25. Në çfarë lloj dyqanesh zakonisht i bëni këto blerje? (Pyetje e shumëfishtë)

Krahasimi ndërmjet valës aktuale dhe asaj të kaluar tregon se struktura e platformave të përdorura për blerje online mbetet praktikisht e pandryshuar, duke reflektuar stabilitet në preferencat e konsumatorëve. Në të dyja valët, Zara Online mbetet platforma më e përdorur për blerje online (33.5%), e ndjekur nga rrjetet sociale me 30.9%, duke konfirmuar rolin e tyre të rëndësishëm si kanale të drejtpërdrejta të shitjes dhe promovimit. GjirafaMall renditet në vendin e tretë me 17.4%, duke ruajtur pozicionin si një nga platformat kryesore lokale për blerje online. Platformat ndërkombëtare si Amazon (4.9%) dhe Foleja (3.7%) kanë një përdorim më të kufizuar, ndërsa pjesa tjetër e platformave (Intersport, Topshop, AliExpress, Zalando, Shein, Temu, etj.) mbeten në nivele shumë të ulëta, secila nën 2%, pa ndryshime të dukshme nga vala e kaluar.




Figura 26. Në cilat platforma i bëni zakonisht blerjet online?

Në valën aktuale, produktet si maicat/këmishat/bluzat, pantallonat/fundet, të brendshmet dhe çorapet blihen pothuajse ekskluzivisht të reja (mbi 96–98%), duke reflektuar një prirje të qëndrueshme që ishte e pranishme edhe në valën e kaluar. Kjo tregon se për këto kategori, tregu i produkteve të ripërdorura mbetet shumë i kufizuar. Nga ana tjetër, ashtu si edhe më parë, veshjet sportive dhe këpucët/çizmet/patiket dallohen si kategoritë ku blerjet second-hand janë relativisht më të pranishme. Në valën aktuale, 15.1% e veshjeve sportive dhe 10.9% e këpucëve blihen të ripërdorura, duke reflektuar një vazhdimësi të prirjes së identifikuar edhe në valën e kaluar, me një hapje pak më të madhe ndaj këtij segmenti. Blerjet e produkteve të ricikluara mbeten shumë të ulëta në të gjitha kategoritë (zakonisht nën 3%), pa sinjale për ndryshim domethënës krahasuar me valën e kaluar. Kjo sugjeron se, pavarësisht diskutimeve mbi qëndrueshmërinë, ky segment ende nuk është integruar gjerësisht në sjelljen konsumatore.




Figura 27. Çfarë lloji te produkteve te mëposhtme te tekstilit blini – veshmbathje? (Pyetje e shumëfishtë)

Produktet e reja vazhdojnë të dominojnë blerjet e aksesorëve, megjithatë vërehen ndryshime të lehta në rolin e produkteve të ripërdorura dhe të ricikluara. Te çantat, blerja e produkteve të reja mbetet shumë e lartë, megjithëse ka një rritje të lehtë nga 92.1% në 92.8%. Paralelisht, blerjet second-hand janë rritur nga 11.4% në 14.7%, ndërsa blerjet e produkteve të ricikluara kanë shënuar rritje më të dukshme, nga 1.3% në 4.0%, duke sugjeruar një hapje graduale ndaj alternativave më të qëndrueshme në këtë kategori. Për kapelet, pjesa e produkteve të reja është rritur ndjeshëm nga 93.9% në 97.3%, ndërsa blerjet second-hand kanë rënë nga 9.8% në 4.2% dhe produktet e ricikluara mbeten në nivele shumë të ulëta (nga 0.5% në 1.2%). Te shallat dhe/ose dorezat, blerja e produkteve të reja është rritur nga 95.3% në 97.9%, ndërsa blerjet second-hand janë rritur lehtë nga 6.0% në 7.2%. Blerjet e produkteve të ricikluara, megjithatë, kanë rënë nga 0.8% në 0.0%, duke mbetur praktikisht të papërfillshme.




Figura 28. Çfarë lloji te produkteve te mëposhtme te tekstilit blini – aksesorë? (Pyetje e shumëfishtë)

Produktet e reja vazhdojnë të dominojnë blerjet e tekstilit për shtëpi, me disa ndryshime të lehta në përdorimin e produkteve second-hand dhe të ricikluara. Te mbulesat e shtratis, pjesa e produkteve të reja është rritur nga 96.0% në 98.1%, ndërsa blerjet second-hand kanë rënë nga 3.6% në 2.4% dhe ato të ricikluara nga 1.9% në 0.7%. Për mbulesat e tavolinave, produktet e reja janë rritur lehtë (95.8% në 96.9%), ndërsa blerjet second-hand janë rritur nga 4.8% në 6.7% dhe ato të ricikluara nga 0.5% në 0.8%. Ndryshimi më i dukshëm vërehet te qilimat, ku blerjet e produkteve të reja kanë rënë nga 97.3% në 94.4%, ndërsa blerjet second-hand janë rritur nga 3.5% në 7.2% dhe ato të ricikluara nga 0.4% në 1.0%. Te perdet, blerjet e produkteve të reja janë rritur nga 96.5% në 97.2%, blerjet second-hand kanë rënë nga 3.5% në 2.9%, ndërsa produktet të ricikluara janë rritur nga 0.2% në 1.4%.




Figura 29. Çfarë lloji të produkteve të mëposhtme të tekstilit blini – shtëpiake? (Pyetje e shumëfishtë)

Krahasimi ndërmjet valës aktuale dhe asaj të kaluar tregon se blerja e produkteve second-hand realizohet kryesisht në dyqane fizike, me ndryshime shumë të vogla ndërmjet dy valëve. Në valën aktuale, 87.1% e blerësve të produkteve të ripërdorura i blejnë ato në dyqan fizik, krahasuar me 89.1% në valën e kaluar, duke treguar një rënie shumë të lehtë. Në të njëjtën kohë, blerjet online janë rritur nga 10.9% në valën e kaluar në 12.9% në valën aktuale. Në përgjithësi, të dhënat sugjerojnë se, edhe pse dyqanet fizike mbeten kanali dominues për blerjet second-hand, kanali online po fiton gradualisht terren, por ende në nivele relativisht të ulëta.




Figura 30. Si i blini zakonisht produktet e ripërdorura (second-hand) të tekstilit?

Rezultatet tregojnë se arsyet kryesore për mosblerjen e produkteve second-hand mbeten kryesisht të njëjta, megjithëse me disa zhvendosje në peshën relative të tyre krahasuar me matjen e

mëparshme. Perceptimi se produktet e ripërdorura nuk janë të pastra apo higjienike është forcuar, duke u rritur nga 44.0% në 50.7%, dhe mbetet arsyeja më e shpeshtë për shmangien e këtij lloji blerjeje. Po ashtu, mospëlqimi ndaj idesë së përdorimit të diçkaje të përdorur nga dikush tjetër mbetet një pengesë e rëndësishme, edhe pse ka shënuar një rënie të lehtë nga 43.6% në 42.5%. Ndërkohë, shqetësimet lidhur me cilësinë e produkteve janë rritur ndjeshëm, nga 23.7% në 33.0%, duke sugjeruar një ndjeshmëri më të lartë ndaj standardeve të cilësisë. Arsye si mospërputhja me shijet personale (30.0% në 29.0%) dhe vështirësia në gjetjen e produkteve të përshtatshme (25.3% në 29.1%) mbeten relativisht të qëndrueshme, me luhatje të lehta. Opsioni "tjetër" vazhdon të ketë peshë minimale, duke rënë nga 1.5% në 0.3%.




Figura 31. Cilat janë arsyet që nuk blini produkte të ripërdorura? (Pyetje e shumëfishtë)

Krahasimi ndërmjet viteve 2024 dhe 2025 tregon se rezistenca ndaj veshjeve të përdorura është bërë më shumë e lidhur me perceptime mbi higjienën dhe cilësinë, sesa thjesht me mospëlqimin e idesë së përdorimit të produkteve të dorës së dytë. Arsyeja kryesore në vitin 2025 është shqetësimi se këto produkte nuk janë të pastra apo higjienike, e cila është rritur nga 44.0% në 50.7%. Po ashtu, mosbesimi ndaj cilësisë është rritur ndjeshëm nga 23.7% në 33.0%, duke sugjeruar se konsumatorët mund të kenë më shumë dyshime për gjendjen, qëndrueshmërinë apo standardin e produkteve të përdorura.

Në anën tjetër, arsyeja më emocionale apo kulturore, pra mospëlqimi i idesë së përdorimit të diçkaje të përdorur nga dikush tjetër, ka mbetur pothuajse e pandryshuar, nga 43.6% në 42.5%. Kjo tregon se stigma ndaj veshjeve të përdorura nuk është rritur ndjeshëm, por pengesat praktike dhe perceptimet mbi cilësinë janë bërë më të dukshme. Rritja e vështirësisë për të gjetur produkte që përshtaten, nga 25.3% në 29.1%, gjithashtu tregon se oferta ekzistuese mund të mos i përmbushë mjaftueshëm pritjet e konsumatorëve për madhësi, stil apo gjendje të produktit. Në këtë kuptim, për të rritur pranimin e veshjeve të përdorura, nuk mjafton vetëm ndërgjegjësimi

mjedisor; nevojiten edhe garanci më të qarta për pastërtinë, cilësinë, selektimin dhe prezantimin e produkteve.




Figura 32. Cilat janë arsyet që nuk blijnë produkte të ripërdorura? Krahasoni 2024–2025 (Pyetje e shumëfishtë)

Të dhënat tregojnë se gatishmëria për të blerë produkte second-hand në të ardhmen mbetet relativisht e ulët, me një ndryshim shumë të vogël krahasuar me matjen e mëparshme. Mesatarja e vlerësimit në shkallën 1–7 ka shënuar një rritje të lehtë, nga 3.10 në 3.21, duke sugjeruar një përmirësim marginal në qëndrimin ndaj blerjes së produkteve të ripërdorura. Megjithatë, niveli mesatar vazhdon të mbetet nën mesataren e shkallës, çka tregon se hezitimi ndaj këtij lloji blerjeje ende dominon.



Figura 33. Në një shkallë nga 1 deri në 7, ku 1-aspak i gatshëm dhe 7-shumë i gatshëm, sa jeni të gatshëm të bleni produkte të ripërdorura në të ardhmen?

Arsyet për të konsideruar blerjen e produkteve second-hand në të ardhmen mbeten kryesisht të orientuara nga aspekti ekonomik, edhe pse disa motive kanë ndryshuar lehtë në peshë krahasuar me matjen e mëparshme. Çmimi më i ulët krahasuar me produktet e reja vazhdon të jetë motivi kryesor, megjithëse ka shënuar një rënie nga 65.8% në 59.1%. Në të njëjtën kohë, interesi për të gjetur produkte unike ose me vlerë historike është zbehur lehtë (49.2% në 46.3%), por mbetet një motiv i rëndësishëm për një pjesë të konsiderueshme të të anketuarve. Aftësia për të blerë produkte që nuk gjenden më në treg si të reja ka shënuar një rritje të vogël (45.8% në 47.3%), duke treguar një interes më të madh për akses në artikuj të rrallë ose jashtë prodhimit. Ndërkohë, motivi që lidhet me reduktimin e mbeturinave dhe ndikimin pozitiv në mjedis mbetet relativisht i qëndrueshëm (23.6% në 24.5%). Opsioni “tjetër” ka rënë ndjeshëm nga 4.2% në 0.9%, duke sugjeruar një përqendrim më të qartë të arsyeve kryesore për këtë lloj blerjeje.




Figura 34. Cilat janë arsyet që do ta konsideroni blerjen e produkteve të ripërdorura (second-hand) në të ardhmen? (Pyetje e shumëfishtë)

Rezultatet tregojnë se ripërdorimi i produkteve të tekstilit brenda familjes mbështetet kryesisht në arsye praktike, me disa ndryshime në theksin e motiveve krahasuar me matjen e mëparshme. Arsyeja se rrobat janë ende në gjendje të mirë për përdorim mbetet më e përmendura, duke kaluar nga 64.8% në 63.0%. Motivi për të kursyer para ka humbur disi peshë, duke rënë nga 53.4% në 48.6%, çka sugjeron se faktorët financiarë janë pak më pak dominues. Një rritje e dukshme vërehet te arsyeja nuk kam shumë nevojë për të blerë rroba të reja, e cila është rritur nga 22.3% në 39.5%, duke reflektuar një fokus më të madh në shfrytëzimin e rrobave ekzistuese. Po ashtu, tradita familjare është bërë më e theksuar, nga 13.5% në 20.4%, duke treguar se ripërdorimi po normalizohet gjithnjë e më shumë brenda familjes. Motivet që lidhen me reduktimin e mbeturinave dhe arsyet mjedisore kanë shënuar rritje nga 12.0% në 16.9%, por mbeten dytësore krahasuar me arsyet funksionale. Opsioni “tjetër” është zvogëluar ndjeshëm, nga 8.0% në 0.5%.




Figura 35. Cilat janë arsyet e ripërdorimit të produkteve të tekstilit nga anëtarët e familjes tuaj? (Pyetje e shumëfishtë)

7.3 VESHMBATHJET DHE AKSESORËT

Në vazhdim trajtohen preferencat e qytetarëve në lidhje me veshmbathjet dhe aksesoret që ata zgjedhin të blejnë. Analiza fokusohet në llojet e produkteve më të kërkuara, faktorët që ndikojnë në zgjedhjen e tyre dhe rëndësinë e markave apo trendëve të fundit në vendimmarrjen e konsumatorëve.

Të dhënat sugjerojnë se preferencat e blerjes janë përqendruar gjithnjë e më shumë te veshmbathjet e përditshme (casual), të cilat kanë shënuar rritje nga 76.5% në 82.7%, duke konfirmuar këtë kategori si zgjedhjen kryesore të konsumatorëve. Ndërkohë, interesi për veshje sportive ka rënë nga 27.3% në 21.8%, ndërsa veshjet formale kanë shënuar një rritje të lehtë, nga 23.4% në 26.5%. Preferenca për veshje për festa apo evente është rritur nga 15.5% në 19.3%, por mbetet më e kufizuar krahasuar me kategoritë e tjera. Kategoria “tjetër” vazhdon të ketë peshë minimale dhe nuk shfaq ndryshime domethënëse. Në përgjithësi, gjetjet tregojnë një konsolidim të preferencës për veshje casual, ndërsa kategoritë e tjera pësojnë ndryshime më të moderuara në kohë.




Figura 36. Çfarë lloji të veshmbathjeve dhe aksesoreve preferoni ta blini më shumë? (Pyetje e shumëfishtë)

Të dhënat tregojnë se çmimi mbetet faktori kryesor që ndikon në zgjedhjen e veshmbathjeve dhe aksesoreve, me një rënie të lehtë krahasuar me matjen e mëparshme. Në matjen e fundit, 74.3% e të anketuarve e përmendin çmimin si një nga tre faktorët kryesorë, ndërsa më herët kjo përqindje ishte 80.9%, duke sugjeruar se, edhe pse dominues, roli i çmimit është disi më pak absolut. Cilësia vazhdon të renditet si faktori i dytë më i rëndësishëm dhe mbetet relativisht e qëndrueshme (53.8% krahasuar me 51.5% më parë). Një stabilitet i ngjashëm vërehet edhe për materialin, i cili përmendet nga 42.8% e të anketuarve në matjen aktuale, kundrejt 44.2% në matjen e kaluar. Faktorë më estetikë dhe simbolikë, si dizajni dhe marka, kanë peshë më të kufizuar dhe shfaqin luhatje të vogla. Dizajni është përmendur nga 28.2% e të anketuarve, një rritje e lehtë krahasuar me 24.0%, ndërsa rëndësia e markës është rritur modestisht nga 18.3% në 21.7%. Në të kundërt, trendet mbeten faktor dytësor, me një përqindje pothuajse të pandryshuar (11.2% kundrejt 11.7%), ndërsa vendi i prodhimit vazhdon të ketë ndikim minimal (3.9% krahasuar me 8.1% më parë).




Figura 37. Cilët janë tre faktorët që ndikojnë më shumë në vendimin tuaj për të zgjedhur veshmbathje apo aksesore që blini? (Pyetje e shumëfishtë)

Niveli i informimit për konceptin e Fast Fashion paraqet një rritje të dukshme në valën aktuale krahasuar me matjen e mëparshme. Në matjen e fundit, 5,8% e të anketuarve deklarohen shumë të informuar, një rritje e lehtë nga 4,8% në valën e kaluar. Ndryshimi më i theksuar vërehet te kategoria “deri diku i/e informuar”, e cila është rritur ndjeshëm nga 31,2% në 42,8%, duke sugjeruar zgjerim të njohurive bazë për këtë koncept. Në të njëjtën kohë, pjesa e atyre që ndihen pak të informuar ka rënë nga 33,5% në 28,9%, ndërsa përqindja e respondentëve që deklarohen aspak të informuar ka zbritur nga 30,5% në 22,5%.




Figura 38. Sa jeni të informuar për konceptin fast fashion (modë e shpejt)?

Krahasimi me vitin 2024 tregon një përmirësim gradual në njohjen e konceptit fast fashion, por ky përmirësim duket më shumë si zhvendosje drejt informimit bazik sesa si rritje e njohurive të thelluara. Në vitin 2025, më pak respondentë deklarojnë se janë pak ose aspak të informuar, ndërsa është rritur dukshëm pjesa e atyre që kanë të paktën një nivel të moderuar njohurie. Megjithatë, rritja

shumë e kufizuar e kategorisë “shumë i/e informuar” tregon se koncepti ende nuk është kuptuar në mënyrë të plotë nga shumica e qytetarëve. Kjo sugjeron se fast fashion është bërë më i pranishëm në diskursin publik, por informimi mbetet kryesisht sipërfaqësor. Për këtë arsye, ndërhyrjet e ardhshme duhet të shkojnë përtej njohjes së termit dhe të fokusohen në shpjegimin e lidhjes ndërmjet konsumit të shpejtë, jetëgjatësisë së shkurtër të produkteve, mbeturinave tekstile dhe ndikimit mjedisor.




Figura 39. Sa jeni të informuar për konceptin fast fashion (modë e shpejtë)? Krahasimi 2024–2025

Ndikimi i Fast Fashion në shpeshtësinë e blerjeve mbetet kryesisht i kufizuar, me ndryshime të vogla mes dy matjeve. Në valën aktuale, 52.5% e të anketuarve deklarojnë se Fast Fashion nuk ndikon në atë se sa shpesh blejnë veshmbathje, një nivel shumë i ngjashëm me valën e kaluar (53.7%), duke sugjeruar stabilitet në këtë qëndrim dominues. Ndërkohë, përqindja e atyre që raportojnë se blejnë pak më shpesh është rritur lehtë nga 25.1% në 25.7%, ndërsa grupi që thotë se blejnë shumë më shpesh mbetet i vogël dhe praktikisht i pandryshuar (5.2% më parë krahasuar me 5.5% aktualisht). Nga ana tjetër, pjesa e respondentëve që shprehen se blejnë më rrallë ka shënuar një rritje të lehtë, nga 16.0% në 16.4%, duke treguar se për një segment të kufizuar Fast Fashion lidhet edhe me ulje të shpeshtësisë së blerjeve.




Figura 40. Sa ka ndikuar Fast Fashion (moda e shpejtë) në atë se sa shpesh bleni veshmbathje apo aksesorë?

Krahasimi mes valës aktuale dhe asaj të kaluar tregon ndryshime të dukshme në mënyrën e menaxhimit të veshmbathjeve dhe aksesorëve që nuk përdoren më. Dhurimi tek familjarët dhe miqtë mbetet praktika më e përhapur, por ka shënuar rënie nga 62.8% në valën e kaluar në 58.3% në valën aktuale. Në të kundërt, dhurimi për familje në nevojë është rritur ndjeshëm, nga 37.9% në 41.4%. Edhe ruajtja për ripërdorim në të ardhmen ka shënuar rritje, nga 23.8% në 26.0%. Hedhja si mbeturinë është bërë më e shpeshtë krahasuar me valën e kaluar, duke u rritur nga 19.9% në 16.6% (ndryshim i lehtë në shpërndarje), ndërsa dhurimi për riciklim dhe shitja në tregje të dorës së dytë mbeten praktika shumë të kufizuara në të dyja valët, pavarësisht një rritjeje të vogël në përqindje në valën aktuale.




Figura 41. Si i menaxhoni veshmbathjet dhe aksesorët që nuk i përdorni më? (Pyetje e shumëfishtë)

Krahasuar me vitin 2024, mënyrat e menaxhimit të veshmbathjeve dhe aksesorëve të papërdorur tregojnë disa zhvillime pozitive drejt ripërdorimit dhe riciklimit. Dhurimi te familjarët mbetet forma kryesore. Në anën tjetër, dhurimi për familje në nevojë dhe ruajtja për ripërdorim në të ardhmen janë rritur lehtë. Ndryshimi më pozitiv vërehet te dhurimi për riciklim, i cili është rritur nga 0.5% në 6.4%, edhe pse mbetet ende në nivel të ulët. Paralelisht, hedhja si mbeturina ka rënë, duke sugjeruar një zhvendosje të lehtë drejt praktikave më të qëndrueshme.

Megjithatë, shitja në tregje të dorës së dytë mbetet shumë e kufizuar, me vetëm 2.8% në vitin 2025. Në përgjithësi, të dhënat tregojnë një përmirësim të lehtë në sjelljet e menaxhimit të veshmbathjeve të papërdorura, por riciklimi dhe tregjet e dorës së dytë ende nuk janë praktika të përhapura.




Figura 42. Si i menaxhoni veshmbathjet dhe aksesorët që nuk i përdorni më? Krahاسimi 2024–2025 (Pyetje e shumëfishtë)

Të dhënat krahasuese, të bazuara në numrin e rasteve të raportuara, tregojnë dallime të dukshme mes valës aktuale dhe asaj të mëparshme në lidhje me vendet ku realizohet dhurimi për riciklim. Në valën aktuale është evidentuar një numër më i madh përgjigjesh, me përqendrim kryesisht te Kryqi i Kuq (10 raste) dhe qendrat e riciklimit (8 raste), si dhe disa raste të veçuara që përmendin institucione ose lokacione specifike. Në kontrast, vala e kaluar karakterizohej nga një numër shumë i kufizuar përgjigjesh, vetëm dy raste gjithsej, të cilat i referoheshin destinacioneve të veçanta. Kjo tregon se në valën aktuale respondentët identifikojnë dhe përdorin më shpesh kanale konkrete për dhurimin e produkteve për riciklim.

Tabela 2. Specifikoni vendin ku? (I dhuroj për riciklim)

Vendi	Frekuenca
Kryqi i Kuq	10
Qendra riciklimi	8
Në vende të caktuara.	2
Teshavesha AMC	1

Të dhënat e bazuara në përqindjet valide tregojnë dallime në mënyrën se ku realizohet dhurimi për familje në nevojë mes valës aktuale dhe asaj të mëparshme. Në valën aktuale, Kryqi i Kuq rezultoi si destinacioni më i shpeshtë i dhurimeve (37.8%), duke shënuar një rritje krahasuar me valën e kaluar (34.9%). Ndërkohë, dhurimi përmes familjarëve, të afërmeve dhe të njohurve ka pësuar ulje, nga 35.3% në valën e kaluar në 23.7% në valën aktuale. Krahas kësaj, vala aktuale paraqet një gamë më të gjerë kanalesh për dhurim, përfshirë dorëzimin direkt te familjet në nevojë (12.0%), shoqatat dhe organizatat humanitare (9.8%), si dhe qendrat e grumbullimit dhe iniciativa të tjera komunitare, të cilat në valën e kaluar ishin të përfaqësuara në mënyrë më të kufizuar.




Figura 43. Specifikoni vendin ku? (I dhuroj për familje në nevojë)

Krahasimi mes valës aktuale dhe asaj të kaluar tregon se shitja e produkteve në tregje të dorës së dytë mbetet e kufizuar në të dyja periudhat. Në secilën valë janë raportuar nga 7 raste gjithsej. Në valën aktuale, rastet lidhen kryesisht me teshavesha dhe tregje të hapura, si dhe me disa kanale të tjera të përmendura individualisht, si Fushë Kosova, Facebook Marketplace dhe dyqane lagjeje. Në valën e kaluar, rastet janë përqendruar më shumë te rrjetet sociale, ndërsa janë përmendur edhe dyqane lagjeje, tregje lokale dhe disa dyqane të specializuara second-hand. Kjo tregon se, ndonëse numri i rasteve mbetet i njëjtë, vendet dhe format e shitjes ndryshojnë mes dy valëve.

Tabela 3. Specifikoni vendin ku dhe nese keni dyqan? (I shes në tregje të dorës së dytë)

Vendi	Frekuenca
Teshavesha	2
Në treg të hapur	2
Fushë Kosovë	1
Facebook Marketplace	1
Në dyqan lagjeje	1

Të dhënat tregojnë se hedhja e veshmbathjeve dhe aksesorëve të papërdorur realizohet kryesisht përmes kontejnerëve të mbeturinave, të cilët përmenden nga 93.7% e të anketuarve, ndërsa vetëm 6.3% deklarojnë se i dërgojnë këto produkte në vende të caktuara për riciklim. Në periudhën e mëparshme, praktikat kanë qenë më të shpërndara, ku 56.6% i hidhnin përmes mbeturinave shtëpiake të menaxhuara nga kompania e pastrimit dhe 42.6% përmes kontejnerëve të mbeturinave të qytetit, me raste shumë të kufizuara të hedhjes në deponi. Kjo pasqyron një përqendrim më të madh të hedhjes në kanale standarde të mbeturinave, ndërsa përdorimi i alternativave për riciklim mbetet i kufizuar.




Figura 44. Specifikoni vendin ku? (I hedhi si mbetura)

Bazuar në këto të dhëna, është kryer një kalkulim për të vlerësuar sasinë e mbeturinave tekstile të gjeneruara nga qytetarët. Nga të anketuarit, 16.6% deklaruan se hedhin veshmbathje në mbeturina, duke raportuar një total prej 485 kg në vit. Kjo i korrespondon një mesatareje prej rreth 9.70 kg për person në vit brenda këtij grupi. Duke e aplikuar këtë mesatare mbi popullsinë që përfaqëson këtë sjellje, vlerësohet që qytetarët në Kosovë gjenerojnë afërsisht 2,695.68 ton mbeturina tekstili në vit nga veshmbathjet.

Në lidhje me sasinë e veshmbathjeve që hidhen gjatë një viti, profili i raportimit ka ndryshuar ndjeshëm mes dy valëve. Në valën më të fundit, anketuarit shpërndahen në kategori më të fragmentuara dhe përgjithësisht më të ulëta të peshës, ku përgjigjet për 1–2 kg dhe 3–5 kg përbëjnë së bashku 35.0% të përgjigjeve (18.1% dhe 16.9%), ndërsa kategoritë mbi 10 kg mbeten

relativisht të kufizuara (4.2% për 15 kg dhe 6.0% për 20 kg). Në krahasim, në valën e mëparshme, raportimi ishte më i përqendruar në intervale më të gjera, me 44.7% të anketuarve që deklarorin hedhjen e 1–5 kg në vit dhe 21.8% që raportorin 11–15 kg, çka tregon një peshë mesatare më të lartë të deklaruar në atë periudhë. Gjithashtu, pjesa e anketuarve që deklarorin “nuk e di” është rritur ndjeshëm në valën aktuale (31.4%), krahasuar me vetëm 8.6% në valën e kaluar, duke sugjeruar një pasiguri më të madhe ose vështirësi në vlerësimin e sasisë së mbeturinave tekstile në vitin e fundit.




Figura 45. Përafërsisht sa kilogram veshmbathje i hudhni gjatë një viti?

7.4 TEKSTILI SHTËPIAK

Krahas veshjeve, anketa përfshin edhe tekstilin e përdorur në ambientet shtëpiake. Ky seksion shqyrton zgjedhjet e konsumatorëve për produkte si mbulesa, perde dhe qilima, duke ndihmuar në kuptimin e elementeve kryesore që ndikojnë në preferencat dhe sjelljen e blerjes.

Blerja e produkteve të reja të tekstilit shtëpiak vazhdon të ndodhë kryesisht kur ekziston nevoja për zëvendësim, megjithatë kjo arsye shfaqet më e theksuar në valën aktuale. Konkretnisht, 74.4% e të anketuarve raportojnë se blejnë produkte të reja kur ka nevojë për zëvendësim, krahasuar me 67.1% në valën e kaluar, duke treguar një rritje prej 7.3 pikë përqindje. Blerjet gjatë ofertave sezonale mbeten arsyeja e dytë më e shpeshtë, por me një rritje më modeste, nga 37.9% në valën e kaluar në 40.2% në valën aktuale. Ndërkohë, blerjet për rinovimin e dekorit të shtëpisë shënojnë rritje më të dukshme, nga 30.7% në 25.5%, duke sugjeruar një orientim më funksional sesa estetik krahasuar me valën e kaluar. Blerjet gjatë festave apo eventeve speciale mbeten më pak të zakonshme, megjithëse vërehet një rënie nga 17.9% në 15.1%.




Figura 46. Në cilat raste zakonisht blini produkte të reja të tekstilit shtëpiak? (Pyetje e shumëfishtë)

Rezultatet e vitit 2025 tregojnë se blerjet e tekstilit shtëpiak janë të orientuara kryesisht nga nevoja praktike për zëvendësim. Kjo mund të lidhet me faktin se këto produkte përdoren çdo ditë dhe blihen më shpesh kur konsumohen, dëmtohen ose nuk i përmbushin më nevojat e familjes. Ndikimi i ofertave sezonale tregon gjithashtu se konsumatorët janë të kujdesshëm me shpenzimet dhe prirjen të blejnë kur çmimet janë më të favorshme. Ndërkohë, motivet dekorative apo blerjet për festa kanë rol më të kufizuar, duke sugjeruar se tekstili shtëpiak shihet më shumë si nevojë funksionale sesa si blerje estetike apo spontane. Në përgjithësi, rezultatet tregojnë se në vitin 2025 konsumatorët janë më të prirur të blejnë tekstil shtëpiak kur produktet ekzistuese duhet të zëvendësohen, ndërsa motivet dekorative kanë peshë disi më të ulët.




Figura 47. Cilat janë arsyet kryesore për blerjen e tekstilit shtëpiak? Krahasoni 2024–2025

Në të dy valët, vendimmarrja për blerjen e produkteve të tekstilit shtëpiak dominohet nga faktorë funksionalë, megjithatë struktura e prioriteteve ka ndryshuar. Në valën më të fundit, çmimi mbetet faktori kryesor (60.9%), por krahasuar me valën e kaluar (67.1%), vërehet një ulje prej 6.2 pikë

përqindje, duke sugjeruar një zbutje relative të ndjeshmërisë ndaj çmimit. Në të njëjtën kohë, materiali (52.1% kundrejt 47.6%) dhe cilësia (50.3% kundrejt 53.7%) mbeten ndër faktorët kryesorë, me materialin që fiton peshë ndërsa cilësia shënon një rënie të lehtë. Qëndrueshmëria shfaq një rënie të dukshme nga 35.7% në 26.6%, duke treguar se ky faktor ka humbur rëndësi relative në zgjedhjet aktuale. Ndërkohë, dizajni mbetet relativisht stabil (24.3% krahasuar me 29.8%), ndërsa faktorë më simbolikë si marka (10.4% kundrejt 6.9%) dhe trendi (9.6% kundrejt 4.3%) shënojnë rritje, megjithëse vazhdojnë të jenë dytësorë në raport me kriteret praktike.




Figura 48. Cilët janë tre faktorët që ndikojnë më shumë në vendimin tuaj për të zgjedhur produktet e tekstilit shtëpiak që blini? (Pyetje e shumëfishtë)

Përgjigjet tregojnë se zakonet e blerjes së tekstilit shtëpiak mbeten relativisht të qëndrueshme mes dy valëve, por me lëvizje të lehta në intensitet. Në valën aktuale, 41.1% e të anketuarve deklarojnë se zakonet e tyre kanë mbetur të njëjta, krahasuar me 45.9% në valën e kaluar, duke sugjeruar një rënie të lehtë të stabilitetit në sjellje. Në të njëjtën kohë, përqindja e atyre që blejnë më rrallë është rritur nga 33.2% në valën e kaluar në 34.2% në valën aktuale, ndërsa blerjet më të shpeshta janë raportuar nga 24.6% e të anketuarve, krahasuar me 20.9% më parë. Këto ndryshime sugjerojnë një zhvendosje të moderuar drejt rritjes së polarizimit në sjelljen e blerjes, ku një pjesë e konsumatorëve po kufizojnë më tej blerjet, ndërsa një segment më i vogël po raporton intensifikim të tyre.



Figura 49. A keni ndryshuar zakonet tuaja të blerjes së produkteve të tekstilit shtëpiak gjatë viteve të fundit?

Në menaxhimin e produkteve të tekstilit shtëpiak që nuk përdoren më, modeli kryesor mbetet dhurimi brenda rrethit familjar, me 49.6% të të anketuarve që raportojnë këtë praktikë, krahasuar me 47.5% në valën e mëparshme. Dhurimi për familje në nevojë mbetet gjithashtu i përhapur dhe relativisht i qëndrueshëm, me 27.2% të të anketuarve aktualisht kundrejt 28.9% më herët. Një ndryshim më i dukshëm vërehet te ruajtja për ripërdorim në të ardhmen, e cila është rritur nga 17.9% në 25.5%, duke sugjeruar një prirje më të fortë drejt zgjatjes së jetës së produkteve. Në të kundërt, hedhja e produkteve si mbeturina ka rënë nga 27.7% në 22.8%, çka tregon një ulje të praktikave më pak të qëndrueshme. Riciklimi mbetet në nivele shumë të ulëta, por ka shënuar një rritje të lehtë nga 1.2% në 3.4%, ndërsa shitja në tregje të dorës së dytë vazhdon të jetë marginale, me rreth 1% të të anketuarve në të dyja matjet.




Figura 50. Si i menaxhoni produktet e tekstilit shtëpiak që nuk i përdorni më? (Pyetje e shumëfishtë)

Kur të anketuarit raportojnë se i dhurojnë produktet e tekstilit për riciklim, vërehet një përqendrim më i madh i praktikës në një kanal të vetëm krahasuar me matjen e mëparshme. Në këtë valë, gjithsej 8 të anketuar kanë specifikuar se i dorëzojnë produktet në vende të dedikuara për riciklim,

pa përmendur alternativa të tjera. Në matjen e kaluar, numri i përgjigjeve ishte më i ulët dhe më i shpërndarë, me gjithsej 4 të anketuar, nga të cilët 2 përmendën fabrika për riciklim, 1 vende ku pranohen produkte për riciklim dhe 1 kanale të dorës së dytë. Kjo tregon se, edhe pse riciklimi mbetet një praktikë e kufizuar në terma absolutë, mënyra e realizimit të tij është bërë më e përqendruar dhe më pak e fragmentuar krahasuar me matjen e mëparshme.

Tabela 4. Specifikoni vendin ku? (I dhuroj për riciklim)

Vendet	Frekuenca
Vendet e dedikuara për riciklim	8

Praktikat e dhurimit për familje në nevojë tregojnë një orientim gjithnjë e më të fortë drejt kanaleve të njohura dhe të besueshme. Kryqi i Kuq konfirmohet si destinacioni kryesor, i përmendur nga 37.7% e përgjigjeve të vlefshme, duke shënuar një rritje të dukshme krahasuar me 29.5% në valën e kaluar. Paralelisht, dhurimi direkt te familjarët, të afërmit apo personat e njohur në nevojë mbetet një praktikë e rëndësishme, edhe pse me një peshë disi më të ulët se më parë, duke kaluar nga 35.8% në 29.6%. Kanale të tjera, si organizatat humanitare, qendrat e grumbullimit apo institucionet fetare, vazhdojnë të përdoren në mënyrë më sporadike, me përqindje që nuk tejkalojnë 10% në asnjërën nga valët.




Figura 51. Specifikoni vendin ku? (I dhuroj për familje në nevojë)

Shitja e produkteve tekstile në tregje të dorës së dytë rezultojnë të jetë një praktikë shumë e kufizuar në të dyja periudhat e krahasuara. Në të dhënat më të fundit identifikohen vetëm 3 raste gjithsej, të shpërndara në kanale kryesisht informale: treg i hapur (1 rast), platforma MerrJep (1 rast) dhe shitje direkte tek persona të afërt (1 rast). Në periudhën e mëparshme, numri i rasteve ishte më i

lartë, me 7 raste të raportuara, si dhe me një diversitet më të madh të kanaleve të përdorura, përfshirë shitjen në lagje, pazar, përmes rrjeteve shoqërore, ambiente second-hand dhe institucione fetare. Kjo prire tregon një reduktim të shtrirjes dhe formalizimit të kësaj praktike, ndërkohë që në të dyja rastet, frekuenca e ulët konfirmon se shitja e tekstilit të përdorur mbetet një sjellje marginale në nivel popullate.

Tabela 5. Specifikoni vendin ku dhe nëse keni dyqan? (I shes në tregje të dorës së dytë)

Vendi	Frekuenca
Në treg të hapur	1
MerrJep	1
Ia shes ndonjë të afërmi.	1

Menaxhimi i produkteve tekstile që hidhen si mbeturina ka pësuar një përqendrim edhe më të madh drejt kanaleve standarde të grumbullimit. Aktualisht, pothuajse të gjithë të anketuarit që raportojnë hedhjen e tekstileve si mbeturina (95.4%) deklarojnë se i depozitojnë ato në konteinerët e mbeturinave, ndërsa vetëm një pjesë shumë e vogël i dorëzon përmes kompanive të mbledhjes së mbeturinave (3.2%) ose i djeg (1.4%). Krahasuar me matjen e mëparshme, ku hedhja përmes kompanive të pastrimit dhe mbeturinave shtëpiake ishte më pak dominante (73.8%) dhe një pjesë jo e vogël përfundonte në deponi të qytetit (20.0%) ose digjej (6.2%), vihet re një zhvendosje drejt një modeli më uniform të sjelljes.




Figura 52. Specifikoni vendin ku? (I hedhi si mbeturina)

7.5 PRAKTIKAT E RIPËRDORIMIT DHE RICIKLIMIT

Me rritjen e vetëdijes për ndikimin mjedisor të industrisë së tekstilit, ky seksion shqyrton sa dhe si qytetarët angazhohen në ripërdorimin dhe riciklimin e produkteve të tekstilit. Rezultatet ndihmojnë në kuptimin e nivelit të ndërgjegjësimit dhe barrierave kryesore që ndikojnë në këto praktika.

Në lidhje me njohuritë mbi ndikimin që prodhimi dhe asgjësimi i produkteve të tekstilit kanë në mjedis, rezultatet tregojnë një nivel përgjithësisht të qëndrueshëm ndërmjet dy matjeve. Në matjen më të fundit, 50.8% deklarojnë se kanë njohuri për këtë ndikim, krahasuar me 53.9% në 2024. Paralelisht, përqindja e atyre që shprehen se nuk kanë njohuri është rritur lehtë, nga 46.1% në 49.2%. Këto gjetje tregojnë se niveli i vetëdijes mjedisore lidhur me tekstilin mbetet relativisht i

balancuar, pa ndryshime të theksuara ndërmjet dy periudhave të matjes. Përqindja e lartë e respondentëve që nuk kanë njohuri mbi këtë çështje tregon nevojën për ndërhyrje më të strukturuar informuese dhe edukative, veçanërisht në lidhje me ndikimin e prodhimit, konsumit të shpejtë, asgjësimit dhe mundësive për ripërdorim e riciklim të produkteve të tekstilit.




Figura 53. A keni njohuri se si ndikon prodhimi dhe asgjësimi i produkteve të tekstilit në mjedis

Perceptimi mbi rëndësinë e këtij problemi mbetet shumë i lartë dhe relativisht i qëndrueshëm ndërmjet dy matjeve, me një ndryshim të vogël por në drejtim pozitiv. Pjesa më e madhe e të anketuarve e konsiderojnë atë shumë të rëndësishëm, ndërsa kjo përqindje është ritur nga 67.6% në matjen e mëparshme në 74.5% në matjen aktuale. Njëkohësisht, vlerësimi i problemit si i rëndësishëm ka rënë nga 30.6% në 23.9%, çka sugjeron një zhvendosje nga vlerësimi "i rëndësishëm" drejt vlerësimit "shumë i rëndësishëm". Kjo tregon një forcim të lehtë të perceptimit për seriozitetin e problemit, edhe pse niveli i përgjithshëm i rëndësisë ka qenë i lartë në të dyja matjet. Kategoritë që e shohin problemin si pak të rëndësishëm ose aspak të rëndësishëm mbeten

margjinale dhe pothuajse të pandryshuara mes dy matjeve, me përqindje që nuk i kalojnë 1.5% në asnjërën periudhë.




Figura 54. Sa mendoni se është i rëndësishëm ky problem?

Në të dyja matjet, arsyeja kryesore e mosinformimit lidhet qartë me mungesën e informacionit në media. Në të dhënat më të fundit, kjo arsye përmendet nga 62.5% e rasteve, duke shënuar një rënie të lehtë krahasuar me matjen e mëparshme, ku mungesa e informacionit në media ishte raportuar nga rreth 66.2% e rasteve. Një model i ngjashëm vërehet edhe për mungesën e fushatave ndërgjegjësuere: në valën e fundit kjo arsye citohet nga 36.0% e rasteve, ndërsa më herët nga rreth 32.4%, duke treguar një rritje të lehtë të peshës së këtij faktori. Në të njëjtën kohë, mungesa e interesit personal për këtë temë mbetet relativisht e qëndrueshme ndërmjet dy matjeve, me 23.4% në valën aktuale dhe rreth 23.7% në matjen e mëparshme. Ndërkohë, përqindja e atyre që nuk e shohin çështjen si një problem të rëndësishëm është rritur, nga rreth 9.7% më parë në 14.9% në të dhënat më të fundit.




Figura 55. Cili mendoni se është shkaku kryesor i mos informimit tuaj mbi këtë çështje? (Pyetje e shumëfishtë)

Në lidhje me shpeshtësinë e ripërdorimit dhe riciklimit të produkteve të tekstilit, të dhënat tregojnë një riorientim drejt praktikave më të moderuara krahasuar me matjen e mëparshme. Pjesa që deklaroi se i ripërdor ose riciklon produktet shpesh përbën 6.7%, krahasuar me 9.9% në matjen e kaluar, duke sugjeruar një ulje të lehtë të këtij grupi. Në të kundërt, kategoria “ndonjëherë” shënon një rritje të dukshme, nga 27.4% në 39.7%, çka tregon se një pjesë më e madhe po përfshihet në këto praktika në mënyrë jo të rregullt. Përqindja e atyre që raportojnë se ripërdorin ose riciklojnë rrallë mbetet praktikisht e pandryshuar (28.1% kundrejt 28.4%), ndërsa grupi që deklaroi se nuk i praktikojnë këto sjellje asnjëherë zvogëlohet nga 34.2% në 25.5%. Në tërësi, rezultatet tregojnë një zhvendosje nga mungesa e plotë e ripërdorimit dhe riciklimit drejt përfshirjes sporadike, duke reflektuar një normalizim gradual të këtyre praktikave, edhe pse jo ende në formë të qëndrueshme dhe të shpeshta.




Figura 56. Sa shpesh i ripërdorni dhe ricikloni produktet tuaja të tekstilit?

Krahasimi me vitin 2024 tregon një zhvendosje të lehtë pozitive në sjelljet e ripërdorimit dhe riciklimit të produkteve të tekstilit. Ndryshimi kryesor nuk qëndron te rritja e praktikimit të shpeshtë,

i cili madje ka rënë lehtë, por te ulja e grupit që nuk i praktikon këto sjellje fare dhe rritja e atyre që i praktikojnë herë pas here. Kjo sugjeron se ripërdorimi dhe riciklimi po bëhen më të pranueshme si sjellje, por ende nuk janë kthyer në praktika të rregullta. Në këtë kuptim, rezultatet tregojnë një kalim nga mosangazhimi drejt përfshirjes sporadike, gjë që është zhvillim pozitiv, por ende i pamjaftueshëm për të treguar ndryshim të qëndrueshëm në sjelljen e konsumatorëve. Për ta forcuar këtë prirje, nevojiten mekanizma më të qartë dhe më të lehtë për qytetarët, si pika grumbullimi, informim praktik dhe mundësi më të dukshme për ripërdorim ose riciklim.




Figura 57. Sa shpesh i ripërdorni dhe ricikloni produktet tuaja të tekstilit? Krahاسimi 2024-2025

Përballja me vështirësi gjatë procesit të ripërdorimit dhe riciklimit të produkteve të tekstilit paraqitet e shpërndarë relativisht në mënyrë të balancuar në të dy matjet. Në matjen më të fundit, 28.2% raportojnë se janë përballur me vështirësi, ndërsa 37.3% deklarojnë se nuk kanë pasur vështirësi dhe 34.5% shprehen se kjo ndodh vetëm herë pas here. Kjo shpërndarje tregon se përvoja me pengesa nuk është dominuese, por as e rrallë. Në matjen e mëparshme, struktura e përgjigjeve ishte shumë e ngjashme: 34.7% raportuan se po përballeshin me vështirësi, 31.0% thanë se nuk kishin hasur vështirësi dhe 34.3% u pozicionuan në kategorinë “ndonjëherë”. Krahاسimi i dy matjeve sugjeron një stabilitet të përgjithshëm në perceptimin e vështirësive, me një rënie të lehtë të përbindjes së atyre që raportojnë vështirësi të drejtpërdrejta dhe një rritje të lehtë të atyre që deklarojnë se nuk hasin pengesa.



Figura 58. A përballeni me vështirësi gjatë procesit të ripërdorimit dhe riciklimit të produkteve të tekstilit?

Në lidhje me ndryshimet që do t'i inkurajonin më shumë individët të ripërdorin dhe riciklojnë produktet e tekstilit, rezultatet tregojnë një vazhdimësi të qartë në prioritetet kryesore, por edhe disa zhvendosje në peshën relative të tyre. Ofrimi i pikave të dedikuara për riciklim mbetet faktori më i përmendur, duke u përmendur nga 45.9% në matjen më të fundit, krahasuar me 39.9% në matjen e mëparshme. Ndërkohë, rëndësia e stimuljeve financiarë, si zbritjet apo shpërblimet për ripërdorim dhe riciklim, shfaqet në nivele të ngjashme, me 26.9% aktualisht dhe 27.2% më herët. Një rritje vërehet te roli i fushatave të ndërgjegjësimit, të cilat përmenden nga 26.8%, krahasuar me 16.4% në matjen e mëparshme, duke sugjeruar një prani më të theksuar të dimensionit informues në perceptimet aktuale. Po ashtu, më shumë opsione për dhurimin e rrobave për persona në nevojë mbeten të rëndësishme, megjithëse me një peshë pak më të ulët në rezultatet aktuale (23.6%) krahasuar me më parë (30.8%). Në të njëjtën kohë, nevoja për informacion më të qartë mbi procesin e ripërdorimit dhe riciklimit shfaqet në nivele të krahasueshme mes dy matjeve, përkatësisht 21.9% dhe 34.2%, duke reflektuar një interes të qëndrueshëm për qartësi procedurale lidhur me këtë proces.




Figura 59. Çfarë ndryshimesh do t'ju inkurajonin të ripërdornit dhe riciklonit produktet e tekstilit më shpesh? (Pyetje e shumëfishtë)

Krahasimi me vitin 2024 tregon se qytetarët po e lidhin gjithnjë e më shumë nxitjen e ripërdorimit dhe riciklimit me zgjidhje praktike dhe të qasshme, më shumë sesa vetëm me informim të përgjithshëm. Rritja e kërkesës për pika të dedikuara riciklimi, nga 39.9% në 45.9%, sugjeron se mungesa e infrastrukturës konkrete mbetet pengesë kryesore për veprim. Në të njëjtën kohë, rënia e nevojës për informacion më të qartë dhe për më shumë opsione dhurimi tregon se qytetarët mund të jenë më të vetëdijshëm për rëndësinë e ripërdorimit, por ende kanë nevojë për mekanizma më të lehtë për ta zbatuar atë në praktikë. Rritja e mbështetjes për fushata ndërgjegjëse, nga 16.4% në 26.8%, tregon se informimi mbetet i rëndësishëm, por duhet të

kombinohet me zgjidhje konkrete, si pika grumbullimi, sisteme të qarta dorëzimi dhe mundësi të dukshme për riciklim apo ripërdorim.




Figura 60. Çfarë do t'ju nxiste të ripërdorni ose ricikloni më shumë rroba? Krahاسimi 2024–2025

Interesi për informacion lidhur me ripërdorimin dhe riciklimin e produkteve të tekstilit mbetet i përqendruar kryesisht te aspektet praktike dhe të zbatueshme. Në të dyja valët, më së shpeshti kërkohet informacion mbi vendet dhe qendrat e ripërdorimit/riciklimit në komunitet, me një nivel të lartë interesi edhe në këtë valë (48.5%), i krahasueshëm me rezultatet e mëparshme (47.6%). Një pjesë e konsiderueshme e pjesëmarrësve shpreh gjithashtu nevojë për udhëzime se si të identifikohen materialet që mund të ripërdoren ose riciklohen, ku vërehet një rritje e lehtë krahasuar me valën e kaluar (33.5% kundrejt 39.9%). Përfitimet mjedisore të ripërdorimit dhe riciklimit vazhdojnë të jenë një temë me interes të qëndrueshëm (32.7%, kundrejt 30.0% më herët), ndërsa kërkesa për informacion mbi kujdesin për rrobat para ripërdorimit ose riciklimit mbetet në nivele të ngjashme (26.0% krahasuar me 29.5%). Interesi për proceset konkrete të ripërdorimit dhe riciklimit të tekstilit shfaqet më i moderuar në të dyja matjet (23.3% kundrejt 23.9%), duke sugjeruar një fokus më të madh te aspektet praktike dhe të afërta me përditshmërinë sesa te proceset teknike.




Figura 61. Në cilat aspekte lidhur me ripërdorimin dhe riciklimin e produkteve të tekstilit dëshironi të merrni më shumë informacion? (Pyetje e shumëfishtë)

Niveli i njohurive për iniciativë të riciklimit të produkteve të tekstilit mbetet shumë i ulët dhe pothuajse i pandryshuar mes dy matjeve. Në këtë valë, vetëm 0.7% deklarojnë se kanë informacion për ndonjë iniciativë të tillë, ndërsa 99.3% shprehen se nuk kanë dijeni. Një vit më parë, rezultatet ishin shumë të ngjashme, me 2.0% që pohonin se kishin informacion dhe 98.0% që deklarorin mungesë njohurish. Në të dyja rastet, dominon qartë mungesa e informacionit mbi iniciativat e riciklimit të tekstilit.

Ndër ata pak që deklarojnë se kanë informacion, përmenden disa iniciativë konkrete dhe të shpërndara, përfshirë Recycle Kosova, kompaninë PLASTIKA Sh.P.K, OJQ Rilindja e Gjellbër me aktivitete të riciklimit të tekstilit dhe trajnime praktike (p.sh. për qepje dhe dizajn), si dhe Aksionin për Nëna dhe Fëmijë (AMC).




Figura 62. A keni informacion për ndonjë iniciativë të riciklimit të produkteve të tekstilit?

Në lidhje me gatishmërinë për t'u përfshirë në proceset e riciklimit të produkteve të tekstilit, niveli mesatar i raportuar mbetet relativisht i qëndrueshëm mes dy valëve. Në valën aktuale, vlera mesatare arrin në 4.52, duke treguar një prirje të moderuar drejt gatishmërisë për përfshirje. Në krahasim, vala e kaluar regjistron një mesatare pak më të ulët, 4.44, çka sugjeron një rritje të lehtë, por jo thelbësore, të gatishmërisë së përgjithshme. Shpërndarja e përgjigjeve mbetet e gjerë në të dyja valët, duke reflektuar dallime të dukshme në nivelin individual të gatishmërisë për t'u angazhuar në këto procese.



Figura 63. Në një shkallë nga 1 deri në 7, ku 1-aspak i gatshëm dhe 7-shumë i gatshëm, sa do të ishit të gatshëm të përfshiheni në procese të riciklimit të produkteve të tekstilit

7.6 EKONOMIA QARKORE

Ekonomia qarkore është një model ekonomik që synon të reduktojë mbeturinat dhe të maksimizojë përdorimin e burimeve duke i mbajtur produktet, materialet dhe burimet në përdorim për sa më gjatë që të jetë e mundur. Ajo bazohet në parimet e ripërdorimit, riparimit, riciklimit dhe reduktimit të mbeturinave, duke krijuar një sistem më të qëndrueshëm dhe më efikas në krahasim

me modelin tradicional linear të "merr, prodho, përdor dhe hidhe" (Ellen MacArthur Foundation, 2013).

Ky segment trajton konceptin e ekonomisë qarkore dhe ndikimin e saj në sjelljen e konsumatorëve. Analiza përfshin perceptimet e qytetarëve mbi rëndësinë e qarkullimit të produkteve dhe gatishmërinë e tyre për të adoptuar modele të qëndrueshme të konsumit.

Njohuria për konceptin e ekonomisë qarkore mbetet përgjithësisht e kufizuar, megjithëse vërehen disa ndryshime mes dy matjeve. Në matjen më të fundit, 12.7% deklarojnë se e njohin shumë mirë konceptin, krahasuar me 5.6% më parë, duke treguar një rritje të lehtë të njohurisë së thelluar. Grupi që shprehet se ka dëgjuar për ekonominë qarkore, por pa pasur njohuri të mira, përbën 35.4%, një nivel i ngjashëm me matjen e mëparshme (38.4%). Ndërkohë, pjesa që deklaron se nuk e njeh konceptin si të tillë mbetet shumicë, megjithëse në rënie, nga 56.0% në matjen e mëparshme në 51.9% aktualisht. Këto rezultate sugjerojnë një përmirësim modest të njohurisë, por edhe vazhdimësi të boshllëqeve të konsiderueshme në kuptimin e konceptit të ekonomisë qarkore.




Figura 64. Sa keni njohuri për konceptin e ekonomisë qarkore?

Krahasimi me vitin 2024 tregon një përmirësim të lehtë në njohjen e konceptit të ekonomisë qarkore, por jo ende një ndryshim të thellë në nivelin e informimit. Rënia e respondentëve që nuk e njohin fare konceptin, nga 56.0% në 51.9%, dhe rritja e atyre që deklarojnë se e njohin shumë mirë, nga 5.6% në 12.7%, sugjerojnë një lëvizje pozitive drejt kuptimit më të mirë të temës. Megjithatë, më shumë se gjysma e respondentëve ende nuk e njohin ekonominë qarkore, ndërsa një pjesë e konsiderueshme mbetet vetëm me njohuri sipërfaqësore. Kjo tregon se diskutimi publik mbi riciklimin, ripërdorimin dhe tranzicionin e gjelbër mund të ketë ndikuar në rritjen e vetëdijes, por koncepti ende nuk është bërë mjaftueshëm i qartë dhe i kuptueshëm për qytetarët. Për këtë

arsye, informimi i ardhshëm duhet të jetë më praktik dhe më i lidhur me shembuj konkretë të jetës së përditshme.




Figura 65. Sa keni njohuri për konceptin e ekonomisë qarkore? Krahasoni 2024—2025

Në të dyja matjet vërehet një nivel i lartë gatishmërie për të ndryshuar zakonet e furnizimit me produkte tekstili, por struktura e kësaj gatishmërie ka ndryshuar. Pjesa e atyre që shprehen plotësisht të gatshëm është rritur nga 28.9% në 43.5%, ndërsa gatishmëria deri diku mbetet kategoria dominuese, por ka rënë nga 67.0% në 53.1%. Në të njëjtën kohë, refuzimi i plotë për të bërë ndryshime mbetet shumë i ulët dhe pothuajse i pandryshuar (4.1% krahasuar me 3.4%). Kjo tregon një zhvendosje nga gatishmëria e moderuar drejt një angazhimi më të fortë për ndryshim, pa ndryshime domethënëse në përqindjen e atyre që nuk janë aspak të gatshëm.



Figura 66. A do të ishit të gatshëm të ndryshoni zakonet tuaja të furnizimit me produkte të tekstilit për të kontribuar në ekonominë qarkore?

Qëndrimet ndaj pjesëmarrjes në evente të shkëmbimit të rrobave tregojnë një nivel relativisht të lartë gatishmërie, me lëvizje të lehta midis kategorive të përgjigjeve krahasuar ndërmjet valëve. Pjesa e atyre që shprehen “disi të gatshëm” është rritur nga 49.9% në 57.1%, duke u konsoliduar si qëndrimi dominues. Në të njëjtën kohë, gatishmëria e lartë (“shumë i gatshëm”) ka shënuar një

rënie të lehtë, nga 24.8% në 23.3%. Ndërkohë, përqindja e atyre që shprehen “aspak të gatshëm” ka rënë nga 25.2% në 19.6%, duke treguar një zvogëlim të qëndrimeve më negative ndaj këtij lloji aktiviteti.




Figura 67. Sa jeni të gatshëm të merrni pjesë në evente të shkëmbimit të rrobave (swapping clothes event)?

Motivimi kryesor për t'u bërë pjesë e nismave të tilla lidhet kryesisht me aspektet ekonomike dhe sociale. Kursimet financiare mbeten faktori më i përmendur, me 46.0%, duke u afruar shumë me rezultatet e valës së mëparshme (48.3%). Edhe ndikimi social vazhdon të ketë peshë të lartë, duke u përmendur nga 44.5% e të anketuarve, krahasuar me 41.1% më herët. Mundësia për të shkëmbyer apo përfituar produkte unike shënon gjithashtu një nivel të qëndrueshëm interesi (35.5% kundrejt 37.8%), ndërsa përmirësimi i stilit të jetesës përmendet nga rreth një e treta e të anketuarve (32.0%), në linjë me gjetjet e mëparshme. Përfitimet e zakonshme dhe opsionet e tjera mbeten marginale në të dyja valët. Këto rezultate sugjerojnë se pjesëmarrja në nisma të tilla motivohet kryesisht nga përfitime të prekshme dhe të menjëhershme, veçanërisht kursimet financiare dhe ndikimi social, të cilat mbeten faktorët dominues dhe relativisht të qëndrueshëm ndërmjet dy valëve. Në të njëjtën kohë, interesi për mundësinë e shkëmbimit apo përfitimit të produkteve unike dhe përmirësimin e stilit të jetesës sugjeron se këto nisma perceptohen jo vetëm si zgjidhje praktike, por edhe si aktivitete me vlerë sociale dhe personale.




Figura 68. Çfarë ju motivon më shumë për t'u bërë pjesë e nismave të tilla? Pyetje e shumëfishtë

7.7 BURIMET E INFORMACIONIT

Një komponent tjetër i rëndësishëm i raportit lidhet me burimet kryesore të informimit për produktet e tekstilit. Ky seksion analizon ndikimin e rrjeteve sociale, mediave tradicionale dhe rekomandimeve personale në formësimin e vendimeve të konsumatorëve për blerje.

Burimet kryesore të informacionit mbeten qartazi kanalet digjitale, me rrjetet sociale që kryesojnë në të dy valët. Përdorimi i tyre është rritur ndjeshëm, nga rreth 61.2% në valën e mëparshme në gati 73.7% aktualisht, duke forcuar rolin e tyre si burimi dominant për informim rreth tekstilit dhe blerjes së produkteve. Faqet në internet shënojnë rënie, nga 52.9% në 42.5% në valën aktuale, duke treguar një zhvendosje drejt kërkimit aktiv online dhe burimeve digjitale të strukturuara. Paralelisht me këtë zhvillim, burimet tradicionale dhe ndërpersonale vazhdojnë të shfaqen në një nivel të ulët. Bisedat me familjarë dhe miq bien në 37.1%, ndërsa televizioni dhe materialet e shtypura (fletëpalosje/broshura) mbeten burime dytësore, me nivele dukshëm më të ulëta përdorimi sesa burimet e tjera. Radioja vazhdon të ketë një rol minimal në të dy periudhat.




Figura 69. Cilat burime të informacionit i përdorni për të marrë informatat në lidhje me tekstilin dhe blerjen e produkteve të tekstilit? Pyetje e shumëfishtë

Përdorimi i rrjeteve sociale si burim kryesor informacioni dhe blerjeje për produktet e tekstilit mbetet shumë i lartë. Facebook vazhdon të jetë platforma më e përdorur, me një rritje të lehtë nga 77.0% në valën e kaluar në 79.9% në valën aktuale, duke forcuar rolin e tij dominues. Instagram mbetet gjithashtu shumë i rëndësishëm, megjithëse vërehet një rënie e lehtë nga 71.7% në 68.2%, duke sugjeruar një stabilizim të përdorimit më shumë sesa rritje të mëtejshme. Në të kundërt, TikTok ka shënuar një rritje të dukshme, nga 22.9% në 27.3%, duke reflektuar rritjen e ndikimit të përmbajtjes vizuale dhe video në procesin e informimit dhe blerjes. YouTube gjithashtu ka fituar terren, duke u rritur nga 15.6% në 19.4%, ndërsa Snapchat ka shënuar një rritje të vogël nga 4.5% në 6.4%. Ndërkohë, LinkedIn dhe Twitter mbeten platforma marginale për këtë qëllim, me përdorim të ulët dhe pothuajse të pandryshuar (LinkedIn nga 3.1% në 4.2%, Twitter nga 3.4% në 3.2%). Në tërësi,

gjetjet tregojnë se, krahas platformave tradicionale sociale, rrjetet e bazuara në video po fitojnë gjithnjë e më shumë rëndësi në informimin dhe vendimmarrjen e konsumatorëve për produktet e tekstit.




Figura 70. Cilat nga rrjetet sociale i përdorni më së shpeshti për informim dhe blerje të produkteve të tekstit? Pyetje e shumëfishtë

8. REZULTATET NGA INTERVISTAT ME BIZNESE

Ky seksion do të përfshijë analizën e të dhënave të mbledhura përmes anketës së zhvilluar me kompani që operojnë në sektorin e veshmbathjes dhe tekstit shtëpiak në Kosovë. Të dhënat do të ndihmojnë në identifikimin e praktikave aktuale, sfidave dhe potencialeve për përmirësim në drejtim të menaxhimit të mbeturinave, riciklimit dhe ekonomisë qarkore në këtë sektor.

8.1 INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM PËR KOMPANINË

Në vazhdim prezantohet profili bazë i kompanive të intervistuar, duke përfshirë aktivitetin ekonomik, strukturën e pronësisë dhe fuqinë punëtore. Ky informacion është i rëndësishëm për të kuptuar kontekstin operacional dhe kapacitetet e sektorit për të përfshirë praktika të ekonomisë qarkore.

Aktivitetet e kompanive paraqiten më të shpërndara këtë vit, me një zhvendosje nga prodhimi drejt shitjes. Shitja me pakicë është aktiviteti më i përhapur, i raportuar në 32.7% të rasteve, ndërsa prodhimi i veshjeve të tekstit përbën 19.4%. Rrobaqepësia mbetet një aktivitet i rëndësishëm me 13.3%, ndërsa puna artizanale përfaqësohet në 7.1% të rasteve. Aktivitete të tjera si pastrimi kimik dhe shitja me shumicë shfaqen në nivele më të ulëta (nga 4.1%), ndërsa përpunimi i tekstit dhe kombinimi i shitjes me pakicë dhe shumicë janë secila në 3.1%. Aktivitetet më të specializuara, si dizajni i modës, prodhimi i uniformave apo produkteve specifike, paraqiten me përqindje të vogla

individuale. Kraheluar me vitin e kaluar ku dominonte prodhimi, këto rezultate tregojnë një orientim më të theksuar drejt tregtisë, veçanërisht shitjes direkte te konsumatori.



Figura 71. Veprimtaria e kompanisë

Sa i përket gjinisë së pronarit të kompanisë, në 48.0% përqind të rasteve këto kompani kanë pronarë meshkuj, ndërsa në 56.0% përqind të rasteve kanë pronare femra. Në këtë përfshihen edhe rastet kur kompanitë kanë më shumë se një pronar.




Figura 72. Gjinia e pronarëve të kompanisë

Këto kompani kanë deklaruar në total 1,131 punëtorë, ku 804 punëtorë (apo 71.1% e tyre) janë femra ndërsa vetëm 327 janë meshkuj (28.9%).




Figura 73. Numri i punëtorëve në kompani sipas gjinisë

Duhet pasur parasysh se numri i kompanive që kanë deklaruar vlera për eksport dhe import është i kufizuar (N=15 për eksport dhe N=21 për import). Në përgjithësi, 16.0% e kompanive kanë deklaruar se kanë eksportuar në vitin 2025, ndërsa 22.0% kanë raportuar se kanë importuar. Vlera totale e eksporteve për kompanitë që kanë dhënë përgjigje arrin në rreth 9.4 milion euro, ndërsa vlera totale e importeve është më e lartë, duke arritur në rreth 11.7 milion euro.




Figura 74. Vlerat e deklaruar të eksportit dhe importit të kompanive

Të dhënat nga intervistat me bizneset tregojnë se aktiviteti tregtar ndërkombëtar i kompanive të anketuara është shumë më i përqendruar te importi sesa te eksporti, sidomos në aspektin sasior. Në eksport, Gjermania del si destinacioni kryesor me 17,356 kg, e ndjekur nga SHBA me 2,026 kg dhe Sllovenia me 2,000 kg, ndërsa sasitë për shtetet e tjera janë dukshëm më të ulëta. Kjo sugjeron se një numër i kufizuar tregjesh përthithin pjesën më të madhe të eksporteve të raportuara nga bizneset, ndërsa prania në tregje të tjera mbetet sporadike dhe me volum shumë të vogël.




Figura 75. Në cilat shtete keni eksportuar në vitin 2025?

Në anën tjetër, importi është i dominuar qartë nga Turqia me 553,041 kg dhe Kina me 211,501 kg, ndërsa pas tyre renditen në distancë të madhe Gjermania me 17,753 kg dhe India me 8,951 kg. Ky hendek shumë i madh mes dy furnitorëve kryesorë dhe vendeve të tjera tregon një përqendrim të lartë të furnizimit të bizneseve kosovare në disa tregje të mëdha prodhuese, veçanërisht në Turqi dhe Kinë. Krahësuar me eksportin, importi paraqitet jo vetëm më i lartë në total, por edhe shumë më i konsoliduar për nga origjina e mallrave.




Figura 76. Në cilat shtete keni importuar në vitin 2025?

Furnizimi me lëndë të parë dominohet nga burimet brenda vendit, me 78.0% të kompanive që deklarojnë se furnizohen në Kosovë, në rritje nga 68.0% një vit më parë. Në të njëjtën kohë, pjesa e atyre që furnizohen jashtë Kosovës ka rënë në 22.0% (nga 32.0%). Kjo tregon një orientim më të fortë drejt tregut vendor si burim furnizimi.




Figura 77. Ku furnizohet kompania juaj me lëndën e parë?

Nga kompanitë që furnizohen jashtë Kosovës, Turqia mbetet burimi kryesor, e përmendur në 54.5% të rasteve (valid percent), megjithëse në nivel më të ulët krahasuar me rreth 69% një vit më parë. India renditet më pas me 9.1%, ndërsa vendet e tjera si Austria, Danimarka, Gjermania, Italia, Kina, Mali i Zi, Maqedonia dhe Rumania paraqiten secila me nga 4.5%. Këto vende janë ndër furnizuesit kryesorë të materialeve tekstile sintetike, si poliesteri, nyloni dhe elastani, të cilat janë jo biodegraduese dhe paraqesin sfida për mjedisin për shkak të vështirësisë në riciklim dhe kohës së gjatë të dekompozimit.




Figura 78. Specifikoni vendin ku jashtë Kosovës?

Rezultatet tregojnë se shitja me pakicë është forma dominuese e shitjes në vitin 2025, e raportuar nga 73.0% e kompanive, duke shënuar një rritje të ndjeshme krahasuar me 53.0% një vit më parë. Në të kundërt, shitja me shumicë ka rënë në 11.0% (nga 27.0%), ndërsa 16.0% e kompanive operojnë në të dy format (nga 20.0%). Kjo zhvendosje drejt shitjes me pakicë tregon një orientim edhe më të fortë drejt konsumatorëve individualë. Në këtë kontekst, rritet edhe gjasësia për gjenerim më të madh të mbeturinave, pasi shitjet me pakicë zakonisht lidhen me më shumë paketim dhe shpërndarje në njësi më të vogla, duke rritur volumnin e mbeturinave në fund të ciklit të përdorimit.




Figura 79. Cila ka qenë forma kryesore e shitjes në kompaninë tuaj në vitin 2025?

8.2 PËRDORIMI I LËNDËVE TË PARA PËR PRODHIM

Zgjedhja e materialeve të produkteve të tekstilit ndikon drejtpërdrejt në mjedis. Për këtë arsye, në këtë pjesë analizohet se cilat lëndë të para përdoren më shumë nga kompanitë, si dhe preferencat e konsumatorëve që formësojnë këtë kërkesë.

Të dhënat tregojnë se aktiviteti kryesor i kompanive është më i shpërndarë krahasuar me vitin e kaluar. Shitja me pakicë përbën kategorinë kryesore me 36.0%, e ndjekur nga prodhimi me 33.0% dhe shërbimet (si dizajni, rregullimet dhe përshtatjet e tekstilit) me 21.0%. Shitja me shumicë mbetet minimale me 4.0%, ndërsa ripërpunimi paraqitet në vetëm 1.0%. Krahasuar me vitin e kaluar, vihet re një rënie e rolit të prodhimit si aktivitet dominues (nga 42.0% në 33.0%), ndërsa aktivitetet e shitjes, veçanërisht ajo me pakicë, marrin një peshë më të madhe në strukturën e tregut. Shërbimet mbeten relativisht të qëndrueshme (21.0% kundrejt 23.0%), ndërsa ripërpunimi vazhdon të jetë shumë i kufizuar, madje edhe më i ulët se më parë (nga 6.0% në 1.0%). Kjo tregon një orientim më të fortë drejt tregtisë dhe më pak drejt prodhimit dhe ripërpunimit, duke nënkuptuar se cikli i materialeve mbetet i kufizuar dhe potenciali për ri-qarkullim të tekstilit vazhdon të jetë i ulët.




Figura 80. Cili është aktiviteti kryesor i kompanisë tuaj?

Të dhënat tregojnë se veshjet për dasma dhe evente mbeten produkti kryesor edhe tek prodhuesit, të raportuara në 34.0% të rasteve, ndonëse në rënie krahasuar me 42.7% një vit më parë. Pas tyre renditen veshjet për fëmijë (12.0%), si dhe veshjet sportive dhe farmerkat (nga 9.0% secila). Produkte si veshjet e brendshme, këpucë dhe artikuj lëkure, çorape dhe tekstili shtëpiak raportohen secila në rreth 7.0%, ndërsa kostumet (6.0%) dhe perdet (5.0%) paraqiten në nivele më të ulëta. Ndryshim i dukshëm vërehet te uniformat e punës, të cilat nga 14.7% vitin e kaluar kanë rënë në vetëm 2.0%. Po ashtu, tekstili shtëpiak, i cili më parë ishte ndër kategoritë më të përmendura (16.0%), tani paraqitet në një nivel më të ulët (7.0%).




Figura 81. Nëse kompania juaj është prodhuese, cilat produkte i prodhoni? (Pyetje e shumëfishtë)

Rezultatet tregojnë se dizajni tekstil mbetet shërbimi më i ofruar, i raportuar në 25.0% të rasteve, megjithëse në nivel dukshëm më të ulët krahasuar me 48.6% një vit më parë. Personalizimi i produkteve (p.sh. qëndisje, printime) paraqitet në 19.0%, duke mbetur relativisht i qëndrueshëm krahasuar me 18.9% më parë. Në të kundërt, riparimi i veshjeve ka rënë ndjeshëm, nga 23.0% në 8.0%, duke treguar një reduktim të këtij lloji shërbimi. Konsulenca për modë ose tekstil vazhdon të jetë ndër shërbimet më pak të përhapura, me 4.0%, në rënie nga 6.8% vitin e kaluar. Gjithashtu, 49.0% e respondentëve kanë deklaruar se kjo pyetje nuk aplikohet për ta, ndërsa 12.0% kanë përmendur shërbime të tjera, çka sugjeron se një pjesë e konsiderueshme e kompanive nuk operojnë në ofrimin e shërbimeve të tilla.




Figura 82. Nëse kompania juaj ofron shërbime, cilat janë shërbimet kryesore që ofroni? (Pyetje e shumëfishtë)

Veshjet për dasma dhe evente vazhdojnë të jenë ndër produktet më të shitura, të raportuara në 25.0% të rasteve, megjithëse në nivel më të ulët krahasuar me 40.8% një vit më parë. Në të njëjtën kohë, struktura e produkteve të shitura paraqitet më e shpërndarë. Veshjet për fëmijë (13.0%) dhe farmerkat (10.0%) zënë një pjesë të konsiderueshme, ndërsa kategori të tjera si veshjet sportive (9.0%) dhe veshjet e brendshme (8.0%) mbeten në nivele mesatare. Produkte si këpucë dhe artikuj lëkure, çorape, kostume dhe tekstili shtëpiak raportohen secila në rreth 7.0%, ndërsa perdet (6.0%) dhe qilimat (3.0%) paraqiten më rrallë; ndërkohë, përgjigjet në "tjetër" tregojnë kryesisht kategori të përgjithshme si "veshje të ndryshme" apo fokus në segmente specifike si veshje për femra. Ndryshimi më i theksuar lidhet me uniformat e punës, të cilat nga 19.7% vitin e kaluar kanë rënë në vetëm 2.0%, duke humbur rolin e tyre si një nga kategoritë kryesore.




Figura 83. Nëse kompania juaj është shitës me pakicë/shumicë, cilat produkte kryesore shisni? (Pyetje e shumëfishtë)

Rezultatet tregojnë se pambuku mbetet materiali më i përdorur në produktet e prodhuara, i raportuar në 38.5% të rasteve, bazuar në numrin e përgjigjeve të vlefshme (N=13). Megjithatë, ky nivel është dukshëm më i ulët krahasuar me 63.3% një vit më parë. Pëlhura tekstili përbën 23.1%, ndërsa lëkura natyrale dhe materialet sintetike raportohen secila me nga 15.4%. Poliesteri paraqitet në nivel më të ulët, me 7.7%. Dominimi relativ i pambukut dhe prania e lëkurës natyrale mund të lidhen me gjenerim më të ulët të mbeturinave jo-biodegraduese, ndërsa përdorimi, edhe në nivel më të kufizuar, i materialeve sintetike dhe poliestarit vazhdon të kontribuojë në mbeturinave më të qëndrueshme dhe më të vështira për t'u trajtuar në mjedis.




Figura 84. Cila është lënda e parë që përdorni për produktet e prodhuara?

Pambuku vazhdon të kryesojë si materiali më i kërkuar nga klientët, me 60.6%, duke mbetur pothuajse në të njëjtin nivel me vitin e kaluar (61.0%). Edhe poliesteri mbetet ndër materialet më të përdorura, me 42.4%, megjithëse në rënie të lehtë krahasuar me 46.0% më parë. Në anën tjetër, materialet sintetike raportohen në 22.2%, më pak se 28.0% një vit më parë. Paralelisht, shfaqen më shumë materiale si pelhura liri (29.3%) dhe materialet e thurura (20.2%), duke treguar një zgjerim të llojeve të materialeve që përdoren. Kategoria “tjetër” përfaqëson 29.3%, ku përfshihen raste kur materialet sigurohen nga vetë klientët ose përdoren lloje të ndryshme pëlhurash, çka sugjeron një qasje më fleksibile në furnizim dhe përzgjedhje materialesh.




Figura 85. Cilat janë materialet që kërkojnë më shumë nga klientët tuaj dhe që kanë më shumë shitje? (Pyetje e shumëfishtë)

8.3 MENAXHIMI I MBETURINAVE

Mënyra si kompanitë menaxhojnë mbeturinat e tyre është kyçe për të vlerësuar ndikimin mjedisor dhe potencialin për ripërdorim dhe riciklim. Në vazhdim analizohen praktikat aktuale dhe hapësirat për përmirësim në këtë drejtim.

Të dhënat tregojnë se gjatë vitit 2025 kompanitë janë mbështetur edhe më shumë në deponitë komunale për menaxhimin e mbeturinave të materialeve, me 70.0% që raportojnë këtë praktikë, krahasuar me 61.0% në vitin paraprak. Në të njëjtën kohë, praktikat më të lidhura me ekonominë qarkore kanë shënuar rënie: përdorimi i materialeve të mbetura ka rënë nga 37.0% në 15.0%, bashkëpunimi me iniciativë për rishfrytëzim nga 10.0% në 4.0%, ndërsa riciklimi nga 6.0% në 4.0%. Kjo prirje mund të lidhet edhe me ndryshimet në profilin e kompanive të anketuara, ku aktivitetet këtë vit paraqiten më të orientuara drejt shitjes me pakicë dhe më pak drejt prodhimit, ripërpunimit dhe shërbimeve të riparimit. Shitja me pakicë është rritur si aktivitet kryesor, ndërsa ripërpunimi mbetet shumë i kufizuar dhe riparimi i veshjeve ka rënë dukshëm krahasuar me vitin

paraprak. Në këtë kontekst, më pak kompani duket se kanë procese të brendshme ku materialet e mbetura mund të rikthehen në përdorim, gjë që mund të shpjegojë rënien e rishfrytëzimit dhe rritjen e mbështetjes në deponim. Në tërësi, krahasimi ndërmjet dy viteve tregon një zhvendosje negative nga praktikrat më qarkore drejt formave më tradicionale të menaxhimit të mbeturinave, duke theksuar nevojën për më shumë mbështetje praktike, lidhje me kompani riciklimi dhe mekanizma që e bëjnë ripërdorimin e materialeve më të zbatueshëm për bizneset.




Figura 86. Si i menaxhon kompania juaj mbeturinat e materialeve në procesin e prodhimit? (Pyetje e shumëfishtë)

Krahasimi me vitin 2024 tregon një zhvillim negativ në mënyrën se si kompanitë menaxhojnë mbeturinat e materialeve. Në vend që të rriten praktikrat e ripërdorimit, rishfrytëzimit apo riciklimit, të dhënat tregojnë një mbështetje më të madhe në deponitë komunale, e cila është rritur nga 61.0% në 70.0%. Kjo sugjeron se menaxhimi i mbeturinave mbetet kryesisht linear dhe i orientuar drejt largimit të mbeturinave, jo drejt rikthimit të materialeve në përdorim. Rënia e përdorimit të materialeve të mbetura, nga 37.0% në 15.0%, është veçanërisht e rëndësishme, sepse tregon se më pak kompani po i shohin mbetjet si burim të mundshëm për ripërdorim. Kjo mund të lidhet me mungesën e kapaciteteve të brendshme, mungesën e zgjidhjeve të jashtme të riciklimit, kostot e trajtimit ose faktin që një pjesë më e madhe e kompanive këtë vit janë të orientuara drejt shitjes me pakicë dhe jo drejt prodhimit, ku materialet e mbetura mund të rikthehen më lehtë në proces. Në këtë kuptim, rezultatet tregojnë se ekonomia qarkore ende nuk është integruar në praktikrat

operative të shumicës së kompanive, ndërsa deponimi mbetet zgjidhja më e lehtë dhe më e përdorur.




Figura 87. Si i menaxhon kompania juaj mbeturinat e materialeve në procesin e prodhimit? Krahësimi 2024—2025 (Pyetje e shumëfishtë)

Shumica e atyre që deklarojnë se grumbullojnë mbeturinat e materialit e bëjnë këtë me frekuencë javore (N=61). Konkretisht, 62.3% raportojnë se i grumbullojnë 1 herë në javë, duke e bërë këtë praktikën më të zakonshme. Një pjesë më e vogël, 26.2%, i grumbullojnë çdo ditë, çka tregon për një nivel më të lartë të vazhdimësisë në menaxhimin e mbeturinave të materialit. Frekuencat më të ulëta janë shumë pak të përfaqësuara, ku vetëm 1.6% raportojnë grumbullim 1 herë në muaj. Ndërkohë, 4.9% deklarojnë se nuk aplikohet për ta, dhe po aq (4.9%) kanë dhënë përgjigje të tjera. Këto gjetje sugjerojnë se grumbullimi i mbeturinave të materialit është një praktikë relativisht e rregullt për shumicën, kryesisht në baza javore, ndërsa mungesa e frekuencave më të rralla mund të lidhet me natyrën e vazhdueshme të prodhimit dhe gjenerimit të mbeturinave në këtë sektor.




Figura 88. Nëse po, sa herë i grumbullojnë mbeturinat e materialit?

Lloji më i zakonshëm i mbeturinave të gjeneruara gjatë procesit të punës janë mbeturinat tekstile, të raportuara nga 49.0% e respondentëve, duke reflektuar natyrën e sektorit dhe proceset e prerjes dhe përpunimit të materialeve. Pas tyre, mbeturinat nga letër/karton (28.0%) dhe plastika (24.0%) përbëjnë kategori të rëndësishme, duke sugjeruar një prani të konsiderueshme të materialeve ndihmëse dhe ambalazhuese në procesin e prodhimit. Ndërkohë, llojet e tjera të mbeturinave janë shumë më pak të përhapura. Vetëm 3.0% raportojnë mbeturina nga ambalazhimi i lëndës së parë, ndërsa mbeturinat nga ambalazhimi i produkteve finale, metalet dhe druri raportohen secila nga 1.0% e respondentëve. Një përqindje relativisht e konsiderueshme (16.0%) ka përzgjedhur kategorinë “Tjetër”, duke deklaruar se nuk kanë mbeturina. Në tërësi, gjetjet tregojnë se mbeturinat tekstile dominojnë qartë strukturën e mbeturinave të gjeneruara, ndërsa materialet e ambalazhimit dhe ndihmëse përbëjnë një shtresë dytësore të rëndësishme në profilin e mbeturinave.




Figura 89. Cilat janë llojet kryesore të mbeturinave që gjeneroni gjatë procesit të punës?

Në vitin 2025, profili i mbeturinave duket më i lidhur me aktivitetet e shitjes, paketimit dhe qarkullimit të produkteve sesa vetëm me prodhimin. Edhe pse mbetjet tekstile mbeten kategoria kryesore, rënia e tyre nga 73.0% në 49.0% sugjeron më pak raportim të mbetjeve që lidhen drejtpërdrejt me prerjen, qepjen apo përpunimin e materialit. Në të njëjtën kohë, rritja e letrës/kartonit dhe plastikës mund të reflektojë peshën më të madhe të aktiviteteve tregtare dhe të paketimit në këtë valë. Prandaj, ndryshimi nuk duhet lexuar vetëm si ulje e mbetjeve tekstile, por edhe si tregues i një profili më të shpërndarë të aktiviteteve të kompanive dhe të llojeve të mbeturinave që ato gjenerojnë.




Figure 90. Cilat janë llojet kryesore të mbeturinave që gjeneroni gjatë procesit të punës? Krahاسimi 2024-2025

Rreth 9% e kompanive kanë deklaruar se nuk kanë njohuri se sa ton mbeturina tekstili gjenerojnë në vit, çka sugjeron mungesë të matjes apo monitorimit të këtij aspekti. Megjithatë, pjesa më e madhe e kompanive (69%) kanë raportuar se nuk gjenerojnë fare mbeturina tekstili (0 ton). Duke u fokusuar vetëm tek kompanitë që kanë raportuar sasi pozitive të mbeturinave (rreth 22% e mostrës), vërehet se shumica operojnë në nivele shumë të ulëta të gjenerimit, kryesisht nën 1 ton në vit. Një pjesë më e vogël raportojnë nivele më të larta (mbi 1 ton), ndërsa vetëm raste të izoluara raportojnë sasi shumë të mëdha (mbi 50 ton). Në total, bazuar në shpërndarjen e raportuar, kompanitë që kanë dhënë vlerësime kontribuojnë me një volum të përgjithshëm të konsiderueshëm të mbeturinave tekstile në vit, megjithëse kjo mbetet e përqendruar në një numër të vogël aktorësh me nivele më të larta prodhimi.




Figura 91. Sa ton mbeturina tekstili gjeneron kompania juaj në vit?

Nga këto të dhëna për sektorin e bizneseve të tekstilit kemi kalkuluar në mënyrë të përafërt gjenerimi i përgjithshëm i mbeturinave të tekstilit. Duke përdorur mesataret e deklaruara të gjenerimit të mbeturinave sipas kategorive kryesore të aktivitetit dhe duke i shkallëzuar ato me shpërndarjen aktuale të bizneseve aktive në Kosovë, vlerësohet se sektori gjeneron rreth 10,338.62 ton mbeturina tekstili në vit.

Ky kalkulim përfaqëson një **vlerësim indikativ**, duke qenë se mungojnë të dhëna sistematike dhe zyrtare mbi menaxhimin e mbeturinave tekstile në sektorin privat në Kosovë.

Një numër edhe më i vogël (5%) ka raportuar se kanë një sistem për ripërdorimin e materialeve të mbetura brenda procesit të prodhimit.

Kjo tregon një mungesë të theksuar të monitorimit dhe menaxhimit të mbeturinave në shumicën e kompanive, praktikat e qëndrueshme ende nuk janë të institucionalizuara, dhe se ka hapësirë të madhe për përmirësim në drejtim të ekonomisë qarkore, riciklimit dhe reduktimit të mbeturinave që përfundojnë në deponi.





Figura 92. A ka kompania juaj një sistem për ripërdorimin e materialeve të mbetura brenda procesit të prodhimit?

Krahasuar me vitin 2024, përqindja e kompanive që deklarojnë se kanë sistem për ripërdorimin e materialeve të mbetura brenda procesit të prodhimit ka rënë ndjeshëm, nga 27.0% në 5.0%. Në të njëjtën kohë, përqindja e kompanive që nuk kanë një sistem të tillë është rritur nga 73.0% në 95.0%. Ky ndryshim tregon se praktikatat e brendshme të ripërdorimit janë bërë edhe më të kufizuara në vitin 2025. Kjo mund të lidhet me orientimin më të madh të kompanive drejt shitjes dhe më pak drejt prodhimit/ripërpunimit, me kapacitetet e kufizuara për ndarjen dhe trajtimin e materialeve të mbetura, si dhe me mungesën e sistemeve të formalizuara për rikthimin e materialeve në procesin e punës.



Ndër kompanitë që kanë raportuar (N=5), praktikatat më të zakonshme lidhen me ripërdorimin kreativ të materialeve dhe transformimin e tyre në produkte më të vogla (secila me 40.0%). Një pjesë më e vogël (20.0%) përmendin rregullimin e veshjeve si formë ripërdorimi. Këto gjetje

tregojnë se, megjithëse ekzistojnë disa iniciativa për ripërdorim, ato mbeten të kufizuara dhe kryesisht të orientuara drejt zgjidhjeve praktike dhe artizanale, pa një përhapje të gjerë në sektor.




Figura 93. Ju lutem përshkruani shkurtimisht sistemin për ripërdorimin e materialeve të mbetura Brenda procesit të prodhimit?

8.4 EKONOMIA QARKORE

Për të kuptuar gatishmërinë e sektorit për të kaluar drejt modeleve të qëndrueshme, është e rëndësishme të vlerësojmë njohuritë dhe interesimin e kompanive për ekonominë qarkore. Njohja për konceptin e ekonomisë qarkore rezulton të jetë e ulët në mesin e kompanive të anketuara. Vetëm 19.0% deklarojnë se kanë dëgjuar për këtë koncept, ndërsa shumica dërrmuese, 81.0%, nuk kanë njohuri për të. Nga këto kompani shumica shprehen të interesuara për ta zbatuar atë në praktikë. Konkretisht, 63.2%, deklarojnë se janë të interesuara të aplikojnë parimet e ekonomisë qarkore në kompaninë e tyre, ndërsa 36.8% nuk shprehin interes. Dallimi i madh ndërmjet njohjes së ulët të konceptit dhe interesimit relativisht të lartë për zbatim sugjeron se pengesa kryesore nuk është domosdoshmërisht mungesa e gatishmërisë, por mungesa e informimit. Pra, shumica e kompanive ende nuk e njohin ekonominë qarkore si koncept, por ato që kanë dëgjuar për të duket se e shohin si të rëndësishme dhe potencialisht të zbatueshme në praktikë. Kjo tregon se ekonomia qarkore ende nuk është pjesë e njohurive të përgjithshme të sektorit, por kur prezantohet ose kuptohet, krijon interes. Për këtë arsye, rezultatet sugjerojnë nevojën për më shumë informim praktik, shembuj konkretë dhe udhëzime të thjeshta për bizneset, në mënyrë që koncepti të mos mbetet abstrakt, por të lidhet me përfitime të qarta si reduktimi i mbeturinave, kursimi i materialeve dhe bashkëpunimi me riciklues.




Figura 94. A keni dëgjuar për konceptin e ekonomisë qarkore?

Duke u bazuar në numrin e kompanive që kanë njohuri për ekonominë qarkore, shumica shprehin gatishmëri ose interes për të filluar me riciklim dhe për të zbatuar praktikatat e ekonomisë qarkore, megjithëse vetëm një pjesë shumë e vogël i kanë filluar tashmë këto praktika. 10 nga 19 kompani deklarojnë se kanë interes, por nuk kanë filluar ende, ndërsa vetëm 1 kompani ka filluar tashmë zbatimin. Nga ana tjetër, 5 kompani shprehen se kjo nuk është prioritet për momentin, ndërsa 3 kompani nuk janë të sigurt.

Tabela 6. A është kompania juaj e gatshme të fillojë me riciklim dhe të zbatojë praktikatat e ekonomisë qarkore?

Përgjigjet	Frekuenca
Po, kemi interesim, por nuk kemi filluar ende	10
Jo, nuk është prioritet për momentin	5
Nuk jam i/e sigurt	3
Po, kemi filluar tashmë	1

Shumica e ketyre kompanive shprehin interes për pjesëmarrje në trajnime mbi ekonominë qarkore, veçanërisht për të përfshirë të gjitha nivelet brenda kompanisë. Konkretisht, 9 nga 19 kompani janë të interesuara për trajnime si për stafin menaxhues ashtu edhe për punëtorët në prodhim, duke treguar një qasje më gjithëpërfshirëse ndaj zhvillimit të kapaciteteve. Ndërkohë, 4 kompani shprehin interes vetëm për stafin menaxhues dhe 2 kompani vetëm për punëtorët në prodhim. Nga ana tjetër, 4 kompani deklarojnë se nuk kanë interes për pjesëmarrje në trajnime.

Tabela 7. A do të ishit të interesuar për pjesëmarrje në trajnime për ekonominë qarkore për biznesin dhe punëtorët tuaj?

Përgjigjet	Frekuenca
Po, për të dyja kategoritë	9
Po, për stafin menaxhues	4
Jo, nuk kemi interesim	4
Po, për punëtorët në prodhim	2

8.5 NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE GJURMËT E KARBONIT

Në vazhdim studimi shqyrton sa të vetëdijshme janë kompanitë për ndikimin që shkaktojnë dhe sa të gatshme janë ato të marrin masa për të ulur gjurmën e tyre të karbonit.

Krahasuar me vitin 2024, niveli i shqetësimit të kompanive për ndikimin mjedisor të aktivitetit të tyre ka shënuar një përmirësim të lehtë, por jo një ndryshim të thellë. Pjesa e kompanive që shprehen “shumë të shqetësuar” mbetet e pandryshuar në 10.0%, ndërsa ato që janë “të shqetësuar” janë rritur nga 20.0% në 27.0%. Në të njëjtën kohë, qëndrimi neutral mbetet pothuajse i njëjtë, nga 35.0% në 34.0%, duke treguar se një pjesë e madhe e kompanive ende nuk kanë qëndrim të qartë apo aktiv ndaj ndikimit mjedisor. Ndryshimi më pozitiv vërehet te ulja e kompanive që janë “aspak të shqetësuar”, nga 22.0% në 15.0%, çka sugjeron një rënie të indiferencës së plotë ndaj kësaj çështjeje. Megjithatë, përqindja e lartë e përgjigjeve neutrale dhe ende e konsiderueshme e atyre me shqetësim të ulët tregon se vetëdija mjedisore është rritur lehtë, por nuk është përkthyer ende në një nivel të fortë përgjegjësie apo prioriteti për shumicën e kompanive.




Figura 95. Sa jeni të shqetësuar për ndotjen që veprimtaria e kompanisë suaj shkakton në mjedis?

Gatishmëria për të investuar në përmirësimin e praktikave për reduktimin e ndikimit mjedisor dhe gjurmës së karbonit paraqitet relativisht e ulët. 27.0% e kompanive deklarojnë se janë të gatshme të bëjnë investime në këtë drejtim, ndërsa shumica, 73.0%, shprehen se nuk janë të gatshme. Këto rezultate sugjerojnë se, pavarësisht një niveli të caktuar ndërgjegjësimi për çështjet mjedisore, kjo nuk është ende përkthyer në gatishmëri konkrete për investim, duke reflektuar mundësisht kufizime financiare apo mungesë prioriteti në këtë fushë.




Figura 96. A jeni të gatshëm të investoni në përmirësimin e praktikave për të reduktuar ndikimin mjedisor dhe gjurmët e karbonit?

Në vitin 2025, kompanitë shfaqin një gatishmëri dukshëm më të ulët për të investuar në përmirësimin e praktikave për reduktimin e ndikimit mjedisor dhe gjurmës së karbonit. Krahësuar me vitin paraprak, përqindja e kompanive që deklarojnë gatishmëri për investim ka rënë nga 70.0% në 27.0%, ndërsa pjesa që nuk është e gatshme është rritur nga 30.0% në 73.0%. Ky ndryshim i madh negativ sugjeron se ndërgjegjësimi për çështjet mjedisore nuk është përkthyer në të njëjtën masë në gatishmëri praktike për investim. Rënia mund të lidhet me disa faktorë të mundshëm, si kostot e larta të investimeve të gjelbra, mungesa e stimuljeve financiarë, pasiguria mbi kthimin e investimit, kapacitetet e kufizuara të bizneseve të vogla, si dhe fakti që shumë kompani këtë vit duken më të orientuara drejt shitjes me pakicë sesa drejt prodhimit, ku investimet mjedisore mund të perceptohen si më të drejtpërdrejta dhe të nevojshme. Kjo tregon se për të nxitur investime mjedisore në sektor nuk mjafton vetëm rritja e vetëdijes, por nevojiten edhe mekanizma mbështetës, informim më i qartë dhe stimuj praktikë për bizneset.




Figura 97. A jeni të gatshëm të investoni në përmirësimin e praktikave për të reduktuar ndikimin mjedisor dhe gjurmët e karbonit? Krahësimi 2024-2025

8.6 REGULLAT MJEDISORE PËR EKSPORT

Rritja e standardeve mjedisore në tregjet ndërkombëtare kërkon që kompanitë eksportuese të përmbushin kritere të qarta për qëndrueshmëri. Ky nënseksion vlerëson shkallën e përgatitjes së bizneseve kosovare për të operuar në këtë kuadër të ri.

Duke u fokusuar në kompanitë eksportuese në BE (N=16), shumica dërrmuese shprehin gatishmëri për të investuar në përmbushjen e kriterëve mjedisore të kërkuara për eksport. 75.0% deklarojnë se janë të gatshme të investojnë, duke treguar një orientim të fortë drejt përputhjes me standardet e tregut të BE-së. Nga ana tjetër, vetëm 6.3% shprehen se nuk janë të gatshme, ndërsa po aq (6.3%) nuk janë të sigurt. Një pjesë prej 12.5% theksojnë se nuk kanë mjaftueshëm informata lidhur me këtë çështje, çka sugjeron nevojën për informim dhe mbështetje shtesë. Në tërësi, rezultatet tregojnë një nivel të lartë gatishmërie për investim ndër kompanitë eksportuese, të shoqëruar me një nevojë për rritje të qartësisë dhe informimit për një pjesë më të vogël të tyre.




Figura 98. Për kompanitë eksportuese në BE: A jeni të gatshëm të investoni për të përmbushur kriteret mjedisore që kërkohen për eksport?

8.7 INTERESIMI DHE SFIDAT PËR RICIKLIM

Ndërmarrjet që operojnë në sektorin e tekstilit kanë një rol të rëndësishëm në zhvillimin e zinxhirit të riciklimit. Në këtë pjesë, analizohen pengesat kryesore dhe niveli aktual i angazhimit të tyre në praktikën e ripërdorimit dhe riciklimit të mbeturinave.

Përfshirja e kompanive në iniciativë të ripërdorimit dhe riciklimit për mbeturinat pas prodhimit paraqitet e ulët. Vetëm 5.0% e kompanive deklarojnë se aktualisht janë të përfshira në iniciativë të tilla, ndërsa shumica, 64.0%, nuk janë të angazhuara në këto praktika. Një pjesë e konsiderueshme, 31.0%, shprehen se nuk janë të sigurta ose nuk kanë njohuri për këtë çështje.




Figura 99. A është kompania juaj aktualisht e përfshirë në ndonjë iniciativë ripërdorimi dhe riciklimi për mbeturinat pas prodhimit?

Në krahasim me vitin 2024, ndryshimet janë të lehta. Kjo sugjeron një zhvendosje të vogël nga pasiguria drejt qëndrimeve më të qarta, por pa ndryshim substancial në nivelin e përgjithshëm të angazhimit praktik.




Figura 100. A është kompania juaj aktualisht e përfshirë në ndonjë iniciativë ripërdorimi dhe riciklimi për mbeturinat pas prodhimit? Krahasimi 2024-2025

Megjenëse kjo është pyetje e hapur dhe kategoritë janë krijuar pas pastrimit/kodimit të përgjigjeve, krahasimi me vitin paraprak duhet të bëhet vetëm në nivel tematik, aty ku kategoritë janë të ngjashme. Në vitin 2024, pengesa kryesore ishte mungesa e informacionit për iniciativa riciklimi (53.3%), ndërsa në vitin 2025 kjo shfaqet më e shpërndarë ndërmjet mungesës së informacionit (18.8%) dhe pasigurisë apo mungesës së njohurive (21.9%). Kjo sugjeron se problemi nuk lidhet vetëm me mungesën e informacionit, por edhe me mungesën e qartësisë se si kompanitë mund të përfshihen praktikisht.

Ndryshimi tjetër lidhet me perceptimin e nevojës. Në vitin 2024, 13.3% e kompanive e lidhnin mospërfshirjen me faktin se ishin biznese të vogla dhe nuk gjeneronin shumë mbeturina, ndërsa në vitin 2025 15.6% raportojnë mbeturina minimale dhe 28.1% deklarojnë se nuk shohin nevojë për përfshirje. Kjo tregon se një pjesë e kompanive nuk e perceptojnë riciklimin si relevant për aktivitetin e tyre, sidomos nëse gjenerojnë pak mbeturina ose nuk kanë sisteme të brendshme për matjen e tyre. Për këtë arsye, nevoja nuk është vetëm për informim të përgjithshëm, por për komunikim më praktik mbi përfitimet, mënyrat e përfshirjes dhe zgjidhjet e përshtatura për biznese të vogla.




Figura 101. Nëse jo, pse nuk jeni të përfshirë?

Të dhënat e vitit 2025 tregojnë se bashkëpunimi i kompanive me kompani riciklimi për menaxhimin e mbeturinave të tekstilit mbetet shumë i kufizuar. Vetëm 4.0% e kompanive raportojnë se kanë bashkëpunim aktiv, ndërsa shumica dërrmuese, 79.0%, deklarojnë se nuk bashkëpunojnë me kompani të tilla. Një pjesë më e vogël, 12.0%, janë të interesuara por aktualisht nuk janë të angazhuara, ndërsa 5.0% nuk e dinë nëse ekzistojnë kompani të tilla.

Krahasuar me vitin paraprak, bashkëpunimi aktiv është rritur lehtë nga 2.0% në 4.0%, por mbetet në nivel shumë të ulët. Në të njëjtën kohë, përqindja e kompanive që nuk bashkëpunojnë është rritur nga 62.0% në 79.0%, ndërsa grupi i kompanive të interesuara por jo të angazhuara ka rënë nga 18.0% në 12.0%. Po ashtu, mungesa e informacionit për ekzistencën e kompanive të riciklimit ka rënë nga 18.0% në 5.0%. Kjo sugjeron se problemi nuk lidhet më vetëm me mungesën e

informacionit, por më shumë me mungesën e angazhimit praktik dhe lidhjeve funksionale ndërmjet bizneseve dhe sektorit të riciklimit.




Figura 102. A bashkëpunon kompania juaj me ndonjë kompani riciklimi për menaxhimin e mbeturinave të tekstilit?

Krahasuar me vitin e kaluar, interesi për bashkëpunim me kompani riciklimi ka pësuar rënie të dukshme. Ndërsa më parë 67% e kompanive deklaroi se ishin të interesuara ose shumë të interesuara, këtë vit kjo përqindje bie në 41.0%. Megjithatë, edhe pse niveli aktual i bashkëpunimit mbetet shumë i ulët (4.0%), diferenca mes praktikës aktuale dhe interesit potencial vazhdon të tregojë se ekziston hapësirë për zhvillim në këtë drejtim. Në të njëjtën kohë, vihet re një rritje e përqindjes së kompanive që nuk shprehin interes, e cila arrin në 46.0%, ndërsa 13.0% mbeten të pasigurt. Kjo sugjeron se barrierat si mungesa e informacionit, perceptimi i kostove apo mungesa e ofertës së strukturuar në treg mund të jenë bërë më të theksuara ose nuk janë adresuar mjaftueshëm gjatë kësaj periudhe.





Figura 103. A do të ishte e interesuar kompania juaj për të bashkëpunuar me një kompani riciklimi që specializohet në menaxhimin e mbeturinave të veshjeve?

Në vitin 2025, interesi i kompanive për bashkëpunim me kompani riciklimi ka rënë dukshëm krahasuar me vitin paraprak. Interesi pozitiv, që përfshin kompanitë "shumë të interesuara" dhe "të interesuara", ka zbritur nga 67.0% në 41.0%, ndërsa përqindja e kompanive që nuk janë të interesuara është rritur nga 17.0% në 46.0%. Kjo tregon një zhvendosje nga gatishmëria e përgjithshme drejt një qëndrimi më të rezervuar ndaj bashkëpunimit praktik. Rënia mund të lidhet me pengesat e raportuara në pyetjet e tjera, sidomos kostot e papërballueshme, mungesën e zgjidhjeve të qarta në treg, vështirësitë logjistike dhe faktin që riciklimi ende nuk shihet si prioritet i menjëhershëm nga një pjesë e kompanive. Në këtë kuptim, rezultatet sugjerojnë se për të rritur bashkëpunimin nuk mjafton vetëm informimi, por nevojiten edhe modele më të qarta, më të përballueshme dhe më praktike të bashkëpunimit me kompanitë e riciklimit.



Krahasuar me vitin e kaluar, struktura e pengesave për bashkëpunim me kompani riciklimi ka ndryshuar ndjeshëm. Ndërsa më parë pengesa kryesore ishte mungesa e informacionit (77.0%), këtë vit dominon qartë faktori financiar, ku 70.0% e kompanive identifikojnë kostot e papërballueshme si barrierën kryesore. Në të njëjtën kohë, mungesa e informacionit ka rënë në 39.0%, duke sugjeruar një përmirësim të pjesshëm në aksesin ose ndërgjegjësimin për shërbimet e riciklimit. Sfida logjistike kanë pësuar një rritje relative, nga 8.0% në 15.0%, duke treguar se aspektet operacionale po bëhen më të dukshme si pengesë në praktikë.




Figura 104. Ju lutem specifikoni pengesat kryesore që ka kompania juaj në lidhje me bashkëpunimin me një kompani të riciklimit.

Në vitin 2025, struktura e pengesave për bashkëpunim me kompani riciklimi ka ndryshuar ndjeshëm krahasuar me vitin paraprak. Në vitin 2024, pengesa kryesore ishte mungesa e informacionit për shërbimet e riciklimit të disponueshme, me 77.0%, ndërsa në vitin 2025 kjo kategori bie në 39.0%. Në të njëjtën kohë, kostot e papërballueshme janë rritur nga 17.0% në 70.0%, duke u bërë pengesa kryesore këtë vit. Kjo sugjeron se kompanitë mund të jenë më të vetëdijshme për ekzistencën e opsioneve të riciklimit, por përballen më shumë me kufizime praktike dhe financiare për t'i zbatuar ato.




Figura 105. A do të ishte e interesuar kompania juaj për të bashkëpunuar me një kompani riciklimi që specializohet në menaxhimin e mbeturinave të veshjeve? Krahاسimi 2024—2025

Preferencat e kompanive për menaxhimin e mbeturinave kanë pësuar një zhvendosje edhe më të theksuar drejt bashkëpunimit me kompani të jashtme të riciklimit. Ndërsa më parë vihej re një balancë e plotë midis dy qasjeve (66% për programe të brendshme dhe 66% për bashkëpunim të jashtëm), këtë vit bashkëpunimi me kompani riciklimi është rritur në 75.6%, duke u konsoliduar si opsioni dominues. Në të njëjtën kohë, preferenca për zhvillimin e programeve të zvogëlimit të mbeturinave brenda kompanisë ka rënë në 34.4%, duke treguar një ulje të ndjeshme të fokusit në zgjidhjet e brendshme. Vetëm 2.2% përmendin alternativa të tjera.




Figura 106. Cilat zgjidhje për menaxhimin e mbeturinave do të preferonte kompania juaj? (Pyetje e shumëfishtë)

Krahasuar me vitin 2024, preferencat e kompanive kanë lëvizur më qartë drejt bashkëpunimit me kompani të jashtme të riciklimit, i cili është rritur nga 66.0% në 75.6%. Në të kundërt, preferenca për programe të brendshme të zvogëlimit të mbeturinave ka rënë ndjeshëm, nga 66.0% në 34.4%. Kjo sugjeron se kompanitë mund ta shohin menaxhimin e mbeturinave si një proces që kërkon ekspertizë, kapacitete dhe infrastrukturë të jashtme, të cilat nuk janë lehtë të zhvillueshme brenda kompanisë.




Figura 107. Cilat zgjidhje për menaxhimin e mbeturinave do të preferonte kompania juaj? Krahësimi 2024–2025 (Pyetje e shumëfishtë)

Vërehet një rritje shumë e lehtë në numrin e kompanive që kanë plane për të zbatuar iniciativë të reja në përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së ambientit. Ndërsa më parë vetëm 1% e kompanive deklaroi se kishin plane të tilla, këtë vit kjo përqindje rritet në 2.0%. Megjithatë, shumica dërrmuese, 98.0%, vazhdojnë të mos kenë plane konkrete në këtë drejtim.




Figura 108. A ka kompania juaj në plan për të zbatuar ndonjë iniciativë të re për të përmirësuar menaxhimin e mbeturinave dhe mirëmbajtjen e ambientit?

Vitin e kaluar 84% e kompanive deklaroi se ishin të hapura për të marrë më shumë informacion ose për të marrë pjesë në diskutime të mëtejshme, këtë vit kjo përqindje bie ndjeshëm në 27.0%.

Në të njëjtën kohë, shumica e kompanive, 73.0%, shprehen se nuk janë të hapura për një angazhim të tillë. Ky ndryshim tregon një rënie të dukshme të interesit dhe angazhimit potencial krahasuar me vitin e kaluar, duke sugjeruar se nevojitet një qasje më e fortë për të motivuar dhe përfshirë kompanitë në diskutime dhe iniciativa që lidhen me praktikën mjedisore.




Figura 109. A do të ishit të hapur për të siguruar informacion shtesë ose për të marrë pjesë në diskutimet e mëtejshme lidhur me menaxhimin e mbeturinave dhe iniciativat e riciklimit në kompaninë tuaj?

Në vitin 2025 vërehet një rënie e ndjeshme në përqindjen e kompanive që deklarojnë se kanë plane për të zbatuar iniciativë të reja për përmirësimin e menaxhimit të mbeturinave dhe mirëmbajtjes së ambientit. Ky ndryshim sugjeron një dobësim të gatishmërisë për angazhim të ri në këtë fushë, që mund të lidhet me kufizime financiare, mungesë të kapaciteteve të brendshme, prioritet më të ulët operacional ose pasiguri mbi mënyrën konkrete të zbatimit të iniciativave mjedisore. Rezultati tregon se, përveç ndërgjegjësimit, kompanitë kanë nevojë për mbështetje më praktike, udhëzim dhe stimuj që planet për menaxhim më të mirë të mbeturinave të kthehen në veprime konkrete.




Figura 110. A do të ishit të hapur për të siguruar informacion shtesë ose për të marrë pjesë në diskutimet e mëtejshme lidhur me menaxhimin e mbeturinave dhe iniciativat e riciklimit në kompaninë tuaj? Krahاسimi 2024—2025

Krahasuar me vitin e kaluar, vihet re një rënie në pjesëmarrjen e kompanive në panairë të tekstilit dhe teknologjisë për tekstil. Pjesëmarrja herë pas here ka rënë nga 45% në 28.0%, ndërsa pjesëmarrja e rregullt mbetet pothuajse në të njëjtat nivele (nga 11% në 10.0%). Në të njëjtën kohë, është rritur dukshëm përqindja e kompanive që nuk marrin pjesë fare, nga 44% në 62.0%. Kjo prirje tregon një zvogëlim të përfshirjes së kompanive në këto aktivitete, duke sugjeruar një distancim nga platformat që ofrojnë mundësi për informim, rrjetëzim dhe ndjekje të zhvillimeve në industri.




Figura 111. A merr pjesë kompania juaj në panairë të tekstilit dhe teknologjisë për tekstil?

Krahasuar me vitin 2024, pjesëmarrja e kompanive në panairë të tekstilit dhe teknologjisë për tekstil ka rënë në vitin 2025. Pjesëmarrja e rregullt mbetet pothuajse e pandryshuar, nga 11.0% në 10.0%, por pjesëmarrja herë pas here ka rënë ndjeshëm nga 45.0% në 28.0%. Ky ndryshim sugjeron një ulje të përfshirjes së kompanive në platforma që mundësojnë informim, rrjetëzim dhe ndjekje të zhvillimeve teknologjike në sektor. Rritja e mospjesëmarrjes mund të lidhet me koston e

pjesëmarrjes, mungesën e kohës ose kapaciteteve, interesin më të ulët për aktivitete të tilla, ose perceptimin se panairët dhe ngjarjet e ngjashme nuk sjellin përfitime të drejtpërdrejta për biznesin.




Figura 112. A merr pjesë kompania juaj në panairë të tekstit dhe teknologjisë për tekstil?

Krahasuar me gjetjet e mëparshme, vihet re një rënie e dukshme e interesit për të marrë informacione mbi panairë dhe konferenca. Ndërsa më parë 90.0% e kompanive shprehnin interes, në matjen aktuale ky nivel ka rënë në 56.0%, duke reflektuar një ulje të konsiderueshme të gatishmërisë për t'u angazhuar me këto aktivitete. Njëkohësisht, pjesa e kompanive që nuk janë të interesuara është rritur në 44.0% nga 10.0% vitin e kaluar, çka sugjeron një qëndrim më të rezervuar ndaj ndjekjes së zhvillimeve në sektor përmes këtyre formateve. Kjo ndryshim mund të tregojë se, ndonëse ekziston ende një bazë e rëndësishme interesi, entuziazmi për informim dhe përfshirje në panairë dhe konferenca është zbehur, duke nënvizuar nevojën për qasje më të targetuara dhe relevante për të riaktivizuar angazhimin e kompanive.




Figura 113. A do të ishit të interesuar të merrnit informacione për panaire dhe konferenca që lidhen me veprimtarinë tuaj?

Në vitin 2025 vërehet një rënie e konsiderueshme e përgjigjeve pozitive krahasuar me vitin 2024. Ky ndryshim sugjeron një nivel më të ulët të gatishmërisë ose interesimit për këtë çështje në vitin 2025, që mund të lidhet me kosto, mungesë kapacitetesh, prioritete të tjera operative ose perceptimin se përfitimet nuk janë të menjëhershme për biznesin.




Figura 114. A do të ishit të interesuar të merrnit informacione për panaire dhe konferenca që lidhen me veprimtarinë tuaj? Krahasimi 2024—2025

Krahasuar me vitin e kaluar, vihet re një rënie e ndjeshme e interesit për angazhimin e stafit në trajnime për riciklim të tekstilit. Ndërsa më parë 62.0% e kompanive shprehnin interes, në matjen aktuale vetëm 30.0% deklarojnë gatishmëri për të investuar në trajnime, duke reflektuar një përgjysmim të interesit. Në të njëjtën kohë, përqindja e kompanive që nuk janë të interesuara

është rritur ndjeshëm nga 14.0% në 61.0%, çka tregon një qëndrim dukshëm më negativ ndaj këtij lloji angazhimi. Ndërkohë, pjesa e atyre që janë të pavendosur ka rënë nga 24.0% në 9.0%, duke sugjeruar se shumë kompani kanë kaluar nga pasiguria në një qëndrim më të qartë refuzues.




Figura 115. A do të ishit të interesuar që të angazhoni stafin tuaj në trajnime për riciklim të tekstit?

Në vitin 2025, interesi për trajnime mbi riciklimin e tekstit duket të jetë dobësuar ndjeshëm, jo vetëm si nivel gatishmërie, por edhe si prioritet për kompanitë. Rënia e përgjigjeve pozitive nga 62.0% në 30.0%, së bashku me rritjen e përgjigjeve negative nga 14.0% në 61.0%, tregon se shumë kompani kanë kaluar nga një qëndrim i hapur ose i pasigurt drejt një refuzimi më të qartë. Kjo mund të lidhet me faktin se riciklimi ende nuk shihet si pjesë e nevojshme e operimit të përditshëm, sidomos në mungesë të kërkesave rregullative, stimujve financiarë ose lidhjeve funksionale me kompani riciklimi. Po ashtu, duke qenë se shumë biznese janë të vogla dhe me kapacitete të

kufizuara, trajnimet mund të perceptohen si angazhim shtesë në kohë dhe burime, pa përfitim të menjëhershëm për biznesin.




Figura 116. A do të ishit të interesuar që të angazhoni stafin tuaj në trajnime për riciklim të tekstilit?
Krahasimi 2024—2025

9. REZULTATET NGA INTERVISTAT ME POLITIKBËRËS

Për të kuptuar dinamikat në zhvillim, sfidat e vazhdueshme dhe mundësitë e reja në menaxhimin e mbeturinave të tekstilit dhe zbatimin e ekonomisë qarkore në Kosovë, janë realizuar intervista me përfaqësues nga institucione shtetërore kyçe në dy valë: intervista të vitit 2025 dhe intervista të vitit 2026. Intervistimi i vitit 2026 ka përfshirë Ministrinë e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës, Agjencinë për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës, Kompaninë për Menaxhimin e Deponive të Kosovës dhe udhëheqësen e Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Gjakovës. Gjetjet nga të dy valët prezantohen në mënyrë të integruar, duke nxjerrë në pah si vazhdimësinë e problemeve, ashtu edhe zhvillimet që kanë ndodhur ndërmjet dy periudhave.

9.1 MINISTRIA E MJEDISIT – DEPARTAMENTI PËR MENAXHIM TË MBETURINAVE

Intervista me përfaqësuesin e Departamentit për Menaxhim të Mbeturinave në kuadër të Intervista e vitit 2025 me përfaqësuesin e Departamentit për Menaxhim të Mbeturinave kishte nxjerrë në pah mungesën e një ligji specifik për mbeturinat e tekstilit dhe kufizimet e konsiderueshme institucionale. Në vitin 2026, gjetjet kryesore konfirmojnë se situata është ende në tranzicion, por me disa zhvillime konkrete që meritojnë vëmendje.

Edhe gjatë vitit 2026, nuk ekziston ende ndonjë rregullore e veçantë e Bashkimit Evropian e integruar plotësisht në legjislacionin e Kosovës për mbeturinat e tekstilit. Megjithatë, është bërë progres i dukshëm: në Ligjin e ri për Mbeturinat, i cili është ende në proces hartimi, është parashikuar përfshirja eksplicite e tekstilit si kategori specifike. Përfaqësuesi i Ministrisë theksoi se ky është prioriteti kryesor institucional për periudhën 2026–2027.

Koordinimi ndërinstitutional mbetet i papërcaktuar plotësisht, por ekziston një grup punues aktiv për hartimin e ligjit, i cili përfshin përfaqësues nga ministritë e tjera, komunat dhe institucionet e tjera relevante. Roli kryesor mbetet i MMPH-së si bartëse e procesit të hartimit.

Sfidat e identifikuar në intervistën e vitit 2025 mbeten kryesisht të njëjta edhe në vitin 2026:

- Mungesa e ndarjes së mbeturinave në burim – mbeturinat tekstile mbërrijnë të përziepa si pjesë e mbeturinave komunale të papërzgjedhura.
- Mungesa e impianteve të trajtimit – trajtimi i veçantë i tekstilit rezulton me kosto shumë të larta pa infrastrukturën e duhur.
- Kapacitetet e kufizuara njerëzore – divizioni përkatës ka vetëm gjashtë punonjës, çka e vështirëson monitorimin dhe zbatimin.
- Mungesa e financimit të dedikuar – nuk ka burim të qëndrueshëm financimi për menaxhimin specifik të mbeturinave tekstile.

Megjithatë, disa aspekte kanë pësuar ndryshime pozitive krahasuar me vitin e kaluar. Udhëzimi Administrativ i vitit 2023 për paketimet dhe mbeturinat e paketimit ka arritur të implementojë pjesërisht sistemin e qeseve plastike: qeset prej 0.25 deri në 0.50 mikrone tani shiten me 0.05 cent, duke krijuar kështu një precedent të rëndësishëm për instrumente ekonomike mjedisore. Sa i përket sistemit të kthimit të depozitave për shishe, kanaqe dhe

qelq – iniciativë e parashikuar që nga viti 2023 – ky process është ende i bllokuar: konsorciumet aplikuese nuk kanë arritur të plotësojnë dokumentacionin e nevojshëm ligjor dhe Udhëzimi Administrativ është ndryshuar në prill 2025, por zgjidhja nuk është gjetur ende.

Ndërgjegjësimi i qytetarëve vazhdon të identifikohet si çështje e hapur. Sipas të dhënave, shumë qytetarë donojnë rrobat e vjetra te Kryqi i Kuq, shtëpitë e pleqve apo familjarëve, por kur nuk gjejnë destinacion adekuat, tekstili përfundon si mbeturinë komunale. Nuk janë zhvilluar ende fushata edukative specifike, edhe pse kjo është parashikuar si aktivitet i ardhshëm.

9.2 AGJENCIA PËR MBROJTJEN E MJEDISIT TË KOSOVËS (AMMK)

Intervista e vitit 2025 me AMMK kishte nxjerrë në pah zhvillimet institucionale të rëndësishme të periudhës 2021–2024, duke përfshirë miratimin e Strategjisë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2024–2035 dhe "Udhërrëfyesit për Ekonominë Qarkore". Intervista e vitit 2026 ofron një vlerësim kritik të progresit dhe sfidave të vërejtura gjatë dy viteve të fundit.

Sipas vlerësimit të AMMK-së, ekonomia qarkore mbetet e lidhur ngushtë me dy dokumente orientuese të publikuara: Udhërrëfyesin e Ekonomisë Qarkore dhe atë për bizneset, si dhe me Strategjinë e Integruar 2024–2035 (Objektivi 4). Megjithatë, vlerësimi i brendshëm i planit të veprimit 2024–2025 ka zbuluar ngecje të konsiderueshme në implementim. Dy vjet me ngërç politik kanë interferuar drejtpërdrejt në buxhetin e Kosovës dhe, në kuadër të kësaj, projektet e ndërlidhura me strategjinë kanë qenë shumë minimale, sipas përfaqësueses: "Prej vitit 2025, në aspektin e implementimit të projekteve nuk kemi ndonjë zhvillim që vlen të përmendet."

Buxheti i vitit 2026 paraqet sërish diskrepancë të qartë mes nevojave të sektorit të mjedisit dhe ekonomisë qarkore dhe alokimeve faktike. Kjo ngre shqetësim serioz për realizueshmërinë e objektivave ambiciozë të Strategjisë 2024–2035, dhe sipas AMMK-së, rishikimi i strategjisë mund të jetë i nevojshëm para afatit të planifikuar 5-vjeçar.

Krahasuar me intervistën e vitit 2025 – ku u paraqitën me optimizëm projekte si "Serec" dhe sistemi i makinave të riciklimit – tabloja e vitit 2026 është më e kujdesshme:

- Nuk ka progres konkret në mbeturinat e tekstilit: mungon ndarja në burim, mungon infrastruktura e trajtimit dhe mungon integrimi i tekstilit si fraksion i veçantë në sistemin e grumbullimit.
- Menaxhimi i mbeturinave mbetet linear: grumbullim – transport – deponim. Ky model dominant nuk ka ndryshuar.
- Deponite ilegale paraqesin gjendje alarmante: nga 2,500 në vitet e kaluara dhe mbi 7,000 siç ishte raportuar, në vitin 2024 komunat kanë raportuar 457 deponi ilegale, por sipas AMMK numri real vlerësohet të jetë shumë më i lartë. Këto deponi përmbajnë sasi të konsiderueshme tekstili.
- Situata e deponive të menaxhuara nga KMDK është gjithashtu shqetësuese: deponia e Pejës ka arritur lartësi prej 15–20 metrash dhe asnjë prej deponive kryesore nuk zotëron leje të integruar mjedisore.

- Djegia masive e mbeturinave në fund të vitit 2025 ka ekspozuar kufizimet e rënda të masave për parandalimin e zjarrit dhe menaxhimit të situatave emergjente.

Ndër arritjet pozitive, sistemi i çmimit të qeseve plastike konsiderohet si një hap konkret drejt instrumenteve ekonomike mjedisore. Kompostuesit e donuar (21–24 njësi) dhe grantet performuese për komunat shihen si mekanizma me potencial të demonstruar. AMMK theksoi se grantet performuese kanë krijuar garë pozitive mes komunave dhe rekomandohet rikthimi i tyre.

Masat konkrete të rekomanduara nga AMMK për periudhën e ardhshme janë:

- Rishikimi i Strategjisë Kombëtare 2024–2035 për të reflektuar realitetin e ngecjeve 2024–2026.
- Rritja e mbulueshmërisë territoriale me shërbime mbeturinash – ende jo totale.
- Rivendosja dhe zgjerimi i granteve performuese për komunat, me matje reale të rezultateve.
- Zgjidhja e problemit të deponive ilegale si prioritet urgjent.
- Rritja e ndjeshme e buxhetit për ekonominë qarkore dhe edukimit të bizneseve, popullatës dhe komunave.

9.3 KOMPANIA PËR MENAXHIMIN E DEPONIVE NË KOSOVË (KMDK)

Intervista e vitit 2025 kishte nxjerrë në pah boshllëqet strukturore në menaxhimin e mbeturinave tekstile nga KMDK: mungesë ndajeje në burim, mungesë bashkëpunimesh me ricikluesit dhe mungesë statistikash. Intervista e vitit 2026 konfirmon vazhdimësinë e këtyre boshllëqeve, por me kontekst shtesë të rëndësishëm.

Mbeturinat tekstile vazhdojnë të mbërrijnë në deponi si sasi e përzier me mbeturinat e tjera – nuk bëhet asnjë ndarje. Nuk ka statistika të dedikuara për fraksionin tekstil, e gjithë mbeturina trajtohet njësoj: shtypet me makineritë e rënda, kompaktohet dhe mbulohet me dhé. Përfaqësuesit konfirmuan se nuk ka pasur asnjë kërkesë apo bashkëpunim me organizata ose kompani riciklimi tekstili.

Sfida kryesore e identifikuar rishtazi në vitin 2026 është mbipopullimi i kapaciteteve – deponitë janë tejkaluar, duke krijuar kushte operacionale alarmante. Kjo situatë, e konfirmuar edhe nga AMMK, tregon se problemi nuk është vetëm i menaxhimit të fraksioneve specifike si tekstili, por i gjithë sistemit.

Aspektet që mbeten të paprekura krahasuar me vitin 2025 janë:

- Mungesa e metodave specifike të ndarjes ose përpunimit të tekstilit.
- Moszbatimi i ndalimit ligjor për deponim të tekstilit si fraksion i përzier – kjo situatë vazhdon për shkak të mungesës së infrastrukturës alternative.
- Mungesa e stimuljeve qeveritarë drejtuar KMDK-së për të përmirësuar praktikën e menaxhimit të tekstilit.
- Mungesa e ndonjë strategjie ose plani të ardhshëm të dedikuar për këtë fraksion – po ndërtohen deponi të reja që do të funksionojnë me të njëjtin model.

Edhe pse KMDK menaxhon deponitë kryesore, tre prej tyre mbeten jashtë domenin të saj. Krahasimi me komunat tregon se menaxhimi nga KMDK është relativisht më i mirë – sidomos për shkak të sistemit të taksimit të bizneseve sipas tonit – por kjo nuk mjafton për të adresuar sfidat strukturore.

Për të ardhmen, përfaqësuesit e KMDK shprehën hapësinë për të shqyrtuar mekanizmin e pagesave të posaçme ndaj prodhuesve/importuesve bazuar në parimin e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit (PZP), i cili do të mund të mbulonte edhe fraksionin tekstil. Ky mekanizëm, i diskutuar edhe në kontekst të GLZ-it gjatë vitit 2025, mbetet i pavënë në praktikë.

9.4 KOMUNA E GJAKOVËS – SEKTORI PËR MENAXHIMIN E MBETURINAVE

Për të plotësuar perspektivën institucionale qendrore me një vështrim nga niveli lokal, është realizuar një intervistë shtesë në maj të vitit 2026 me udhëheqësen e Sektorit për Menaxhimin e Mbeturinave në Komunën e Gjakovës. Kjo intervistë ofron një rast studimor të veçantë, sepse Komuna e Gjakovës është një nga komunat me ndërhyrjet më të hershme dhe më të strukturuar në fushën e menaxhimit të mbeturinave dhe ekonomisë qarkore në nivel lokal, duke ofruar mundësinë për një verifikim "nga poshtë-lart" të konstatimeve institucionale të nivelit qendror.

Sektori për Menaxhim të Mbeturinave në Komunën e Gjakovës është themeluar në janar të vitit 2019, pas marrjes në punë në vitin 2018 të dy zyrtarëve sipas Ligjit për Menaxhimin e Mbeturinave. Sektori funksionon si njësi e nivelit teknik (jo politikëbërës) dhe përbëhet nga udhëheqësja dhe dy zyrtarë.

INICIATIVAT DHE ARRITJET 2019–2024

Gjatë periudhës 2019–2024, sektori ka realizuar për çdo vit konkursin "Gjakovë e Pastër", i njohur edhe si "Eko Gjakova", në të cilin përfshiheshin të gjitha shkollat dhe lagjet e komunës. Konkursi nxiste mbledhjen dhe ndarjen e mbeturinave – tekstilit, kartonit dhe qelqit – si dhe kthimin e tyre në art, duke shpërblyer shkollat dhe lagjet më të pastra me pemë, ulëse, shporta dhe pajisje tjera. Në vitin 2024, konkursi u përqendrua specifikisht në mbledhjen e tekstilit nga shkollat, si përgjigje ndaj praktikës së hudhjes sezonale të rrobave të paperdorura. Megjithatë, sasitë e mbledhura nuk u tërhoqën në kohë nga organizata partnere "Rilindja e Gjelbërt" dhe mbetën të depozituara në oborrin reciklues, duke nxjerrë në pah brishtësinë e zinxhirit operacional kur mungojnë partnerët e qëndrueshëm të tërheqjes dhe trajtimit.

Një zhvillim i rëndësishëm strukturor është funksionimi i oborrit reciklues të menaxhuar nga KRM Çabrat – kompani aksionare 100% në pronësi të komunës – ku më shumë se 150 biznese mbledhin, presojnë dhe shesin kartonin dhe letrën. Ky model paraqet një rast konkret të ekonomisë qarkore të aplikuar në nivel lokal me përfshirje aktive të sektorit privat.

Komuna ka qenë gjithashtu përfituese e granteve performuese të bashkëfinancuara nga Ministria e Mjedisit dhe GLZ-i, përmes të cilave ka siguruar dy kamionë për mbledhjen e mbeturinave dhe

ka shpërndarë diku mes 2.000 dhe 3.000 kompostuesish të qytetarët me oborre dhe kopshte. Si rezultat i këtyre investimeve të kombinuara dhe i bashkëpunimit të vazhdueshëm me KRM Çabratin, mbulueshmëria territoriale e shërbimit të mbledhjes së mbeturinave është rritur nga rreth 60% në vitin 2019 në 100% të territorit komunal sot.

NGECJA E PERIUDHËS 2025–2026

Krahasuar me intensitetin e periudhës paraprake, viti 2025 paraqet një ndalim të theksuar të aktiviteteve. Përfaqësuesja e formuloi këtë në mënyrë të prerë: "Në 2025 nuk kemi bo diçka konkret." Aktiviteti është reduktuar në rutinën e tërheqjes së deponive ilegale dhe ndërhyrje në dëgjie të mbeturinave, ndërsa projektet inovative apo pilot janë pezulluar për mungesë buxheti dhe vullneti politik. Kjo gjendje është në linjë të plotë me konstatimet e AMMK-së dhe MMPH-së për ngecjen e përgjithshme institucionale të dy viteve të fundit dhe ndikimin e ngërçit politik mbi planet sektoriale, duke konfirmuar se efektet e këtij ngërçi nuk kanë qenë vetëm në nivelin qendror, por janë reflektuar drejtpërdrejt edhe në kapacitetin operativ të komunave më aktive.

BASHKËPUNIMI ME SEKTORIN PRIVAT DHE ORGANIZATAT LOKALE

Përkundër mungesës së kornizës strukturore kombëtare, dy aktorë privatë/organizativë janë identifikuar nga përfaqësuesja si bashkëpunëtorë aktivë në Komunën e Gjakovës:

- **Kosova Green Plus** (Dukagjin Berisha) – biznes i specializuar në grumbullimin dhe riciklimin e qelqit. Komuna i ka vënë në dispozicion mbi 100 kontejnerë për shpërndarje në restorante dhe lokale, ndërsa biznesi prodhon ulëse, banaqe dhe tavolina nga qelqi i grimcuar. Leja mjedisore për këtë biznes është lëshuar vetëm gjatë javës së intervistës (maj 2026), duke shënuar një zhvillim të vonuar por të rëndësishëm rregullator, që hap mundësinë e zgjerimit të aktivitetit edhe jashtë komunës.
- **Organizata IMCA** (Dorina Lluka) – organizatë lokale me dy kontejnerë të dedikuar për grumbullimin e tekstit. E mbledhura përfundon në dyqanin e organizatës, ku artikujt rishiten – një model i thjeshtë i ripërdorimit (reuse) që në nivel kombëtar mbetet i pareplikuar.

Përveç këtyre dy iniciativave, përfaqësuesja konfirmoi se asnjë biznes tjetër nuk i është drejtuar sektorit me kërkesë për bashkëpunim në fushën e riciklimit ose ekonomisë qarkore. Kjo tregon se ekosistemi privat i riciklimit në nivel lokal mbetet jashtëzakonisht i kufizuar dhe i fragmentuar, duke konfirmuar gjetjen e KMDK-së për mungesën e kërkesave nga organizata ose kompani të riciklimit tekstil.

SFIDAT STRUKTURE TË IDENTIFIKUARA

Sfidat e ngritura nga përfaqësuesja e Komunës së Gjakovës konfirmojnë dhe plotësojnë gjetjet e institucioneve qendrore, duke shtuar dimensione operationale konkrete:

- **Mungesa e deponive inerte** – komuna nuk disponon pronë publike adekuate. Kushtet ligjore (rrugë e shtruar deri në vendin e caktuar, jashtë zonave të banuara, larg rrjedhave

të lumenjve) janë të vështira të plotësohen për shkak të gjeografisë specifike të Gjakovës (lumenj të shumtë, Liqeni i Radoniqit).

- **Bllokimi i planeve ndërkomunale** – plani ndërkomunal me Komunën e Prizrenit, i mbështetur nga GIZ-i, është pezulluar për shkak të sanksioneve të Bashkimit Evropian. Kjo ka prerë një linjë të rëndësishme strategjike për zgjidhjen e problemit të deponive inerte në nivel rajonal.
- **Mungesa e zinxhirit të integruar** – sipas vlerësimit të përfaqësueses, problemi qendror operacional është që ndërhyrjet bëhen të copëzuara: aplikohen kontejnerë pa kamionë për bartjen e tyre, mbahen ligjërata pa infrastrukturë në vendet ku zhvillohen, ose nisen projekte pilot pa vazhdimësi buxhetore. Përmenden raste konkrete: kontejnerët nëntokësorë në Prishtinë pa kamionë specifikë për t'i zbrazur; ligjëratat në shkolla pa kontejnerët e ndarjes në po atë vend. Mesazhi kryesor është: "është cikël, është zinxhir – nuk mundesh veç me mbajtje ligjërata".
- **Mungesa e vullnetit politik** – si në nivel lokal ashtu edhe qendror, vullneti politik për investime afatgjata në ekonominë qarkore vlerësohet i pamjaftueshëm. Përfaqësuesja theksoi se cikli i shpeshtë zgjedhor (përfshirë zgjedhjet e parashikuara në qershor 2026) lë në pezull vendimet strategjike sektoriale.
- **Mungesa e qasjes afatgjatë** – modelet evropiane referencë të përmendura (Sllovenia, Gjermania) kanë kërkuar 30 vjet punë të vazhdueshme për të arritur nivelin aktual të ekonomisë qarkore. Pritshmëria realiste për Kosovën duhet të jetë një horizont kohor 20–30 vjeçar me ndërhyrje graduale dhe të strukturuar, jo pritshmëri rezultatesh të menjëhershme.

REKOMANDIMET KRYESORE

Përfaqësuesja e Komunës së Gjakovës rekomandon një qasje të integruar afatgjatë që përfshin:

- Integrimin e edukimit për ekonominë qarkore dhe ndarjen në burim në kurrikulën e edukatës qytetare në shkolla – si parakusht për ndryshim kulturor afatgjatë.
- Investime në zinxhirin e plotë operacional: kontejnerë, kamionë, punëtorë, impiante trajtimi dhe tregje për materialet e ricikluara – si një sistem i integruar, jo ndërhyrje të copëzuara.
- Rivendosjen e granteve performuese mes Ministrisë së Mjedisit dhe komunave, që historikisht kanë gjeneruar rezultate konkrete – një rekomandim i përbashkët edhe me AMMK-në.
- Përfundimin e shpejtë të planeve ndërkomunale për menaxhimin e deponive inerte.
- Forcimin e bazës ligjore përmes miratimit të Ligjit të ri për Mbeturinat dhe zbatimit konsistent të Strategjisë 2024–2035, duke pranuar se afati i miratimit të ligjit (fundi i vitit 2026) është realist nga këndvështrimi i informacioneve të Asociacionit të Komunave.

VLERA E RASTIT STUDIMOR

Intervista me Komunën e Gjakovës është veçanërisht me vlerë sepse ofron një verifikim empirik të konstatimeve të nivelit qendror nga këndvështrimi operacional. Të tre institucionet qendrore (MMPH, AMMK, KMDK) raportojnë ngecje, kufizime buxhetore dhe sfida strukturore – dhe niveli lokal, përmes rastit të Gjakovës si një nga komunat më aktive në këtë fushë, konfirmon këto trende dhe shton dimensione operationale konkrete: çfarë funksionon (gara konkurruese shkollore, kompostuesit e shpërndarë, partneritetet me biznese të vogla si Kosova Green Plus dhe IMCA, granti performues MMPH-GIZ), çfarë nuk funksionon (mbledhje pa zinxhir të mbyllur, ligjërata pa infrastrukturë, projekte pilot pa vazhdimësi), dhe çfarë mungon domosdoshmërisht (vullneti politik afatgjatë, investim i integruar i zinxhirit, edukim sistemik nga niveli shkollor).

9.4 PËRMBLEDHJE E INTERVISTAVE

Krahasimi mes intervistave të vitit 2025 dhe atyre të vitit 2026 nxjerr në pah disa prirje të qëndrueshme dhe disa zhvillime të reja. Në përgjithësi, progresi duket më i pranishëm në nivel të planifikimit ligjor dhe strategjik, ndërsa zbatimi praktik në terren mbetet ende i kufizuar. Intervista me Komunën e Gjakovës e forcon këtë vlerësim, pasi tregon se edhe në një komunë relativisht aktive në menaxhimin e mbeturinave, rezultatet varen shumë nga buxheti, vullneti politik, partnerët operacionalë dhe funksionimi i të gjithë zinxhirit të menaxhimit.

Elementet që kanë mbetur të pandryshuara:

- Mungesa e një kornize ligjore specifike për mbeturinat e tekstilit mbetet ende sfidë, edhe pse Ligji i ri për Mbeturinat parashikon përfshirjen e tekstilit si kategori specifike. Deri në miratimin dhe zbatimin e tij, tekstili vazhdon të mos trajtohet si fraksion i veçantë në praktikë.
- Mbeturinat tekstile nuk ndahen në burim dhe vazhdojnë të trajtohen njëjloj si mbeturinat e tjera komunale. Kjo u confirmua si nga institucionet qendrore, ashtu edhe nga KMDK, ku tekstili përfundon në deponi si pjesë e mbeturinave të përziera.
- Nuk ekziston ende një sistem funksional i riciklimit të tekstilit në nivel kombëtar. Përkundër disa iniciativave të veçanta lokale ose organizative, mungon një mekanizëm i qëndrueshëm për grumbullim, selektim, trajtim dhe riciklim të tekstilit.
- Kapacitetet institucionale mbeten të kufizuara në të gjitha nivelet. Në nivel qendror sfidë mbetet numri i kufizuar i stafit dhe burimeve, ndërsa në nivel lokal komunat përballen me mungesë buxheti, kapacitete teknike dhe vazhdimësi të projekteve.
- Bashkëpunimi strukturor me sektorin privat të riciklimit tekstil mungon. Edhe pse në disa komuna ekzistojnë iniciativa të kufizuara, si rasti i IMCA-s në Gjakovë për grumbullimin e tekstilit, këto mbeten të izoluara dhe jo pjesë e një sistemi të gjerë kombëtar.

Zhvillimet pozitive të periudhës 2025–2026:

- Ligji i ri për Mbeturinat është në fazë hartimi dhe parashikon tekstilin si kategori specifike, që përbën një hap të rëndësishëm nga perspektiva ligjore. Kjo tregon se tekstili po fillon të njihet si fraksion që kërkon trajtim më të veçantë, edhe pse zbatimi ende nuk ka filluar.

- Udhëzimi Administrativ për paketimet ka arritur të implementojë sistemin e çmimit për qeset plastike, duke krijuar precedent për instrumente ekonomike mjedisore. Ky zhvillim mund të shërbejë si model për mekanizma të ardhshëm financiarë, përfshirë edhe skema të mundshme për tekstilin.
- Strategjia e Integruar 2024–2035 dhe Udhërrëfytyrja për Ekonominë Qarkore ofrojnë kuadrin e nevojshëm dokumental për zhvillimin e politikave të ardhshme. Megjithatë, intervistat tregojnë se këto dokumente kërkojnë zbatim më të fortë dhe financim më të qëndrueshëm.
- Në nivel lokal, Komuna e Gjakovës ofron disa shembuj pozitivë të ndërhyrjeve praktike. Konkursi “Gjakovë e Pastër/Eko Gjakova”, aktivitetet me shkolla dhe lagje, oborri riciklues i KRM Çabratit, shpërndarja e kompostuesve dhe rritja e mbulueshmërisë territoriale të shërbimit të mbeturinave nga rreth 60% në vitin 2019 në 100% sot tregojnë se ndërhyrjet lokale mund të japin rezultate konkrete kur kombinohen kapacitetet komunale, mbështetja financiare dhe partneritetet operative.
- Grantet performuese për komunitat janë identifikuar si mekanizëm pozitiv nga më shumë se një akter. Përvoja e Gjakovës dhe vlerësimi i AMMK-së tregojnë se këto grante kanë ndihmuar komunitat të përmirësojnë shërbimet, të risin mbulueshmërinë dhe të nxisin konkurrencë pozitive në nivel lokal.

Zhvillimet negative ose shqetësimet e reja të identifikuar në vitin 2025–2026:

- Ngecja politike e dy viteve të fundit ka pasur ndikim të drejtpërdrejtë në zbatimin e strategjive mjedisore dhe të ekonomisë qarkore. Sipas intervistave, mungesa e stabilitetit politik dhe kufizimet buxhetore kanë ngadalësuar projektet dhe kanë kufizuar zbatimin e masave të planifikuara.
- Gjendja e deponive është alarmante, me mbipopullim kapacitetesh, mungesë të lejeve të integruara mjedisore dhe raste të djegies masive të mbeturinave. Kjo tregon se problemi i tekstilit nuk mund të shihet i shkëputur nga dobësitë më të gjera të sistemit të menaxhimit të mbeturinave.
- Sistemi i kthimit të depozitave, i planifikuar që nga viti 2023, mbetet i pazbatuar, duke treguar vështirësi të thella administrative dhe ligjore. Kjo tregon se edhe kur instrumentet e reja janë të parashikuara, operacionalizimi i tyre mbetet sfidë.
- Buxheti i vitit 2026 nuk parashikon mjaftueshëm fonde për ekonominë qarkore, duke vënë në pikëpyetje realizueshmërinë e objektivave të Strategjisë 2024–2035. Kjo është veçanërisht shqetësuese duke pasur parasysh se zbatimi i ekonomisë qarkore kërkon investime në infrastrukturë, kapacitete njerëzore dhe mekanizma monitorimi.
- Në nivel lokal, rasti i Gjakovës tregon se viti 2025 ka shënuar një ndërprerje të aktiviteteve më inovative për shkak të mungesës së buxhetit dhe vullnetit politik. Aktivitetet janë reduktuar kryesisht në ndërhyrje rutinore, si largimi i deponive ilegale dhe reagimi ndaj rasteve të djegies së mbeturinave.
- Një shqetësim shtesë është brishtësia e zinxhirit operacional. Në rastin e Gjakovës, mbledhja e tekstilit në shkolla gjatë vitit 2024 nuk u pasua me tërheqje dhe trajtim të qëndrueshëm nga partnerët, duke treguar se iniciativat pilot nuk janë të mjaftueshme pa mekanizma të qartë për grumbullim, transport, trajtim dhe destinacion final.

Sfidat kryesore strukturore të identifikuar në të dyja periudhat mbeten:

- Mungesa e bazës ligjore të konsoliduar për tekstin si fraksion specifik. Edhe pse ka zhvillime në hartimin e Ligjit të ri për Mbeturinat, mungon ende një kornizë funksionale që përcakton detyrime, përgjegjësi dhe mekanizma zbatimi për tekstin.
- Kapacitetet e kufizuara institucionale dhe njerëzore, si në nivel qendror ashtu edhe në nivel lokal. Institucionet përgjegjëse kanë staf dhe burime të kufizuara për monitorim, zbatim dhe koordinim.
- Mungesa e ndarjes në burim dhe ndërgjegjësimi të qytetarëve. Tekstili vazhdon të hyjë në sistemin komunal si mbeturinë e përzier, ndërsa qytetarët shpesh nuk kanë alternativa të qarta për dhurim, grumbullim ose riciklim.
- Mungesa e bashkëpunimeve strukturore me sektorin privat dhe organizatat e riciklimit. Iniciativat ekzistuese janë të kufizuara, lokale dhe të fragmentuara, pa një mekanizëm kombëtar që i lidh komunat, bizneset, organizatat dhe operatorët e riciklimit.
- Financimi i pamjaftueshëm dhe i paqëndrueshëm mbetet një nga pengesat kryesore. Si institucionet qendrore, ashtu edhe komunat theksojnë se mungesa e buxhetit pengon zhvillimin e projekteve afatgjata dhe të integruara.
- Mungesa e një zinxhiri të plotë operacional mbetet sfidë thelbësore. Siç tregon rasti i Gjakovës, ndërhyrjet shpesh bëhen të copëzuara: vendosen kontejnerë pa transport të përshtatshëm, mbahen ligjërata pa infrastrukturë në terren, ose zbatohen projekte pilot pa vazhdimësi buxhetore. Kjo e bën të vështirë kalimin nga iniciativa të veçuara drejt një sistemi funksional të ekonomisë qarkore.

Mundësitë për përmirësim të identifikuar nga të gjithë aktorët përfshijnë: miratimin dhe zbatimin e Ligjit të ri për Mbeturinat me përfshirjen e tekstit; rishikimin e Strategjisë 2024–2035 për të reflektuar realitetin aktual të ngecjeve në zbatim; rivendosjen dhe zgjerimin e granteve performuese për komunat; zgjerimin e mbulueshmërisë territoriale me shërbime; zgjidhjen urgjente të problemit të deponive ilegale dhe presionit mbi deponitë ekzistuese; si dhe investimin e qëndrueshëm në ndërgjegjësim publik, edukim të bizneseve dhe ndërtim të zinxhirit të plotë operacional për ndarje, grumbullim, transport, trajtim dhe treg të materialeve të ricikluara. Rasti i Gjakovës tregon se këto masa mund të jenë efektive vetëm nëse zbatohen si pjesë e një sistemi të integruar dhe afatgjatë, jo si ndërhyrje të veçuara ose të përkohshme.

10. KONKLUZION

Industria e tekstilit në Kosovë mbetet një sektor me peshë ekonomike dhe potencial të dukshëm për punësim, por struktura e saj vazhdon të jetë e brishtë dhe e pa-orientuar sa duhet drejt një modeli qarkor zhvillimi. Sektori dominohet nga mikro-ndërmarrjet, ndërsa pjesa më e madhe e aktiviteteve ekonomike dhe e punësimit mbetet e përqendruar në tregti, sidomos në tregtinë me pakicë të tekstilit dhe veshjeve. Edhe pse ka rritje të numrit të bizneseve dhe të punëtorëve krahasuar me vitin e kaluar, kjo nuk është shoqëruar me transformim të dukshëm strukturor në madhësinë e bizneseve ose në rritjen e një baze më të fortë prodhuese.

Nga këndvështrimi tregtar, gjetjet e raportit tregojnë qartë se Kosova vazhdon të varet fuqishëm nga importi i tekstilit. Gjatë vitit 2025, importet kanë qenë dukshëm më të larta se eksportet në të gjitha kategoritë kryesore, përfshirë veshmbathjet, aksesoret dhe tekstin shtëpiak, si në vlerë ashtu edhe në sasi. Ky hendek është veçanërisht i thellë te veshmbathjet dhe te veshjet e përdorura, çka tregon se një pjesë shumë e madhe e tekstilit që hyn në tregun vendor përfundimisht duhet të menaxhohet brenda Kosovës në fazën post-konsum. Në këtë kuptim, bilanci negativ tregtar nuk është vetëm çështje ekonomike, por edhe çështje e drejtpërdrejtë e menaxhimit të mbeturinave dhe e presionit mjedisor.

Raporti tregon gjithashtu se Kosova ende nuk ka krijuar kushtet minimale për një menaxhim të specializuar të mbeturinave të tekstilit. Tekstili nuk trajtohet si fraksion i veçantë me sistem të konsoliduar kombëtar, nuk ka ndarje në burim, nuk ka statistika të dedikuara për sasinë që përfundon në deponi dhe nuk ekziston një zinxhir funksional i grumbullimit, përpunimit dhe riciklimit për këtë kategori mbeturinash. Intervistat me institucionet dhe menaxhuesit e deponive e konfirmojnë se mbeturinat e tekstilit vazhdojnë të trajtohen si pjesë e mbeturinave të përziera, ndërsa mbipopullimi i deponive dhe mungesa e infrastrukturës alternative e bëjnë problemin edhe më urgjent.

Nga ana e sektorit privat, gjetjet sugjerojnë se ekziston një nivel i kufizuar i përfshirjes në praktikatat e ekonomisë qarkore. Bizneset kryesisht operojnë brenda logjikës tradicionale lineare, me fokus te furnizimi, shitja dhe menaxhimi minimal i mbeturinave, ndërsa investimet në teknologji për trajtim të mbeturinave, bashkëpunimi me ricikluesit dhe zhvillimi i modeleve të ripërdorimit mbeten të ulëta. Kjo nuk vjen vetëm nga mungesa e vullnetit, por edhe nga mungesa e stimuljeve financiarë, e qartësisë rregullative dhe e infrastrukturës mbështetëse. Në të njëjtën kohë, raporti tregon se baza institucionale për ekonomi qarkore po forcohet gradualisht përmes strategjive të reja, projekteve pilot dhe nismave të mbështetura nga partnerë ndërkombëtarë, por zbatimi praktik mbetet dukshëm prapa dokumenteve strategjike.

Në nivel shoqëror, raporti sugjeron se ekziston hapësirë reale për ndërhyrje në sjelljen konsumatore dhe në rritjen e ndërgjegjësimit për ripërdorim, riciklim dhe konsum më të qëndrueshëm. Megjithatë, pa infrastrukturë konkrete, pa skema funksionale

mbledhjeje dhe pa bashkërendim mes institucioneve, bizneseve dhe qytetarëve, gatishmëria individuale nuk mjafton për të prodhuar ndryshim sistemik. Për këtë arsye, problemi i mbeturinave të tekstit në Kosovë nuk duhet parë thjesht si çështje e sjelljes së konsumatorit ose e praktikave të biznesit, por si sfidë strukturore që kërkon ndërhyrje të koordinuar në politikëbërje, në infrastrukturë, në financim dhe në edukim publik.

11. REKOMANDIME

Në vazhdim janë dhënë rekomandimet për akterët kryesorë të përfshirë në menaxhimin e mbeturinave të tekstit dhe zbatimin e ekonomisë qarkore në sektorin e tekstit, duke përfshirë institucionet publike, komunat, bizneset, organizatat e shoqërisë civile, donatorët dhe sektorin privat.

Për institucionet publike:

- Të zhvillohet një qasje e veçantë dhe e dedikuar për mbeturinat e tekstit brenda kornizës së përgjithshme të menaxhimit të mbeturinave.
- Të njihet formalisht tekstili si fraksion specifik i mbeturinave, me objektiva të qarta për ndarje në burim, grumbullim të veçantë dhe trajtim të specializuar.
- Të integrohet fraksioni i tekstit në planet kombëtare dhe komunale të menaxhimit të mbeturinave, në mënyrë që tekstili të mos mbetet i padukshëm në statistika dhe i patrajtuar në praktikë.
- Të përmirësohen dhe harmonizohen gradualisht politikat për tekstin me direktivat dhe standardet e Bashkimit Evropian, veçanërisht me kërkesat për grumbullim të ndarë të tekstit, Përgjegjësi të Zgjeruar të Prodhuesit dhe trajtim të tekstit si fraksion i veçantë i mbeturinave.
- Të krijohet bazë më e qartë për financimin, organizimin dhe monitorimin e riciklimit të tekstit, në përputhje me kërkesat e tregut evropian dhe tranzicionin drejt ekonomisë qarkore.
- Të forcohet koordinimi institucional ndërmjet ministrive, komunave, agjencive mjedisore, operatorëve të mbeturinave dhe aktorëve të sektorit privat, përmes një mekanizmi të qëndrueshëm që përcakton qartë rolet, përgjegjësitë, burimet dhe afatet për veprim.

Për MMPHI-në, Doganën e Kosovës dhe institucionet tregtare:

- Të shqyrtohen masa më të rrepta për importin e veshmbathjeve të përdorura, duke përfshirë kontroll më të fortë të cilësisë, gjendjes dhe destinimit të tyre.
- Të shqyrtohet kufizimi ose ndalimi i importit të atyre kategorive të veshmbathjeve të përdorura që nuk janë të përshtatshme për ripërdorim real dhe që kanë jetëgjatësi shumë të shkurtër.
- Të parandalohet hyrja e materialeve të tekstit që mund të përfundojnë shpejt si mbetura dhe që risin presionin mbi sistemin vendor të menaxhimit të mbeturinave.

Për komunat, operatorët e mbeturinave dhe ndërmarrjet e riciklimit:

- Të forcohet infrastruktura dhe kapacitetet operative për menaxhimin e mbeturinave të tekstilit.
- Të ngrihen pika të dedikuara për grumbullim të ndarë të tekstilit në nivel komunal dhe lokal.
- Të zhvillohen modele pilot për selektim, grumbullim, ripërdorim dhe riciklim të tekstilit.
- Të krijohen partneritete funksionale ndërmjet komunave, operatorëve të mbeturinave, organizatave komunitare dhe ndërmarrjeve që mund të angazhohen në ripërdorim ose riciklim.
- Të sigurohet që politikat për tekstin të shoqërohen me investime konkrete në infrastrukturë, pasi pa kapacitete operative ato rrezikojnë të mbeten vetëm deklarative.

Për Ministrinë e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë, KIESA-n dhe institucionet që mbështesin sektorin privat:

- Të krijohen stimuj financiarë dhe teknikë për bizneset që adoptojnë praktika të ekonomisë qarkore.
- Të ofrohen grante për pajisje dhe teknologji që reduktojnë mbeturinat në sektorin e tekstilit.
- Të mbështetet ripërdorimi i mbeturinave të brendshme të prodhimit dhe bashkëpunimi me ricikluesit.
- Të krijohen skema të posaçme për ndërmarrjet që kalojnë nga modeli linear në modele qarkore të biznesit.
- Të sigurohet që masat mbështetëse të jenë të arritshme edhe për mikro-ndërmarrjet dhe bizneset e vogla, jo vetëm për operatorët më të mëdhenj.
- Të lidhet mbështetja për sektorin e tekstilit me kriteret e gjelbra dhe performancë mjedisore, duke përfshirë dizajnin qarkor, reduktimin e mbeturinave, zgjatjen e jetës së produktit, përdorimin më efikas të materialeve dhe përputhshmërinë me standardet që po vendosen gradualisht në tregjet evropiane.

Për Agjencinë për Mbrotjtjen e Mjedisit të Kosovës, Doganën e Kosovës, ARBK-në dhe institucionet statistikore:

- Të përmirësohet sistemi i të dhënave dhe statistikave për sektorin e tekstilit dhe mbeturinat tekstile.
- Të zhvillohen mekanizma për mbledhjen e të dhënave të ndara për tekstin, si në import dhe eksport, ashtu edhe në gjenerimin, grumbullimin, trajtimin dhe deponimin e mbeturinave.
- Të krijohen tregues të qartë për matjen e progresit në menaxhimin e mbeturinave të tekstilit dhe zbatimin e praktikave të ekonomisë qarkore.
- Të adresohet mungesa aktuale e statistikave për fraksionin e tekstilit, pasi kjo e vështirëson planifikimin e politikave dhe monitorimin e rezultateve.

Për institucionet edukative, shkollat dhe mediat:

- Të rritet ndërgjegjësimi dhe edukimi publik për konsum më të qëndrueshëm, ripërdorim, ndarje në burim dhe riciklim të tekstilit.
- Të zhvillohen ndërhyrje informuese që synojnë qytetarët, bizneset, komunat dhe institucionet arsimore.
- Të përfshihet ekonomia qarkore në aktivitete edukative, me fokus praktik në mënyrën e furnizimit, përdorimit dhe asgjësimit të produkteve të tekstilit.
- Të promovohet ndryshimi i sjelljes së qytetarëve dhe bizneseve, pasi ekonomia qarkore në tekstil nuk mund të funksionojë vetëm mbi bazën e zgjidhjeve teknike.

Për organizatat e shoqërisë civile dhe joqeveritare:

- Të zhvillohen fushata vetëdijësimi dhe informimi për publikun dhe bizneset mbi ndikimin mjedisor të tekstilit dhe mundësitë për ripërdorim e riciklim.
- Të krijohen dhe mbështeten iniciativa komunitare për grumbullim, dhurim, ripërdorim dhe riciklim të tekstilit.
- Të ndërtohen partneritete me komunat, shkollat, bizneset dhe ndërmarrjet e riciklimit për zbatimin e modeleve pilot.
- Të ndërmerren hulumtime të vazhdueshme dhe të publikohen informata praktike për aplikimin e ekonomisë qarkore në sektorin e tekstilit.

Për donatorët dhe partnerët zhvillimorë:

- Të mbështeten me grante ose kredi me kushte të lehtësuara kompanitë që investojnë në riciklim, upcycling, ripërdorim apo prodhim të qëndrueshëm.
- Të financohen programe për zhvillimin e zinxhirit të riciklimit dhe ndërtimin e infrastrukturës për ndarjen dhe grumbullimin e mbeturinave të tekstilit.
- Të mbështeten komunat dhe organizatat lokale në zhvillimin e modeleve pilot për tekstilin si fraksion i veçantë.
- Të ofrohet mbështetje teknike dhe financiare për ndërtimin e kapaciteteve të institucioneve publike, bizneseve dhe organizatave të shoqërisë civile.

Për investitorët dhe sektorin privat:

- Të investohet në teknologji për riciklim, përpunim dhe ripërdorim të tekstilit, duke adresuar mungesën aktuale të infrastrukturës për këtë fraksion.
- Të mbështetet zhvillimi i ndërmarrjeve të reja që fokusohen në dizajn të qëndrueshëm, riparim, upcycling dhe produkte të ricikluara.
- Të krijohen partneritete me biznese vendore, komuna dhe organizata komunitare për ngritjen e qendrave të dedikuara për ndarje, grumbullim dhe përpunim të tekstilit.
- Të shfrytëzohen skemat ekzistuese të bashkëfinancimit nga BE-ja, donatorët ndërkombëtarë dhe institucionet vendore për të ulur rrezikun financiar dhe për të siguruar mbështetje teknike.
- Të mbështetet certifikimi dhe standardizimi i produkteve të ricikluara, në mënyrë që ato të kenë qasje më të lehtë në tregjet vendore, rajonale dhe ndërkombëtare.

Për sektorin e tekstilit si fushë pilot për ekonominë qarkore:

- Të përdoret sektori i tekstilit si fushë pilot për aplikimin e ekonomisë qarkore në praktikë.
- Të testohen modele të reja të grumbullimit, ripërdorimit, riciklimit, sipërmarrjes sociale dhe bashkëpunimit ndërmjet sektorit publik dhe atij privat.
- Të shfrytëzohet pesha ekonomike e sektorit, varësia e lartë nga importi dhe potenciali për gjenerim të mbeturinave si arsye për ta trajtuar tekstilin si sektor prioritar për ndërhyrje qarkore.
- Të synohet jo vetëm reduktimi i ndikimit mjedisor, por edhe krijimi i vlerës së shtuar ekonomike dhe vendeve të reja të punës në sektorë të gjelbër.

Zbatimi i rekomandimeve nga raporti paraprak

Nëse krahasojmë rekomandimet e raportit paraprak, vërejmë se gjatë periudhës 2024–2025 ka pasur disa zhvillime në nivel strategjik dhe institucional, por zbatimi praktik në sektorin e tekstilit mbetet i kufizuar. Në nivel të politikave publike, është shënuar progres përmes avancimit të kornizës për menaxhimin e integruar të mbeturinave, përfshirë Strategjinë për Menaxhimin e Integruar të Mbeturinave 2024–2035 dhe Planin e Veprimit 2024–2026, si dhe përmes diskutimeve për Ligjin për Mbeturina dhe mekanizmat e Përgjegjësisë së Zgjeruar të Prodhuesit. Megjithatë, deri në periudhën e raportimit, Kosova ende nuk ka një politikë të posaçme për mbeturinat e tekstilit, nuk ka sistem të konsoliduar për grumbullimin e ndarë të tekstilit dhe nuk ka një skemë funksionale PZP për këtë sektor. Prandaj, rekomandimet për harmonizim me direktivat e BE-së, ndarje në burim, raportim të dedikuar dhe trajtim të veçantë të tekstilit janë zbatuar vetëm pjesërisht në nivel orientimi strategjik, por jo ende në nivel operacional.

Në nivel të bizneseve, të dhënat e vitit 2025 tregojnë se rekomandimet e raportit paraprak për matjen e mbeturinave, ripërdorimin e materialeve, ndarjen sipas llojit dhe bashkëpunimin me operatorët e riciklimit nuk janë zbatuar në mënyrë të gjerë. Përkundrazi, kompanitë mbështeten më shumë në deponitë komunale sesa vitin e kaluar, ndërsa përdorimi i materialeve të mbetura, bashkëpunimi me iniciativë për rishfrytëzim dhe riciklimi kanë shënuar rënie. Po ashtu, bashkëpunimi aktiv me kompani riciklimi mbetet shumë i ulët, ndërsa gatishmëria për trajnime dhe investime mjedisore është më e dobët se në vitin paraprak. Kjo tregon se, pavarësisht rekomandimeve të dhëna, sektori privat ende përballet me pengesa praktike, financiare dhe informative për të kaluar drejt modeleve më qarkore. Në aspektin e ndërgjegjësimit dhe edukimit, rezultatet tregojnë se ka ende nevojë për informim më të strukturuar. Njohuria për ekonominë qarkore është përmirësuar lehtë te qytetarët, por mbetet e kufizuar te një pjesë e madhe e respondentëve dhe veçanërisht te bizneset. Kjo tregon se rekomandimet për fushata vetëdijësimi, edukim dhe shpërndarje të informacionit praktik janë ende të pazbatuara në shkallën e nevojshme.

Në përgjithësi, rekomandimet e raportit paraprak mbeten të vlefshme, por progresi gjatë vitit ka qenë më i dukshëm në nivel strategjik sesa në zbatim praktik. Për fazën e ardhshme, nevojitet kalim më i qartë nga dokumentet strategjike drejt masave konkrete, me përgjegjësi të ndara për institucionet publike, komunat, bizneset, organizatat e shoqërisë civile, donatorët dhe investitorët.

REFERENCAT

- Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës. (2023). *Annual report on the state of the environment 2022*.
- Alite, M., Abu-Omar, H., Agurcia, M. T., Jácome, M., Kenney, J., Tapia, A., & Siebel, M. (2023). Construction and demolition waste management in Kosovo: A survey of challenges and opportunities on the road to circular economy. *Journal of Material Cycles and Waste Management*, 25, 1191–1203.
- Bislimi, F., & Dalloshi, P. (2025). Bridging awareness and action: Understanding consumer profile for a circular economy in Kosovo. *International Journal of Sustainable Development and Planning*, 20(2), 565–576.
- Dervisholli, S. (2025, June). Where we stand: Kosovo's Green Agenda Progress Review. Kosovo Green Action.
- Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit. (2024a). *Developing sustainable municipal waste services*.
- Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit. (2024b). *Circular urban development – Kosovo4Green*.
- Deutsche Gesellschaft für Internationale Zusammenarbeit. (2025). Law on Waste and Extended Producer Responsibility (PZP).
- Dogana e Kosovës. (2025). *Bilanci tregtar*.
- Dogana e Kosovës. (2024). Integrated Tariff of Kosovo: Version 01.01.2024. Dogana e Kosovës.
- Ellen MacArthur Foundation. (2013). *Towards the circular economy: Economic and business rationale for an accelerated transition*.
- European Bank for Reconstruction and Development. (2022). *Kosovo country diagnostic*:

Private investment challenges and opportunities.

European Commission. (2020). *A new circular economy action plan: For a cleaner and more competitive Europe.*

European Commission. (2022). *EU strategy for sustainable and circular textiles.*

European Commission. (2023). *Proposal for a directive of the European Parliament and of the Council amending Directive 2008/98/EC on waste.*

European Commission. (2024). *Kosovo report 2024.*

European Environment Agency. (2024). *Textile waste management in Europe's circular economy.*

European Free Trade Association. (2025). *EFTA and the Republic of Kosovo sign Free Trade Agreement.*

European Topic Centre on Circular Economy and Resource Use. (2024). *Circular economy country profile 2024 – Kosovo.*

European Union. (2016). *Stabilisation and Association Agreement between the European Union and the European Atomic Energy Community, of the one part, and Kosovo, of the other part. Official Journal of the European Union.*

European Commission. (2024). *Commission publishes the 2025 version of the Combined Nomenclature.* European Commission.

European Commission. (2025). *Waste Framework Directive.* European Commission.

Eurostat. (n.d.). *International trade in goods: Indices methodology.* European Commission.

European Union Office in Kosovo. (2025). *Circular Economy for Green Transition in Kosovo.* European Union Office in Kosovo.

EU4Green. (2023). *Kosovo's pathway to new circular business models.*

EU4Green. (2024). *Guideline for the implementation of circular business models in Kosovo.*

- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (2012). *Ligji Nr. 04/L-060 për mbeturina*.
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (2022). *Ligji Nr. 08/L-071 për ndryshimin dhe plotësimin e Ligjit Nr. 04/L-060 për mbeturina*.
- Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës. (2024). *Ligji Nr. 08/L-262 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjeve që përmbajnë procedura të veçanta administrative dhe harmonizimin e tyre me Ligjin Nr. 05/L-031 për procedurën e përgjithshme administrative, faza e dytë*.
- Geissdoerfer, M., Savaget, P., Bocken, N. M. P., & Hultink, E. J. (2017). The circular economy: A new sustainability paradigm? *Journal of Cleaner Production*, 143, 757–768.
- Haliti Rudhani, L., Bajraktari, A., Pira, B., & Mehmeti, I. (2025). Waste recycling and sustainable economic growth: Challenges of the circular economy in developing countries. *International Journal of Environmental Sciences*, 11 (12s), 574–581.
- International Trade Administration. (2026). *Kosovo trade agreements*.
- Kosovo Investment and Enterprise Support Agency. (2025). *Public call: Grant scheme for the purchase of advanced manufacturing and processing machinery*.
- Ministria e Industrisë, Ndërmarrësisë dhe Tregtisë. (2023). *Strategy for industrial development and business support 2030*.
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. (2023). *Circular economy roadmap of Kosovo*.
- Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës. (2025). *Strategjia (2024–2035) për menaxhimin e integruar të mbeturinave në Kosovë dhe plani i veprimit (2024–2026)*.
- Niinimäki, K., Peters, G., Dahlbo, H., Perry, P., Rissanen, T., & Gwilt, A. (2020). The environmental price of fast fashion. *Nature Reviews Earth & Environment*, 1 (4), 189–200.

- Open Data Kosovo. (2023, June). *Bizneset e hapura*.
- Organisation for Economic Co-operation and Development. (2024). *Western Balkans competitiveness outlook 2024: Kosovo*.
- People in Need. (2024). *Pioneering NGO advancing circular economy in Kosovo*.
- Qeveria e Republikës së Kosovës. (2023). *Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 07/2023 për ambalazhin dhe mbeturinat e ambalazhit*.
- Qeveria e Republikës së Kosovës. (2025). *Udhëzim Administrativ (QRK) Nr. 04/2025 për ndryshimin dhe plotësimin e Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2023 për ambalazhin dhe mbeturinat e ambalazhit*.
- Regional Cooperation Council. (2020). *Sofia Declaration on the Green Agenda for the Western Balkans*. Regional Cooperation Council.
- RIINVEST Institute. (2024). *A comprehensive study to identify skills gap in the industry sector labour market*.
- Rilindja e Gjelbër. (2024). *Promovimi i ekonomisë qarkore si model i qëndrueshëm për zhvillimin e ndërmarrjeve sociale – SEREC*.
- Rilindja e Gjelbër. (2025). *3R Thrift Store*. Rilindja e Gjelbër.
- Rilindja e Gjelbër. (2025). *Ekonomia qarkore përmes artit*. Rilindja e Gjelbër.
- Sinha, P., Dissanayake, G., & Mahotra, A. (2022). Addressing post-consumer textile waste in developing economies. *The Journal of The Textile Institute*, 113(9), 1761–1773.
- U.S. Department of State. (2024). *2024 investment climate statements: Kosovo*.
- USAID. (2020). *Kosovo's apparel industry works together to explore new markets*.
- Western Balkans Circular Economy Hub. (2025). *Circular Economy Awards 2025: The Western Balkans' first regional winners announced*. Western Balkans Circular Economy Hub.
- World Bank. (2026). *Kosovo overview*. World Bank.

Zyra e Kryeministrit. (2023). *Udhërrëfytyesi i Kosovës për ekonominë qarkore*.

Seksioni 1. Furnizimi me produktet e tekstilit

1. Si furnizoheni me produktet e mëposhtme të tekstilit? (Pytje e shumëfishtë)

	I blej personalisht	Dikush nga familja i blen për mua	I ripërdor nga anëtarët e familjes	Nuk i blej/përdori
Veshmbathje				
Maica, këmisha, bluza dhe të ngjajshme	☐	☐	☐	☐
Xhaketa, pallto, jakne dhe të ngjajshme	☐	☐	☐	☐
Pantollona, xhinse dhe fund/fustan	☐	☐	☐	☐
Të brendshme	☐	☐	☐	☐
Sportive	☐	☐	☐	☐
Këpucë, çizme, patike dhe të ngjajshme	☐	☐	☐	☐
Çorape	☐	☐	☐	☐
Aksesorë				
Çanta	☐	☐	☐	☐
Kapele	☐	☐	☐	☐
Shall dhe/ose dorëza	☐	☐	☐	☐
Tekstil shtëpiak				
Mbulesa të shtratit (çarçafët, mbulesa të jastëkëve, jorgan)	☐	☐	☐	☐
Mbulesa të tavolinave	☐	☐	☐	☐
Qilima	☐	☐	☐	☐
Perde	☐	☐	☐	☐

2. Sa shpesh i blen produktet e mëposhtme të tekstilit? (Vendos produktet e zgjedhura tek opsioni I blej personalisht ose Dikush nga familja i blen për mua)

	Disa herë në muaj	Një herë në muaj	Çdo 2-3 muaj	Çdo 6 muaj	Më rrallë se çdo 6 muaj
Veshmbathje					
Maica, këmisha, bluza dhe të ngjajshme	☐	☐	☐	☐	☐
Xhaketa, pallto, jakne dhe të ngjajshme	☐	☐	☐	☐	☐
Pantollona, xhinse dhe fund/fustan	☐	☐	☐	☐	☐
Të brendshme	☐	☐	☐	☐	☐
Sportive	☐	☐	☐	☐	☐
Këpucë, çizme, patike dhe të ngjajshme	☐	☐	☐	☐	☐
Çorape	☐	☐	☐	☐	☐
Aksesorë					
Çanta	☐	☐	☐	☐	☐
Kapele	☐	☐	☐	☐	☐
Shall dhe/ose dorëza	☐	☐	☐	☐	☐
Tekstil shtëpiak					
Mbulesa të shtratit (çarçafët, mbulesa të jastëkëve, jorgan)	☐	☐	☐	☐	☐
Mbulesa të tavolinave	☐	☐	☐	☐	☐
Qilima	☐	☐	☐	☐	☐
Perde	☐	☐	☐	☐	☐

3. Ku i blen zakonisht produktet e mëposhtme të tekstitit? (Vendos produktet e zgjedhura tek opsioni *I blej personalisht ose Dikush nga familja i blen për mua*) (Pyetje e shumëfishtë)

	Brenda Kosovës	Jashtë Kosovës
Veshmbathje		
Maica, këmisha, bluza dhe të ngjajshme	☐	☐

Xhaketa, pallto, jakne dhe të ngjajshme	☐	☐
Pantollona, xhinse dhe fund/fustan	☐	☐
Të brendshme	☐	☐
Sportive	☐	☐
Këpucë, çizme, patike dhe të ngjajshme	☐	☐
Çorape	☐	☐
Aksesorë		
Çanta	☐	☐
Kapele	☐	☐
Shall dhe/ose dorëza	☐	☐
Tekstil shtëpiak		
Mbulesa të shtratit (çarçafët, mbulesa të jastëkëve, jorgan)	☐	☐
Mbulesa të tavolinave	☐	☐
Qilima	☐	☐
Perde	☐	☐

4. (Nëse P3=Jashtë Kosovës) Në cilat vende jashtë Kosovës i bën këto blerje?

5. (Nëse P3=Jashtë Kosovës) Pse këto produkte vendosni ti bleni jashtë Kosovës? (Pyetje e shumëfishtë) (Me rotacion)
- Në Kosovë nuk i gjej ato produkte që i kërkoj
 - Mendoj që cilësia e produkteve jashtë Kosovës është më e mirë
 - Preferoj marka ndërkombëtare që nuk janë në Kosovë
 - Modelet janë më të reja jashtë vendit
 - Reputacioni i dyqaneve ndërkombëtare është më i mirë
 - Çmimet e produkteve janë të arsyeshme në raport me cilësinë
 - Tjetër (specifikoni) _____
6. Si i blen zakonisht produktet e mëposhtme të tekstilit? (Vendos produktet e zgjedhura tek opsioni I blej personalisht ose Dikush nga familja i blen për mua) (Pyetje e shumëfishtë)

	Në dyqane fizike	Blerje online
Veshmbathje		
Maica, këmisha, bluza dhe të ngjajshme	☐	☐
Xhaketa, pallto, jakne dhe të ngjajshme	☐	☐
Pantollona, xhinse dhe fund/fustan	☐	☐

Të brendshme	☐	☐
Sportive	☐	☐
Këpucë, çizme, patike dhe të ngjajshme	☐	☐
Çorape	☐	☐
Aksesorë		
Çanta	☐	☐
Kapele	☐	☐
Shall dhe/ose dorëza	☐	☐
Tekstil shtëpiak		
Mbulesa të shtratit (çarçafët, mbulesa të jastëkëve, jorgan)	☐	☐
Mbulesa të tavolinave	☐	☐
Qilima	☐	☐
Perde	☐	☐

7. (Nëse P3=Brenda Kosovës dhe P6=Në dyqane fizike) Në çfarë lloj dyqanesh i bën zakonisht këto blerje? (Pyetje e shumëfishtë) (Me rotacion)
- Dyqane brenda qendrave tregtare
 - Dyqane të lagjes
 - Dyqane online
 - Dyqane të dorës së dytë (Second hand)
 - Tregje të hapura (pazar)
 - Dyqane ndërkombëtare të njohura (p.sh. Zara, H&M, Mango, etj.)
 - Tjetër (specifikoni) _____
8. (Nëse P6=Blerje online) Në cilat platforma bëni zakonisht blerje online?

9. Çfarë lloji të produkteve të mëposhtme të tekstilit i bleni? (Vendos produktet e zgjedhura tek opsioni I blej personalisht ose Dikush nga familja i blen për mua) (Pyetje e shumëfishtë)

	Të reja	Të ripërdorura (second-hand)	Të ricikluara
Veshmbathje			
Maica, këmisha, bluza dhe të ngjajshme	☐	☐	☐
Xhaketa, pallto, jakne dhe të ngjajshme	☐	☐	☐
Pantollona, xhinse dhe fund/fustan	☐	☐	☐
Të brendshme	☐	☐	☐
Sportive	☐	☐	☐
Këpucë, çizme, patike dhe të ngjajshme	☐	☐	☐

Çorape	☐	☐	☐
Aksesorë			
Çanta	☐	☐	☐
Kapele	☐	☐	☐
Shall dhe/ose dorëza	☐	☐	☐
Tekstil shtëpiak			
Mbulesa të shtratit (çarçafët, mbulesa të jastëkëve, jorgan)	☐	☐	☐
Mbulesa të tavolinave	☐	☐	☐
Qilima	☐	☐	☐
Perde	☐	☐	☐

Nëse P9 = Të ripërdorura (second-hand) vazhdo P10, tjerët P11

10. Si l bleni zakonisht produktet e ripërdorura të teksilit (second-hand)?

- a) Në dyqan fizik
- b) Blerje online

Nëse P9 != Të ripërdorura (second-hand) vazhdo P11

11. Cilat janë arsyet që nuk blini produkte të ripërdorura (second-hand) të tekstit? (Pytje e shumëfishtë)(Me rotacion)

- a) Nuk besoj se janë cilësore
- b) Nuk janë të përshtatshme për shijet e mia
- c) Mendoj se nuk janë të pastërta/higjienike
- d) Kam vështirësi në gjetjen e produkteve që më përshtaten
- e) Nuk më pëlqen ideja e përdorimit të diçkaje të përdorur nga dikush tjetër.
- f) Tjetër (specifikoni) _____

12. Në një shkallë nga 1 deri në 7, ku 1-aspak i gatshëm dhe 7-shumë i gatshëm, sa jeni të gatshëm të bleni produkte të ripërdorura në të ardhmen?

Nëse P12>4 vazhdo P13, tjerët P14

13. Cilat janë arsyet pse do ta konsideroni blerjen e produkteve të ripërdorura të tekstit (second-hand) në të ardhmen? (Pytje e shumëfishtë)(Me rotacion)

- a) Kanë çmim më të ulët krahasuar me produktet e reja
- b) Bëhet reduktimi i mbeturinave dhe ndikimi pozitiv në mjedis
- c) Mund të gjej produkte unike ose me vlerë historike
- d) Mund të blej produkte që nuk gjenden më në treg si të reja
- e) Tjetër (specifikoni) _____

Nëse P1 = I ripërdor nga anëtarët e familjes vazhdo P14, tjerët P15

14. Cilat janë arsyet e ripërdorimit të produkteve të teksilit nga anëtarët e familjes suaj? (Pytje e shumëfishtë)(Me rotacion)

- a) Për të kursyer para
- b) Për të reduktuar mbeturinat dhe për arsye mjedisore

- c) Rrobat janë ende në gjendje të mirë për përdorim
- d) Nuk kam shumë nevojë për të blerë rroba të reja
- e) Është një traditë familjare
- f) Tjetër (specifikoni) _____

Seksioni 2. Veshmbathjet dhe aksesorët

Nëse P1 = **I blej personalisht** ose **Dikush nga familja i blen për mua** në **Veshmbathje** ose **Aksesorë** vazhdo P15, tjerët P17

15. Çfarë lloji të veshmbathjeve dhe aksesorëve preferoni ta blini më shumë? (Pytje e shumëfishtë)
 - a) Të përditshme (Casual)
 - b) Formale
 - c) Për festa/evente
 - d) Sportive
 - e) Tjetër (specifikoni) _____
16. Cilët janë tre faktorët që ndikojnë më shumë në vendimin tuaj për të zgjedhur veshmbathje apo aksesorë që bleni? (Pytje e shumëfishtë)(Me rotacion)
 - a) Çmimi
 - b) Trendi
 - c) Marka
 - d) Dizajni
 - e) Cilësia
 - f) Materiali
 - g) Vendi i prodhimit
 - h) Tjetër (specifikoni) _____
17. Sa jeni të informuar për konceptin e Fast Fashion (moda e shpejtë)?
 - a) Shumë i/e informuar
 - b) Deri diku i/e informuar
 - c) Pak i/e informuar
 - d) Aspak i/e informuar (kalo tek P19)
18. Sa mendoni se bleni më shpesh veshmbathje apo aksesorë për shkak të ndikimit të Fast Fashion (moda e shpejtë)?
 - a) Blej shumë më shpesh
 - b) Blej pak më shpesh
 - c) Nuk ndikon se sa shpesh blej veshmbathje
 - d) Blej më rrallë
19. Si i menaxhoni veshmbathjet dhe aksesorët që nuk i përdorni më? (Pytje e shumëfishtë)(Me rotacion)
 - a) I dhuroj tek familjarët e mi
 - b) I dhuroj për riciklim (specifikoni vendin ku: _____)
 - c) I dhuroj për familje në nevojë (specifikoni vendin ku: _____)

- d) I shes në tregje të dorës së dytë (specifikoni vendin ku dhe nese keni dyqan: _____)
- e) I ruaj për ripërdorim në të ardhmen
- f) I hedhi si mbeturina (specifikoni vendin ku: _____)
- g) Tjetër (specifikoni)_____

Nëse P19=f vazhdo P20, tjerët P21

20. Përafërsisht sa kilogram veshmbathje i hudhni gjatë një viti?

Seksioni 3. Tekstili shtëpiak

Në tekstil shtëpiak hyjnë mbulesa të shtratit (çarçafët, mbulesa të jastëkëve, jorgan), mbulesa të tavolinave, qilima, perde dhe produkte tjera të ngjajshme.

Nëse P1 = **I blej personalisht** ose **Dikush nga familja i blen për mua** në **Tekstil shtëpiak** vazhdo P21, tjerët P24

- 21. Në cilat raste zakonisht bleni produkte të reja të tekstilit shtëpiak? (Pytje e shumëfishtë) (Me rotacion)
 - a) Gjatë ofertave sezonale
 - b) Kur ka nevojë për zëvendësim
 - c) Gjatë festave apo eventeve speciale
 - d) Kur dua të rinovoj dekorin e shtëpisë
 - e) Tjetër (specifikoni)_____
- 22. Cilët janë tre faktorët që ndikojnë më shumë në vendimin tuaj për të zgjedhur produktet e tekstilit shtëpiak që bleni? (Pytje e shumëfishtë) (Me rotacion)
 - a) Çmimi
 - b) Trendi
 - c) Marka
 - d) Dizajni
 - e) Cilësia
 - f) Materiali
 - g) Qëndrueshmëria
 - h) Vendi i prodhimit
 - i) Tjetër (specifikoni) _____
- 23. A keni ndryshuar zakonet tuaja të blerjes së produkteve të tekstilit shtëpiak viteve të fundit?
 - a) Po, blej më shpesh
 - b) Po, blej më rrallë
 - c) Jo, zakonet e mija kanë mbetur të njejta
- 24. Si i menaxhoni produktet e tekstilit shtëpiak që nuk i përdorni më? (Pytje e shumëfishtë) (Me rotacion)
 - a) I dhuroj tek familjarët e mi
 - b) I dhuroj për riciklim (specifikoni vendin ku: _____)

- c) I dhuroj për familje në nevojë (specifikoni vendin ku: _____)
- d) I shes në tregje të dorës së dytë (specifikoni vendin ku dhe nëse keni dyqan: _____)
- e) I ruaj për ripërdorim në të ardhmen
- f) I hedhi si mbeturina (specifikoni vendin ku: _____)
- g) Tjetër (specifikoni) _____

Seksioni 4. Praktikët e ripërdorimit dhe riciklimit

Ripërdorimi dhe riciklimi i tekstilit përfshin procesin e mbledhjes dhe dhurimit të produkteve të tekstilit për qëllime ripërdorimi ose riciklimi.

25. A keni njohuri për ndikimin që kanë në mjedis prodhimi dhe asgjësimi i produkteve të tekstilit?
 - a) Po
 - b) Jo
26. (Nëse P25=a) Sa mendoni se është i rëndësishëm ky problem?
 - a) Shumë i rëndësishëm
 - b) I rëndësishëm
 - c) Pak i rëndësishëm
 - d) Aspak i rëndësishëm
27. (Nëse P25=b) Cili mendoni se është shkaku kryesor i mosinformimit tuaj mbi këtë çështje? (Pytje e shumëfishtë)
 - a) Mungesa e informacionit në media
 - b) Mungesa e fushatave ndërgjegjëse
 - c) Nuk kam pasur interes për këtë temë
 - d) Nuk e shoh si një problem të rëndësishëm
 - e) Tjetër (specifikoni) _____
28. Sa shpesh i ripërdorni dhe ricikloni produktet tuaja të tekstilit?
 - a) Shpesh
 - b) Ndonjëherë
 - c) Rrallë
 - d) Asnjëherë (Kalo P30)
29. A përballeni me vështirësi gjatë procesit të ripërdorimit dhe riciklimit të produkteve të tekstilit?
 - a) Po
 - b) Jo
 - c) Ndonjëherë
30. (Nëse P28=d) Çfarë ndryshimesh do t'ju inkurajonin të ripërdornit dhe riciklonit produktet e tekstilit më shpesh? (Pytje e shumëfishtë) (Me rotacion)
 - a) Ofrimi i pikave të dedikuara për riciklim të rrobave
 - b) Marrja e zbritjeve ose shpërblimeve për ripërdorim/riciklim

- c) Fushata ndërgjegjësimi për rëndësinë e ripërdorimit/riciklimit
- d) Informacion më i qartë mbi procesin e ripërdorimit/riciklimit
- e) Ofrimi i shërbimit për mbledhjen e rrobave nga shtëpia
- f) Më shumë opsione për të dhuruar rrobat për njerëz në nevojë
- g) Tjetër (specifikoni) _____

31. Në cilat aspekte lidhur me ripërdorimin dhe riciklimin e produkteve të tekstilit dëshironi të merrni më shumë informacion? (Pytje e shumëfishtë)(Me rotacion)

- a) Proceset e ripërdorimit/riciklimit të tekstilit
- b) Vendet dhe qendrat e ripërdorimit/riciklimit në komunitetin tuaj
- c) Përfitimet mjedisore të ripërdorimit/riciklimit
- d) Si të identifikohen materialet që mund të ripërdoren/riciklohen
- e) Si të kujdesem për rrobat para ripërdorimit/riciklimit
- f) Tjetër (specifikoni) _____

32. A keni informacion për ndonjë iniciativ të riciklimit të produkteve të tekstilit?

- a) Po (Ju lutem specifikoni _____)
- b) Jo

33. Në një shkallë nga 1 deri në 7, ku 1-aspak i gatshëm dhe 7-shumë i gatshëm, sa do të ishit të gatshëm të përfshiheni në procese të riciklimit të produkteve të tekstilit?

Seksioni 5. Ekonomia qarkore

34. Sa keni njohuri për konceptin e ekonomisë qarkore?

- a) Po, e njoh shumë mirë
- b) Po, kam dëgjuar por nuk kam shumë njohuri
- c) Jo, nuk e njoh si koncept

Nëse P34=c vazhdo P36

35. A do të ishit të gatshëm të ndryshoni zakonet tuaja të furnizimit me produkte të tekstilit për të kontribuar në ekonominë qarkore?

- a) Po, plotësisht
- b) Deri diku
- c) Jo fare

36. Sa jeni të gatshëm të merrni pjesë në evente të shkëmbimit të rrobave (swapping clothes event)?

- a) Shumë i gatshëm
- b) Disi i gatshëm
- c) Aspak i gatshëm

Nëse P36=c vazhdo P38

37. Çfarë ju motivon më shumë për t'u bërë pjesë e nismave të tilla? (Pytje e shumëfishtë)(Me rotacion)

- a) Përfitimet mediocre
- b) Kursimet financiare
- c) Ndikimi social

- d) Përmirësimi i stilit të jetesës
- e) Mundësia për të shkëmbyer/përfituar produkte unike
- f) Tjetër (specifikoni)_____

Seksioni 6. Burimet e informacionit

38. Cilat burime të informacionit i përdorni për të marrë informatat në lidhje me tekstin dhe blerjen e produkteve të tekstilit? (Pyetje e shumëfishtë) (Me rotacion)
- a) Rrjete sociale
 - b) Televizion
 - c) Radio
 - d) Webfaqet në internet
 - e) Bisedat me familjar/miq
 - f) Fletëpalosje/broshura
 - g) Tjetër (specifikoni)_____

Nëse P38=a vazhdo P39, tjerët Demografia

39. Cilat nga rrjetet sociale i përdorni më së shpeshti për informim dhe blerje të produkteve të tekstilit? (Pyetje e shumëfishtë)
- a) Facebook
 - b) Instagram
 - c) Twitter
 - d) TikTok
 - e) LinkedIn
 - f) Youtube
 - g) Snapchat

Seksioni 7. Demografia

D1. GJINIA

- a) Femër
- b) Mashkull

D2. MOSHA (vjet)

--

D3. (STATUSI MARTESOR) Cili është statusi juaj martesor?

- a) Beqar/e
- b) I/E martuar
- c) I/E divorcuar
- d) I/E ve
- e) Bashkëjetesë

D4. (FAMILJA) Numri i anëtarëve të familjes: _____

D5. (TË ARDHURAT PERSONALE) Sa janë të ardhurat tuaja mujore personale (Neto)?

- a) Nuk kam të ardhura
- b) Deri 150 euro
- c) 151-300 euro
- d) 301-450 euro
- e) 451-600 euro
- f) 601-750 euro
- g) 751-900 euro
- h) 901-1200 euro
- i) 1201-1500 euro
- j) 1501-2000 euro
- k) 2001 – 2500 euro
- l) 2501 – 3000 euro
- m) 3000+ euro
- n) Refuzoj të përgjigjem

D6. (TË ARDHURAT FAMILJARE) Sa janë të ardhurat mujore të familjes tuaj (Neto)?

- a) Nuk kemi të ardhura
- b) Deri 200 euro
- c) 201-400 euro
- d) 401-600 euro
- e) 601-900 euro
- f) 901-1200 euro
- g) 1201-1500 euro
- h) 1501-2000 euro
- i) 2001-2500 euro
- j) 2501-3000 euro
- k) 3001 - 4000 euro
- l) 4001 – 5000 euro
- m) 5000+
- n) Refuzoj të përgjigjem

D9. KOMUNA _____

D10. (VENDBANIMI) Në çfarë vendbanimi jetoni?

- a) Urban
- b) Rurale

D11. (EDUKIMI) Cili është niveli më i lartë i shkollimit që keni përfunduar?

- a) Pa edukim/shkollim të përfunduar
- b) Shkollë fillore (8 apo 9 vjeçare)

- c) Shkollë e mesme
- d) Shkollë e lartë
- e) Universitet (Bachelor)
- f) Master
- g) Doktoratë

D12. (PUNËSIMI) Cili është statusi juaj i punësimit?

- a) I/E papunësuar – duke kërkuar punë
- b) I/E papunësuar – duke mos kërkuar punë
- c) I/E vetëpunësuar
- d) I/E punësuar në sektorin publik
- e) I/E punësuar në sektorin privat
- f) I/E punësuar kohë pas kohe
- g) Pensionist/e
- h) Amvis/e
- i) Student/e
- j) Tjetër, ju lutem specifikoni: _____

PYETËSORI PËR INTERVISTAT ME BIZNESE

INFORMACIONI I PËRGJITHSHËM PËR KOMPANINË

1. Emri i kompanisë: _____
2. Emri i brendit/markës: _____
3. Veprimtaria e kompanisë: _____
4. Gjinia e pronarëve të kompanisë: (Nëse ka më shumë pronarë me gjini të ndryshme, kliko në aq sa janë)
 - a) Femër: _____
 - b) Mashkull: _____
5. Numri i punëtorëve në kompani dhe ndarja sipas gjinisë:

Gjinia	Numri i punëtorëve
Femër	
Mashkull	

6. Komuna: (listohen si dropdown list të gjitha komunat)
7. Kontakti:
 - a) Email: _____
 - b) Nr. i telefonit: _____
 - c) Adresa: _____

8. Qarkullimi vjetor për sektorin tuaj i deklaruar në vitin 2024 në ATK: (Shkruaj shumën në Euro ashtu siç keni deklaruar në Administratën Tatimore të Kosovës) [Nëse biznesi nuk e ka informacionin për vitin 2024, pyet për vitin 2023]

9. Sa ka qenë vlera e eksporteve të kompanisë tuaj në vitin 2024?

- a) Eksporti (Shëno vlerën në €): _____
- b) Nuk kam eksportuar në vitin 2024 [kaloje pyetjen 11]

10. Sa ka qenë vlera e importeve të kompanisë tuaj në vitin 2024?

- a) Importi (Shëno vlerën në €): _____
- b) Nuk kam importuar në vitin 2024 [kaloje pyetjen 12]

11. Në cilat shtete keni eksportuar në vitin 2024? (Shëno shtetet në të cilat keni eksportuar në vitin 2024)

Shteti	Sasia në KG

12. Nga cilat shtete keni importuar në vitin 2024?

Shteti	Sasia në KG

13. Ku furnizohet kompania juaj me lëndën e parë?

- a) Në Kosovë
- b) Jashtë Kosovës: Ju lutem specifikoni shtetet _____

14. Cila ka qenë forma kryesore e shitjes në kompaninë tuaj në vitin 2024?

- a) Me pakicë
- b) Me shumicë
- c) Të dyja

15. Sa ka qenë sasia e produkteve të përpunuara nga kompania juaj në vitin 2024?

- a) Sasia totale e përpunuar (në KG): _____
- b) Lloji i produkteve të përpunuara: _____
- c) Nuk aplikohet

PËRDORIMI I LËNDËVE TË PARA PËR PRODHIM

16. Cili është aktiviteti kryesor i kompanisë tuaj?

- a) Prodhues
- b) Ripërpunues
- c) Shitje me pakicë
- d) Shitje me shumicë
- e) Importues
- f) Eksportues

- g) Shërbime (p.sh., dizajn, rregullime, përshtatje të tekstilit, etj.)
- h) Tjetër (Ju lutem specifikoni: _____)

17. Nëse kompania juaj është prodhuese, cilat produkte i prodhoni? [Mund të zgjedhni më shumë se një opsion]

- a) Veshje sportive
- b) Veshje të brendshme
- c) Farmerka
- d) Uniforma të punës
- e) Këpucë, çanta, dhe produkte lëkure
- f) Çorapë
- g) Veshje për fëmijë
- h) Veshje dasdash dhe eventesh
- i) Kostume për meshkuj dhe femra
- j) Tekstil shtëpiak
- k) Perde
- l) Qilima
- m) Veshje të thurura
- n) Nuk aplikohet
- o) Tjetër (Ju lutemi specifikoni): _____

18. Nëse kompania juaj ofron shërbime, cilat janë shërbimet kryesore që ofroni? [Mund të zgjedhni më shumë se një opsion]

- a) Dizajn tekstili
- b) Riparim i veshjeve
- c) Personalizim i produkteve (p.sh., qëndisje, printime)
- d) Konsulencë për modë ose tekstil
- e) Nuk aplikohet
- f) Tjetër (Ju lutem specifikoni: _____)

19. Nëse kompania juaj është shitës me pakicë/shumicë, cilat produkte kryesore shisni? [Mund të zgjedhni më shumë se një opsion]

- a) Veshje sportive
- b) Veshje të brendshme
- c) Farmerka
- d) Uniforma të punës
- e) Këpucë, çanta, dhe produkte lëkure
- f) Çorapë
- g) Veshje për fëmijë
- h) Veshje dasdash dhe eventesh
- i) Kostume për meshkuj dhe femra
- j) Tekstil shtëpiak
- k) Perde
- l) Qilima
- m) Veshje të thurura

- n) Tjetër (Ju lutem specifikoni: _____)
- o) Nuk aplikohet

20. Cila është lënda e parë që përdorni për produktet e prodhuara? [kompanitë përgjigjen vetëm për produktet që i prodhojnë]

21. Cilat janë materialet që kërkohen më shumë nga klientët tuaj dhe që kanë më shumë shitje? [Mund të zgjedhni më shumë se një opsion]

- a) Pambuk
- b) Poliester
- c) Pelhurë liri
- d) Mikrofibra
- e) Materiale të thurura (p.sh., trikotazh)
- f) Lëkurë natyrale
- g) Material sintetik (p.sh., nylon, elastan)
- h) Materiale të specializuara (p.sh., tekstil antialergjik, tekstil i papërshkueshëm nga uji)
- i) Tjetër (Ju lutem specifikoni: _____)

MENAXHIMI I MBETURINAVE

22. Praktikrat e menaxhimit të mbeturinave: Si i menaxhon kompania juaj mbeturinat e materialeve në procesin e prodhimit? [Mund të zgjedhni më shumë se një opsion]

- a) I mbledhin deponitë komunale
- b) I ricikloni
- c) Përdorni materialet e mbetura
- d) I djegim
- e) I groposim
- f) I hedhim në natyrë (lumenj, ambiente të hapura)
- g) Bashkëpunoni me iniciativat për ri-shfrytëzim të materialit
- h) I shesim
- i) Tjetër (Ju lutem specifikoni: _____)

23. Nëse mbeturinat e materialeve i mbledhin deponitë komunale, sa paguani në vit? [Nëse 22=a]

24. Nëse po, sa herë i grumbullojnë mbeturinat e materialit? [Nëse 22=a]

- a) Çdo ditë
- b) 1 herë në javë
- c) 1 herë në muaj
- d) Nuk aplikohet
- e) Tjetër (Ju lutem specifikoni: _____)

25. Sa ton mbeturina tekstili gjeneron kompania juaj në vit? _____
26. Cilat janë llojet kryesore të mbeturinave që gjeneroni gjatë procesit të punës?
- a) Mbeturina tekstili (copëza, mbeturina prerjeje, etj.)
 - b) Mbeturina nga ambalazhimi i lëndës së parë
 - c) Mbeturina nga ambalazhimi i produkteve finale
 - d) Letër/karton
 - e) Metal
 - f) Plastikë
 - g) Dru
 - h) Tjetër (specifikoni: _____)
27. A ka kompania juaj një sistem për ripërdorimin e materialeve të mbetura brenda procesit të prodhimit? _____
- a) Po (Ju lutem përshkruani shkurtimisht: _____)
 - b) Jo

EKONOMIA QARKORE

28. A keni dëgjuar për konceptin e ekonomisë qarkore?
- a) Po
 - b) Jo [kalo te pyetja 32]
29. A jeni të interesuar të aplikoni parimet e ekonomisë qarkore në kompaninë tuaj?
- a) Po
 - b) Jo
30. A është kompania juaj e gatshme të fillojë me riciklim dhe të zbatojë praktikën e ekonomisë qarkore?
- a) Po, kemi filluar tashmë
 - b) Po, kemi interesim, por nuk kemi filluar ende
 - c) Jo, nuk është prioritet për momentin
 - d) Nuk jam i/e sigurt
31. A do të ishit të interesuar për pjesëmarrje në trajnime për riciklim të tekstilit dhe ekonominë qarkore për biznesin dhe punëtorët tuaj?
- a) Po, për stafin menaxhues
 - b) Po, për punëtorët në prodhim
 - c) Po, për të dyja kategoritë
 - d) Jo, nuk kemi interesim

NDRYSHIMET KLIMATIKE DHE GJURMËT E KARBONIT

32. Sa jeni të shqetësuar për ndotjen që veprimtaria e kompanisë suaj shkakton në mjedis?
- a) Shumë të shqetësuar
 - b) Të shqetësuar
 - c) Neutrale
 - d) Jo shumë të shqetësuar
 - e) Aspak të shqetësuar
33. A jeni të gatshëm të investoni në përmirësimin e praktikave për të reduktuar ndikimin mjedisor dhe gjurmët e karbonit?
- a) Po
 - b) Jo

RREGULLAT MJEDISORE PËR EKSPORT

34. Për kompanitë eksportuese në BE: A jeni të gatshëm të investoni për të përmbushur kriteret mjedisore që kërkohen për eksport?
- a) Po
 - b) Jo
 - c) Nuk jam i sigurt
 - d) Nuk kam mjaftueshëm informata sa i përket kësaj çështjeje

INTERESIMI DHE SFIDAT PËR RICIKLIM

35. A është kompania juaj aktualisht e përfshirë në ndonjë iniciativë ripërdorimi dhe riciklimi për mbeturinat pas prodhimit? _____
- a) Po
 - b) Jo [kalo tek pyetja 37]
 - c) Nuk jam i/e sigurtë/ Nuk e di
36. Nëse po, ju lutem përshkruani shkurtimisht iniciativat e riciklimit të ndërmarra _____
37. Nëse jo, pse nuk jeni të përfshirë? _____
38. A bashkëpunon kompania juaj me ndonjë kompani riciklimi për menaxhimin e mbeturinave të tekstilit?
- a) Po
 - b) Jo
 - c) Të interesuar, por aktualisht jo të angazhuar
 - d) Nuk e dimë nëse ka kompani të tilla
39. A do të ishte e interesuar kompania juaj për të bashkëpunuar me një kompani riciklimi që specializohet në menaxhimin e mbeturinave të veshjeve?
- a) Shumë i/e interesuar
 - b) I/E interesuar
 - c) Jo i/e interesuar

d) Nuk jam i/e sigurtë

40. Ju lutem specifikoni pengesat kryesore që ka kompania juaj në lidhje me bashkëpunimin me një kompani të riciklimit.

- a) Mungesa e informacionit për shërbimet e riciklimit të disponueshme
- b) Kostot e pa përballueshme
- c) Sfidat logjistike
- d) Tjetër (Ju lutem specifikoni: _____)

41. Cilat zgjidhje për menaxhimin e mbeturinave do të preferonte kompania juaj?

- a) Programet e zvogëlimit të mbeturinave brenda kompanisë
- b) Bashkëpunimi me kompanitë e riciklimit - të jashtme
- c) Tjetër (Ju lutem specifikoni: _____)

42. Sa e rëndësishme është mirëmbajtja e ambientit në kompaninë tuaj?

- a) Shumë e rëndësishme
- b) Neutrale
- c) Jo shumë e rëndësishme
- d) Aspak e rëndësishme

43. A ka kompania juaj në plan për të zbatuar ndonjë iniciativë të re për të përmirësuar menaxhimin e mbeturinave dhe mirëmbajtjen e ambientit?

- a) Po (Ju lutem elaboroni: _____)
- b) Jo

44. A do të ishit të hapur për të siguruar informacion shtesë ose për të marrë pjesë në diskutimet e mëtejshme lidhur me menaxhimin e mbeturinave dhe iniciativat e riciklimit në kompaninë tuaj?

- a) Po
- b) Jo

45. A merr pjesë kompania juaj në panairë të tekstilit dhe teknologjisë për tekstil?

- a) Po, rregullisht
- b) Po, herë pas here
- c) Jo

46. A do të ishit të interesuar të merrnit informacione për panairë dhe konferenca që lidhen me veprimtarinë tuaj?

- a) Po
- b) Jo

47. A do të ishit të interesuar që të angazhoni stafin tuaj në trajnime për riciklim të tekstilit?

- a) Po
- b) Jo

c) Nuk e di

Shprehim mirënjohjen tonë të thellë për të gjithë kontribuesit që kanë marrë pjesë në realizimin e këtij hulumtimi. Falënderojmë bizneset që ndanë kohën dhe përvojën e tyre, qytetarët që dhanë mendimet e tyre me sinqeritet, si dhe përfaqësuesit institucionalë që ofruan njohuri të vlefshme dhe perspektiva të rëndësishme. Kontributi i tyre ka qenë thelbësor për pasqyrimin real të situatës dhe për formulimin e rekomandimeve që synojnë përmirësimin e sektorit të tekstilit në Kosovë.

Ky publikim është zbatuar nga Rilindja Gjelbër, menaxhuar nga Fondi për Zhvillimin e Komunitetit (CDF) dhe prodhurar me mbështetjen financiare të Ambasadës Suedeze në Prishtinë. Përmbajtja e tij rrjedh nga përgjigjet e anketave të marra deri në datën e specifikuar në këtë raport dhe është përgjegjësi e vetme e Rilindja Gjelbër, zbatues i projektit “Kthimi i Vlerave në Ekonominë Qarkore” nën kuadrin e programit “Fuqizimi i OSHC-ve Mjedisore në Kosovë”.

